

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2021



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Qershor 2022

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
Hyrje	11
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	13
1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	13
1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	14
1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale.....	15
1.1.3 Norma e Arkëtimit.....	19
1.1.4 Niveli i Matjes	20
1.1.5 Efiçenca e Stafit.....	20
1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	21
1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN	22
1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit	22
1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet	22
1.2.2 Investimet Kapitale në Sektorin UK	24
1.3 Reforma në Sektor	26
1.4 Metodologjia e re e Vendosijes së Tarifave, Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK.....	26
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime	28
2.1 Ndarja sipas Grupimeve të Shoqërive UK.....	28
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosiura nga ERRU	30
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	31
2.3.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	31
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	36
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale	44
2.3.4 Norma e Arkëtimit.....	46
2.3.5 Niveli i Matjes	51
2.3.6 Efiçenca e Stafit.....	56
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	63
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	68
Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës	73
3 Konkluzione dhe Rekomandime	74
4 Tema e Veçantë (Studim i ERRU-së tetor 2021, i përditësuar me të dhënat e OSHEE në mbyllje të vitit 2021)	75
5 Aneks: Të dhënat Kryesore të Sektorit	80

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
SKP	Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korrente
UPA	Uji Pa të Ardhura
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Përmbledhje

Raporti i Performancës, si Instrument Analize, Informimi dhe Transparence i Sektorit UK

Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në sektor përbën një detyrim ligjor të ERRU-së si institucion i pavarur. Raporti i Performancës së shoqërive UK 2021 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Raporti përshkruan dhe analizon në mënyrë strikte performancën dhe zhvillimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve dhe të çdo shoqërie UK brenda periudhës kalendarike 1 janar - 31 dhjetor 2021. Hartimi i raportit realizohet mbasi ERRU ka marrë në fund të marsit të vitit pasardhës të dhënat financiare të vitit 2021 nga shoqëritë UK të certifikuar nga një auditues i autorizuar, si dhe të dhëna të tjera tekniko-operative të shoqërive UK të cilat grumbullohen dhe përpunohen nga sektori i monitorimit pranë ERRU-së. Gjatë periudhës mbas janarit të vitit pasardhës (2022) kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme institucionale në sektor, por ato nuk pasqyrohen në këtë raport.

Raporti jep gjithashtu rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko ekonomikë të performancës së shoqërive, si dhe u shërben shoqërive UK si një mjet për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK.

Treguesit Kryesorë të Performancës së Sektorit UK, Viti 2021

Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP) për vitin 2021 për vlerësimin e performancës së shoqërive UK jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2020	2021	Tendencë	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	65.4	64.8	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	103.2	103.4	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	74.9	73.9	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	89.8	92.3	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korrente(%)	76.6	77.6	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	79.6	80.7	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.32	5.37/4.9*	↘	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	13.8	15.4	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	51.5	52	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.1	76.8	↗	n/a

Burimi: ERRU

* Efiçenca e Stafit 5.37 staf për 1000 lidhje përfshin edhe personelin roje të nënkontraktuar me privatin ndërsa 4.9 staf për 1000 lidhje UK nuk përfshinë këto të fundit.

Nivelet e TKP për sektorin për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 përgjithësisht kanë tendencë të lehtë pozitive. Përfundimisht bëjnë treguesit "Mbulimi i kostove Totale" dhe i "Efiçencës së Stafit" të cilët kanë një përkeqësim të vogël.

Normat e Arkëtimit "Korrente dhe të Përgjithshme" të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2020. Treguesi "Mbulimi i Kostove O&M" 103.4% paraqitet në nivel performance të mirë me një përmirësim të lehtë, por sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM pasi vetëm 12 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor arrijnë

të mbulojnë 100% kostot e O&M. Rezultantja del pozitive për sektorin pasi disa nga shoqëritë e mëdha duke filluar nga UK Tirane. Korçë, Berat- Kuçovë mbulojnë mbi 100% kostot e O&M.

Sektori vijon të mbingarkohet me staf edhe gjatë vitit 2021 ku në sektor janë shtuar edhe 191 punonjës duke ndikuar në një përkeqësim të lehtë të këtij treguesi, pavarësisht se numri i lidhjeve UK në sektor është shtuar me 21,105 lidhje UK. Në treguesin 5.37 staf/për 1000 lidhje UK janë përfshirë dhe personat për shërbim roje të nënkontraktuara tek privati. Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje të sistemeve të FU dhe KUN, si dhe abuzimi me punësimet e pajustificuara. Në këtë drejtim kërkohet një angazhim më i madh nga shoqëritë dhe bashkitë përkatëse për të eliminuar punësimet nepotike apo të karakterit politik.

Me përmirësim të ndjeshëm me 1,6 orë/ditë paraqitet “Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë” duke arritur nivelin mesatarisht 15.4 orë/ditë. Po kështu edhe Treguesi “Uji Pa të Ardhura” në nivelin e 64.8% megjithëse ka një përmirësim të lehtë, përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe të papranueshme. Tendencë pozitive përmirësimi të lehtë kanë patur edhe treguesit “Niveli i Matjes”, “Mbulimi me Ujë” dhe “Mbulimi me Kanalizime”.

ERRU në përputhje me kërkesat bashkëkohore për qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të treguesve kryesorë të performancës të sektorit. Për këtë në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave aprovuar në dhjetor 2021 janë përfshirë në TKP edhe treguesit e “Eficiencës së Energjisë” dhe të “Ankesave të Konsumatorëve”. Rëndësi të veçantë i është kushtuar gjithashtu bazës së të dhënave të raportuara, saktësisë dhe mënyrës së llogaritjes së TKP, të cilat do të jenë pjesë e ndryshimeve që do të reflektohen në raportin e performancës për vitin 2022 për një vlerësim sa më real (benchmarking) të sektorit në përgjithësi dhe secilës shoqëri UK në veçanti.

Bilanci Financiar i Sektorit UK

Performanca financiare e sektorit UK për vitet 2020 dhe 2021 (në 000 lekë) jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Diferenca 2021/2020	
1	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,542,489	9,660,482	117,994	1%
2	Kostot Kapitale	3,606,628	3,862,892	256,263	7%
3	Kostot Totale	13,149,117	13,523,374	374,257	3%
4	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,850,414	9,987,507	137,093	1%
5	Të Ardhurat nga Subvencionet	720,000	380,000	(340,000)	-47%
6	Totali i të Ardhurave	10,570,414	10,367,507	(202,907)	-2%
7	Mbulimi i Kostove O&M	111%	107%		-3%
8	Mbulimi i Kostove Totale	80%	77%		-5%

Burimi: ERRU

Për vitin 2021 janë realizuar 9 987 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 137 milion lekë.

Për vitin 2021 janë 12 shoqëri nga 58 shoqëri që operojnë në të gjithë vendin, të cilat i mbulojnë mbi 100% Kostot e Operim dhe Mirëmbajtjes. Niveli i mbulimit të kostove të O&M ka rënie për shoqëritë e Grupit të I-rë nga 114% në 113%, ndërsa ka rritje për

shoqëritë e Grupit të II-të nga 68% në 69%, dhe Grupit të III-të nga 54% në 67%. Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ka ardhur për arsye se vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 është rritur me 4.3 milion m³ ujë si rezultat i rritjes me 19 mijë lidhje të reja të furnizimit me ujë dhe rritjes së orëve të furnizimit me ujë. Ndërsa vëllimi i faturuar KUN është rritur me 6.4 milion m³ si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve KUN. Sektori me të ardhurat e gjeneruara arrin të mbulojë kostot e O&M në nivelin 103%. Kjo nuk do të thotë se sektori ka performancë financiare të mirë sepse akoma 46 shoqëri UK nuk mbulojnë kostot e O&M (disa edhe nën 50%) dhe duhet të subvencionohen nga qeveria qendrore. Vlera pozitive e mësipërme për të gjithë sektorin vjen kryesisht nga bilanci financiar pozitiv i UK Tiranë për mbulimin e kostove të O&M.

***Subvencionimi
i Sektorit UK
nga Qeveria
Qendrore***

Qeveria qendrore nëpërmjet AKUM ka shpërndarë 380 milion lekë subvencione, të cilat janë dedikuar tërësisht për kostot e energjisë elektrike. Kanë përfituar 60% të totalit të subvencioneve, përkatësisht shoqëritë UK Durrës 98.2 milion lekë, UK Vlorë 52.5 milion lekë, UK Patos 32.7 milion dhe UK Elbasan 30.3 milion lekë.

Shoqëritë UK të bashkive Fier, Kamëz, Devoll, Kukës, Mat, Himarë, Gramsh, Bulqizë, Dropull, Roskovec, Tepelenë, Finiq, Klos, Pukë, Libohovë dhe Fushë Arrëz, nuk kanë marrë subvencione për vitin 2021 megjithë nevojën që kanë për mbulimin e kostove të O&M. Nevoja totale për subvencione për të gjithë Sektorin UK që të mbulohen deri 100% kostot e O&M vlerësohet në shumën prej 1,632 milion lekë (rreth 13.5 milion euro), ndërsa fondi i akorduar shoqërive si subvencion për vitin 2021 ka qenë 380 milion lekë (3.2 milion euro), me të cilin janë mbuluar 23% të nevojave për subvencione. Megjithatë duke patur parasysh se ato janë alokuar vetëm për kompensimin e kostove të energjisë elektrike, krahasuar me një vit më parë me këtë destinacion ato kanë qenë 230 milion lekë më të larta se ato të vitit 2020.

***Reforma e
Qeverisë në
Sektorin UK***

Në tre dekadat e fundit është evident fakti i performancës së dobët financiare të sektorit të ujësjellës kanalizimeve, si edhe i cilësisë së shërbimeve që shoqëritë UK ofrojnë për konsumatorët. Duke patur parasysh problematikat që paraqet sektori, qeveria qendrore ka planifikuar zbatimin e një reforme thelbësore në sektor me qasje kryesore agregimin e sektorit të fragmentarizuar në një numër të kufizuar shoqëri UK.

Gjatë vitit 2021 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi me anë të një sërë takimesh me përfaqësues të pushteteve vendore dhe të shoqërive UK mbi nevojën e një reforme rrënjësore në sektor me anë të agregimit të shoqërive UK ekzistuese me një numër mjaft të reduktuar të tyre, si një instrument për përmirësimin e gjendjes financiare të sektorit, si dhe të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Detaje të mëtejshme, si dhe hapat ligjorë e organizativë të realizimit të reformës pritet të konkretizohen gjatë vitit 2022 me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit të Ministrave dhe nën-akte të tjera ligjore.

***Licencimi i
Shoqërive UK
nga ERRU***

Në sektorin UK shërbimi i "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik" për vitin 2021 është ofruar nga 58 shoqëri nga të cilat 53 prej tyre disponojnë licenca të vlefshme, ndërkohë që mbeten 5 shoqëri të pa licencuara. Arsyet e mos licencimit janë të ndryshme si neglizhencë nga vetë shoqëritë UK siç është rasti i UK Klos e cila ende nuk ka krijuar shoqërinë e saj aksionare sipas VKM Nr.63 dhe vijon të mbetet departament/ndërmarrje pranë bashkisë Klos, por kryesisht vjen si rezultat i mungesës së pajisjes me Akt Miratimin Higjieno-Sanitar nga Inspektorati Shëndetësorë Shtetëror.

ERRU ka adresuar vazhdimisht problematikën që mbart procesi i përfundimit nga shoqëritë UK të Akt Miratimit Higjiëno-Sanitar si kusht i domosdoshëm për liqensimin e tyre nga ERRU. Edhe gjatë vitit 2021, ERRU, i është drejtuar përsëri me shkresë zyrtare Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për këtë çështje. Gjithashtu ka zhvilluar takime me Drejtorin e Programit të Ujit të GIZ, në lidhje me asistencën e nevojshme që mund të kërkohet për përmirësimet e mësipërme, nga ku është marrë premtimi për të përfshirë në buxhetin e vitit 2022 të GIZ. Me miratimin e reformës në sektor edhe kjo çështje duhet të marrë zgjidhje përfundimtare nisur dhe nga fakti se MIE parashikohet të jetë aksionere e shoqërive UK.

***Miratimi i
Tarifave të
Reja për
Shoqëritë UK***

Gjatë vitit 2021 nga ERRU janë miratuar tarifa të reja shërbimesh për 3 shoqëri UK, përkatësisht për UK Patos, UK Sarandë si dhe për UK Mallakastër. Gjithashtu KKRR ka marrë vendimet përkatëse për fillim procedure të aplikimit për nivel të ri tarifor edhe për 3 shoqëritë UK Bulqizë, UK Konispol dhe UK Kukës. Këto dy të fundit janë shoqëri që operojnë me tarifa të pa miratuara nga ERRU dhe me aplikimet përmbushin detyrimin ligjor në këtë drejtim.

UK Patos është një nga shoqëritë me performancën më të dobët financiare që mbulonte vetëm 25% të kostove të O&M. Tarifatat e reja të miratuara synojnë kryesisht përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë dhe mundëson pagimin e një pjesë të faturës së energjisë elektrike.

UK Sarandë ka aplikuar për herë të parë pas riorganizimit për tarifa të reja e të unifikuara për të dyja zonat Ksamil dhe Sarandë. Tarifatat e reja të miratuara mundësojnë mbulimin mbi 100% të kostove të O&M, interesat e kredive të marra, si dhe pjesërisht kostot e amortizimit.

UK Mallakastër ka aplikuar për të miratuar tarifa për herë të parë për shkak të problemeve që kanë patur vazhdimisht me licencimin. Me tarifatat e reja të miratuara përmbushet detyrimi ligjor që shoqëria duhet të operojë sipas tarifave të miratuara nga ERRU, si edhe synohet përmirësimi i gjendjes financiare duke mbuluar rreth 61% të kostove të O&M.

***Planet e
Biznesit 5
Vjeçare si
Instrument i
Përmirësimit
të Menaxhimit
të Shoqërive
UK***

Planet e Biznesit 5 vjeçar shërbejnë si instrument për përmirësimin e menaxhimit të shoqërive UK në të cilat planifikohen veprimet e nevojshme për të përmirësuar Treguesit Kryesorë të Performancës. Aktualisht në sektor disponojnë plane të biznesit 5 vjeçar kryesisht shoqëritë UK të mëdha dhe të mesme. Metodologjia e re e tarifave të aprovuar nga ERRU në dhjetor 2021, e ka vendosur si kusht dokumentin e planit të biznesit 5-vjeçar për shoqëritë që aplikojnë për tarifa me target mbulimin deri 100% të Kostove Kapitale të aktivitetit. Mungesa e planeve 5 vjeçare të biznesit është evidente kryesisht për shoqëritë e vogla, të cilat nuk kanë kapacitete dhe mjetet e duhura financiare për realizimin e tyre. ERRU në kuadrin e projektit të Modernizimit të Sektorit financiar nga Banka Botërore do të hartojë modelin e unifikuar të planit të biznesit 5 vjeçar, si dhe të udhëzuesit përkatës për këtë qëllim.

Efiçenca e Energjisë Elektrike, Sfidë e sektorit UK për Menaxhimin e saj

Kriza globale energjetike ka prekur direkt edhe sektorin UK. ERRU në vitin 2021 ka realizuar studimin “Mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë nga Shoqëritë UK” që është edhe pjesë e këtij Raporti në kapitullin “Tema e Veçantë”. Qëllimi i studimit analizon gjendjen debitorë të shoqërive UK për pagesën e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së, të faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënia e rekomandimeve për mundësinë për rritjen e aftësisë financiare të shoqërive UK për të bërë të mundur pagesën e faturës së energjisë elektrike, si dhe të detyrimeve të prapambetura ndaj OSHEE-së. Studimi konstatoi se qasja për zgjidhjen e kësaj problematike qëndron në rritjen e efiçencës së përdorimit të energjisë elektrike, përmirësimit të TKP të shoqërive UK në tërësi, aplikimi i një plani të ri tarifor për shërbimet UK, si edhe subvencionimi pjesërisht/plotësisht nga buxheti i shtetit. Studimi analizoi në veçanti problematikën për 6 Shoqëri UK përkatësisht, Durrës, Vlorë, Patos, Kavajë, Krujë dhe Kurbin të cilat përfaqësonin rreth 65% të detyrimit total për energjinë elektrike ndaj OSHEE.

Kosto e energjisë elektrike edhe për vitin 2021 mbetet zëri i dytë pas kostove të punës me peshën më të madhe në kostot O&M të shoqërive UK me rreth 29% në totalin e këtyre kostove. Në vitin 2021 kostot e energjisë elektrike janë rritur me 8% nga rritja e konsumit me sasinë 12.2 milion kw krahasuar me vitin 2020. Ndikimin e ka dhënë UK Durrës për shkak edhe të hyrjes në funksion të sistemit të ri të furnizimit me ujë nga burimet e Fushë Milotit në vitin 2021 me një prurje prej 637 litra/sek. Gjithashtu ndikim ka dhënë kriza e energjisë elektrike e reflektuar në 4 muajt e fundit të vitit 2021, sipas të cilës shoqëritë UK që furnizohen me energji 35KV, faturohen nga OSHEE me tarifa të liberalizuara të tregut. Realisht në fund të viti 2021 rreth 80% e shoqërive UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot O&M, si rrjedhojë edhe detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së vazhdojnë të akumulohen.

Nisur nga pritshmëria e rritjes së çmimit për njësi të energjisë elektrike, gjatë vitit 2022 priten vendime të veçanta nga qeveria qendrore në lidhje me tarifat e energjisë elektrike për shoqëritë UK për një situatë që pritët të ketë kohëzgjatje të paparashikuar.

Metodologjia e re e Vendosjes së Tarifave Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Në fund të vitit 2021 ERRU aprovoi metodologjinë e re të vendosjes së tarifave për shërbimet e UK. Metodologjia e re i përgjigjet më mirë kërkesave aktuale dhe të perspektivës së sektorit, dhe ka përmirësime në drejtim të procesit të analizës, të nxitjes për hartimin e planit të menaxhimit të aseteve, rishikimin normave të amortizimit dhe TKP, vendosjen e kriterëve për saktësinë e të dhënave, të periudhës rregullatore, rikonceptim dhe detajim i zbatimit të kriterit të Përbalueshmërisë dhe të aplikimit të tarifave me blloqe për ruajtjen e burimeve natyrore të ujit.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave, si kusht i domosdoshëm për një analizë objektive të performancës së sektorit dhe të vendosjes së objektivave në të ardhmen. Në metodologjinë e re të tarifave ka një kapitull të veçantë “Sistemet e Informacionit” ku paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat specifike për mbajtjen e informacionit të krijuar nga shoqëria kur aplikojnë për tarifa të reja. Për verifikimin dhe saktësinë e të dhënave me të cilat është hartuar edhe raporti i performancës 2021, ERRU, ka realizuar takime të drejtpërdrejta në terren me 30 shoqëri UK me probleme të saktësisë së të dhënave. Këto takime kanë shërbyer gjithashtu për trajnimin e stafeve në plotësimin e saktë dhe korrekt të formularit të data bazës.

Investimet në Sektorin UK dhe Impakti i Tyre

Investimet nga buxheti i shtetit për vitin 2021 nëpërmjet AKUM-it, kryesisht kanë qenë të orientuara për përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë për qendrat urbane, si projekte të reja dhe ato në vazhdim. Kjo në vijim të objektivit afat shkurtër që ka ndërmarrë qeveria qendrore ku përmes investimeve synohet të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë pa ndërprerje për 58 qendra urbane, nga 66 të tilla deri në fund të vitit 2023. Tabela e mëposhtme jep investimet e planifikuara në sektorin UK financiar nga AKUM dhe nga burime të huaja për periudhën 2020-2023.

Përshkrimi	Vlera Totale e Investimit 2020-2023 (ne Lekë)	Vlera e Financuar për Vitin 2021 (ne Lekë)
Investime nga AKUM	18,531,262,514	946,000,000
Investime të Huaja	1,744,917,279	2,600,000,000
TVSH	4,055,235,959	709,200,000
TOTALI	24,331,415,752 (eq. 196 milion euro)	4,255,200,000 (eq. 35 milion euro)

Burimi: AKUM

Investimet fizike nga buxheti i shtetit në sektorin e ujësjellës kanalizimeve për vitin 2021 kanë pësuar një rënie në krahasim me vitet e mëparshme, pasi gjatë vitit 2021 në total janë disbursuar vetëm 946 milion lekë (rreth 7,8 milion euro). Me anë të tyre u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për **konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 5 qendra urbane, përkatësisht Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj duke e çuar kështu në 27 numrin total të zonave me regjim 24/7 deri në fund të vitit 2021.**

Gjithashtu në sektor është investuar edhe nga donatorët e huaj, në vlerën e 2.6 miliard lekë ose rreth 21 milion euro kryesisht nga BE dhe KfW. Gjithsesi krahasuar me vitet e mëparshme këto investime kanë qenë në vlerë më të ulët. Investimet fizike nga donatorët kanë konsistuar kryesisht në financimin e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III, IV dhe V (rreth 90% e totalit) që përmbledh 8 qytete të Shqipërisë, përkatësisht, Shkodër, Lezhë, Kamëz, Elbasan, Berat, Kuçovë, Vlorë dhe Fier. Ndërkohë që pjesa tjetër e financimit është investuar në projekte të tjera në një shkallë më të vogël, si për rehabilitimin e rrjetit hidrik të Tiranës etj.

Theksohet fakti se investimet në drejtim të kanalizimeve të ujërave të ndotura mbeten akoma një sfidë për tu arritur në të ardhmen pasi mbulimi i sektorit me kanalizime në rang kombëtar për vitin 2021 mbetet akoma shumë i ulët në masën e 52%.

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor gjatë vitit 2021 u përzgjedhën katër Tregues Kryesorë të Performancës, të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe të cilësisë së shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht, Mbulimi i Kostove të O&M, Norma Korrente e Arkëtimit, Uji Pa të Ardhura dhe Vazhdimësia (Orët) e Furnizimit me Ujë. Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm shoqëria me performancën më të mirë gjatë vitit 2021 u rendit Shoqëria UK Lezhë e ndjekur nga Shoqëritë UK Korçë dhe UK Gramsh ndërsa shoqëritë me performancë me të dobët në sektor u klasifikuan shoqëritë UK Selenicë, U Has, dhe UK Vau Dejës (shih Aneks 7, tabela 40).

Një klasifikim tjetër për performancën më të mirë u realizua edhe bazuar sipas ndarjes në tre grupe të shoqërive UK që i referohen numrit të lidhjeve që ato administrojnë, ku ndër shoqëritë e vogla (grupi i III-të) e para u klasifikua shoqëria UK Konispol (shih Aneks 8, tabela 41)

KONKLUZIONE, REKOMANDIME

- Problemet e mungesave të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara pranë ERRU-së për mjaft shoqëri UK, kërkon rritjen e përgjegjshmërisë së stafëve drejtuese të shoqërive UK në respektim të procedurave për saktësinë e të dhënave të përcaktuara në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave të shërbimeve UK.
- Rritja e kostove të energjisë elektrike edhe për vitin 2021 me 8%, kërkon një vëmendje të shtuar nga shoqëritë UK, kryesisht atyre me skema të furnizimit me ujë me ngritje mekanike. Nevoja për marrjen e masave për menaxhimin e kostove të energjisë merr rëndësi të veçantë në kushtet e krizës globale të energjisë e cila pritët të shoqërohet me rritjen e çmimit të energjisë. Këto masa do të konsistojnë kryesisht në rritjen e efijencës së energjisë elektrike bazuar në raporte studimi me këtë subjekt.
- Veçanërisht shoqëritë problematike ndaj pagesës së faturës së energjisë elektrike, të merret në konsideratë firmosja e një kontrate performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos të UPA, Normës Korrente të Arkëtimit dhe Efijencës së Stafit.
- Duhet të aktivizohet dhe të nënshkruhen Kontratat e Performancës ndërmjet AKUM-it dhe Bashkive/Shoqërive UK në të cilat realizimi i objektivave të TKP duhet të shërbejnë si element bazë për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.
- Duke patur parasysh rolin kyç të Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë në menaxhim për përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë, rekrutimi dhe ose vazhdimësia në detyrë e të cilëve duhet të bëhet bazuar në një kontratë performance të firmosur nga kryetari i Këshillit Administrativ të shoqërisë dhe Drejtorit Ekzekutiv me objektiva konkrete.
- Efijenca e stafit në nivelin 5.37 punonjës për 1000 lidhje UK, paraqitet në nivele të larta ku për vitin 2021 konstatohet rritje e kostove të punës me 5% dhe që zënë 33% në kostot operacionale të shoqërisë. Shoqëritë UK duhet të marrin në konsideratë bazuar në një analizë të detajuar të organigramave dhe pozicioneve të punës për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj. ERRU në veçanti do ta trajtojë këtë problem kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja të shërbimeve.
- Në lidhje me problemin e garantimit të sigurtisë së veprave të furnizimit me ujë si objekte të rëndësishme të veçantë duhet përshtatur legjislacioni në fuqi për të mundësuar alternativën e garantimit të sigurtisë me mjete logjistike, si kamera të gërshtuara edhe me masa të tjera teknike, në mënyrë që të ulen kostot e pajustifikuara të stafit, apo të kontraktimit të palëve të treta për këto shërbime.

- Ujit Pa të Ardhura, 64.8% megjithëse ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2020, përsëri mbetet problem serioz për sektorin UK dhe me elementë të konsiderueshme të pasaktësisë së matjes së sasisë së ujit të prodhuar dhe më tej. Në kuadër të reformës së re të sektorit UK, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet instalimit të matësve të ujit në burim dhe tek konsumatorët privat dhe familjarë në mënyrë që të hartohen bilancet e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Planet e Biznesit 5-vjeçarë si dhe Planet e Menaxhimit të Aseteve si një domosdoshmëri për shoqëritë UK, duhet të jenë në fokus kryesorë të reformës në sektor për shoqëritë e agreguara.
- Në kuadër të reformës mbi agregimin e sektorit për përmirësimin e performancës së tij në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare, të vijohet sa më parë me konkretizimin e këtij procesi përsa i përket formës dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore për realizimin e saj.

Hyrje

Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në sektor përbën një tjetër detyrim ligjor të ERRU-së. Raporti i Performancës së shoqërive UK për vitin 2021 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektor. Raporti jep një pasqyrë të sektorit krahasuar me vitin paraardhës (benchmarking) dhe tendencën e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri bazuar në një analizë dhe vlerësim sa më objektiv të performancës së sektorit. Gjithashtu raporti jep konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të shoqërive UK dhe në të njëjtën kohë shërben si një mjet për shoqëritë UK për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK.

Raporti përshkruan dhe analizon në mënyrë strikte performancën dhe zhvillimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve dhe të çdo shoqërie UK brenda periudhës kalendarike 1 janar - 31 dhjetor 2021. Hartimi i raportit realizohet mbasi ERRU ka marrë në fund të marsit të vitit pasardhës të dhënat financiare të vitit 2021 nga shoqëritë UK të certifikuara nga një auditues i autorizuar, si dhe të dhëna të tjera tekniko-operative të shoqërive UK të cilat grumbullohen dhe përpunohen nga sektori i monitorimit pranë ERRU-së. Gjatë periudhës mbas janarit të vitit pasardhës (2022) kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme institucionale në sektor, por ato nuk pasqyrohen në këtë raport.

Nisur nga rëndësia e analizës, konkluzioneve dhe rekomandimeve që jepen në Raport për përmirësimin e performancës së Sektorit UK, ERRU, ka intensifikuar punën e tij në monitorimin e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK duke zhvilluar takime të drejtpërdrejta me stafet teknike të shoqërive me qëllim saktësinë dhe konfirmimin e tyre.

Në këtë drejtim janë zhvilluar takime me 30 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor që paraqesin probleme në lidhje me raportimin dhe saktësinë e të dhënave për verifikimin në vend të tyre.

Duke patur parasysh afatin kohorë të kufizuar për publikimin e raportit, ku ERRU për të katërtin vit radhazi ka bërë përpjekjet maksimale që raporti të jetë i publikuar në fund të Qershorit 2022 në mënyre që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2021.

Gjendja e performancës së sektorit UK për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, përgjithësisht paraqet tendencë të lehtë pozitive pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesi "Mbulimi i kostove Totale" i cili ka një përkeqësim të vogël me 1% dhe Efienca e Stafit përkeqësuar me 0.05 punonjës/1000 lidhje UK.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M ka një përmirësim të lehtë, por sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it pasi 46 nga totali prej 58 shoqëri UK që operojnë në sektor nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M. Normat e Arkëtimit "Korrente dhe të Përgjithshme" të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2020.

Përmirësim të ndjeshëm paraqet edhe treguesi i "Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" i cili në mbyllje të vitit 2021 rezulton mesatarisht 15.4 orë/ditë, si dhe treguesi Niveli i Matjes (80.7%) të cilët lidhen direkt me cilësinë e shërbimit që u ofrohet konsumatorëve. Gjithashtu të përmirësuar janë edhe Treguesit "Uji Pa

të Ardhura” në nivelin e 64.8%, por përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe shumë larg objektivit të vendosur nga ERRU për këtë tregues, ndërsa treguesit Mbulimi me Ujë është në vlerën 77.6% dhe Mbulimi me Kanalizime me 52%.

Përgjithësisht përmirësimi i gjendjes së sektorit UK për vitin 2021, edhe pse në nivele jo shumë të larta ka treguar stabilitet duke patur parasysh faktorin Covid-19 që ka qenë prezent edhe gjatë këtij viti. Shoqëritë UK kanë përmirësuar menaxhimin si në rritjen e faturimit, arkëtimeve të faturave të vitit, dhe atyre të prapambetura, instalimit të matësve individuale, dhe për një ulje sado të vogël të humbjeve.

Problematikë për sektorin mbeten edhe detyrimet ndaj OSHEE, kjo pasi rreth 80% e shoqërive UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara si rrjedhojë detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së akumulohen çdo vit duke shtuar llogaritë e pagueshme edhe pse qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë shoqëritë UK. ERRU, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë kësaj problematike duke realizuar dhe “Studimi mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë nga Shoqëritë UK” i cili u realizua nga ERRU gjatë vitit 2021 dhe është pjesë e këtij Raporti në kapitullin “Tema e Veçantë”

Përmirësimi i situatës në drejtim të shlyerjes së detyrimeve ndaj OSHEE kërkon domosdoshmërisht zgjidhje në nivel të qeverisë qendrore pasi është e pamundur që ajo të realizohet vetëm me anë të rritjes së tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duke patur parasysh se duke filluar nga viti 2021 shoqëritë priten të përballen me rritje të çmimit të energjisë në bursat ndërkombëtare. Megjithatë qeveria për vitin 2021 ka alokuar subvencione me destinacion vetëm për pagesat e energjisë elektrike përsëri këto subvencione kanë qenë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura pasi janë përdorur vetëm për faturat e vitit.

Në vijim të objektivit afat shkurtër të qeverisë qendrore për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë 24 orë deri në vitin 2023 për 58 nga 66 qendra urbane, projekt që ka filluar të zbatohet që në vitin 2018, deri në mbyllje të vitit 2021 janë shtuar edhe 5 qendra urbane me furnizimin me ujë 24/7 përkatësisht Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj duke e çuar kështu në 27 numrin e qyteteve që kanë cilësi të lartë të shërbimit të furnizimit me ujë. Impakt ky i cili është reflektuar edhe në treguesin e Kohëzgjatjes mesatare të Furnizimit me Ujë 15.4 orë/ditë për të gjithë sektorin me +1.6 orë/ditë.

Viti 2021 është viti në të cilin qeveria qendrore ka shtruar platformën për reformimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve ku me anë të agregimit si ekonomi e shkallës konsiderohet qasja kryesore për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërive dhe sektorit, si edhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve. Gjatë vitit 2022 pritet të fillojë zbatimin e reformës me aktet dhe nënaktet ligjore përkatëse të domosdoshme për realizimin e saj.

Në këtë kuadër ERRU dhe në përgjigje të kërkesave aktuale dhe të perspektivës së sektorit ka hartuar edhe metodologjinë e re të vendosjes së tarifave që merr parasysh edhe rastet që shoqëritë me të ardhurat nga aktiviteti të mund të mbulojnë pjesërisht ose plotësisht nevojat e kostove totale. Në këtë rast hartimi i planeve të biznesit 5 vjeçare dhe raportimi i të dhënave të plota dhe me saktësinë e kërkuar merr rëndësi të veçantë.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës së sektorit UK kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve në sektor, përkatësisht shoqëritë UK, bashkitë, qeveria qendrore dhe të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm të sektorit.

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit Ujësjellës Kanalizime për vitin 2021 jepet përmes 10 treguesve të performancës të marrë në analizë nga ERRU të paraqitura në Tabelën 1. Në të jepet tendenca e saj krahasuar me vitin 2020 si dhe objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela 1. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitet 2020,2021

Nr.	Treguesit e Performancës	2020	2021	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	65.4	64.8	↗	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	103.2	103.4	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	74.9	73.9	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	89.8	92.3	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korrente(%)	76.6	77.6	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	79.6	80.7	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.32	5.37/4.9*	↘	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	13.8	15.4	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	51.5	52	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.1	76.8	↗	n/a

Burimi: ERRU

** Efiçenca e Stafit 5.37 staf për 1000 lidhje përfshin edhe personelin roje të nënkontraktuar me subjekte private ndërsa 4.9 staf për 1000 lidhje UK nuk përfshinë këto të fundit.*

Nga tabela e mësipërme vërehet që nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 përgjithësisht kanë tendencë pozitive të lehtë pothuajse në të gjithë treguesit. Treguesi "Mbulimi i Kostove Totale" ka një përkeqësim të vogël me (-1%), i cili krahasuar me vitin 2020 ka ardhur nga rënia e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura nga ana e shoqërisë për subjektet debitore në të kaluarën.

Treguesi "Efiçenca e Stafit" në nivelin 5.37 punonjës për 1000 lidhje UK, paraqitet në nivele të larta ku për vitin 2021 konstatohet rritje e kostove të punës me 5% dhe që zënë 33% në kostot operacionale të shoqërisë. Ky tregues paraqitet me një përkeqësim të lehtë sepse shtimi i numrit me 119 punonjës në sektor nuk ka arritur të balancojë rritjen e numrit total prej 21,105 lidhje të reja ujësjellës kanalizimeve. Normat e Arkëtimit "Korrente dhe të Përgjithshme" të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2020.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M me një përmirësim të lehtë paraqitet në nivel performance të mirë sipas referencës së ERRU. Vlera prej 103,4% e këtij treguesi tregon në dukje një gjendje "optimiste", por në fakt vetëm 12 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M, domethënë që sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore. Rezultatja del pozitive për sektorin sepse mjaft nga shoqëritë e mëdha duke filluar që nga UK Korçë, Tiranë, Berat Kuçovë arrijnë ti mbulojnë kostot e O&M mbi 100%.

Treguesi “Mbulimi i Kostove Totale” është përkeqësuar për vitin 2021, nga 74.9% në 73.9%. Kjo situatë konsiderohet normale sepse në fakt mbledhja e detyrimeve të prapambetura me kalimin e kohës bëhet gjithnjë e më e vështirë sepse në përgjithësi mbeten debitorë subjekte të falimentuara, ato me ndihmë ekonomike etj.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve që lidhet me “Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë” i cili është 15.4 orë/ditë, paraqet një përmirësim të ndjeshëm.

Treguesi “Uji Pa të Ardhura” në nivelin e 64.8% ka një përmirësim të lehtë, por përsëri mbetet në nivele shumë të larta dhe shumë larg objektivit të vendosur nga ERRU për këtë tregues.

Treguesi i “Nivelin e Matjes” (80.7%) që lidhet me faturimin e saktë të konsumatorëve për sasinë e ujit që ato konsumojnë ka përmirësim krahasuar me vitin 2020. Një përmirësim i lehtë vërehet edhe për treguesit e “Mbulimit me Ujë dhe Kanalizime”.

ERRU në përputhje me kërkesat bashkëkohore të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK dhe të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve i ka dhënë një rëndësi të veçantë përcaktimit dhe vlerësimit të treguesve kryesorë të performancës të sektorit dhe të shoqërive në veçanti. Në këtë kuadër në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave aprovuar në dhjetor 2021 ka rishikuar indikatorët kryesorë të performancës duke përfshirë në të edhe treguesit e “Eficiencës së Energjisë” dhe të “Ankesave të Konsumatorëve” ndaj shoqërisë UK. Rëndësi të veçantë i është kushtuar gjithashtu bazës së të dhënave të raportuara, saktësisë dhe mënyrës së llogaritjes së TKP, të cilat do të jenë pjesë e ndryshimeve që do të reflektohen në raportin e performancës për vitin 2022 për një vlerësim sa më real (benchmarking) të sektorit në përgjithësi dhe secilës shoqëri UK në veçanti.

Më poshtë analizohen në detaje për të gjithë sektorin secili nga Treguesit Kryesor të Performancës.

1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Gjatë vitit 2021, 58 shoqëri UK që operojnë në sektor prodhuan në total 311.2 milion m³ nga të cilat 59% me ngritje mekanike dhe 41% me vetërrjedhje. Faturimi Total në nivelin 35,2% raportohet në nivele të ulta edhe si pasojë e faturimit aforfe sidomos për konsumatorët në zona rurale të cilët e përdorin ujin e pijshëm për vaditje ndërsa faturohen litra/ditë/banor.

Gjatë shfrytëzimit të sistemeve të furnizimit me ujë, humbjet e ujit janë një pengesë e konsiderueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive UK. Përmirësimi i Treguesit UPA nëpërmjet performancës në rritje dhe uljes së kostove operative është rrugëzgjdhja për të patur përmirësim të dukshëm të tij.

Treguesi UPA vazhdon të mbetet në nivele të larta e të papranueshme ndonëse është përmirësuar me 0.6%. Kjo ka ardhur nga ndikimi negativ i faktorëve, si “lidhje të paligjshme”, “faturimi aforfe”, “sistemet e vjetra” të zonave rurale pjesë e zonës së shërbimit të shoqërive UK, si dhe lëvizja e kufizuar si pasojë e Pandemisë së COVID 19.

Matja e prodhimit në nivelin rreth 50% në burim, si pasojë e mungesës së matësve në to, ka bërë që gjatë vlerësimit të treguesit UPA të ketë pasaktësi, kjo gjë konstatohet sidomos në Bilancet e Ujit të analizuara për çdo shoqëri UK.

Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2021 është 64.8%, performuan nën kufirin 30% të performancës së mirë pesë shoqëri UK, 18 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 35 të tjera performuan mbi kufirin 50% të Benchmarking.

Niveli i lartë i UPA, i cili ndikon direkt në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, mbetet shqetësimi kryesor për rregullatorin i cili vazhdimisht këmbëngul në “Hartimin e planeve të biznesit” dhe përfshirjen në to të planeve të veprimit për të reduktuar humbjet komerciale (dukshme) dhe ato teknike (reale).

Bilanci i Ujit, si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative, për orientimin e shoqërive drejt përmirësimit të treguesit “Uji Pa të Ardhura”, mbetet në fokusin e rregullatorit, i cili harton çdo vit dhe raportin e Bilancit të Ujit ku shoqëritë njihen mbi nivelin e humbjeve të çdo shoqërie dhe të sektorit UK në tërësi. ERRU konstaton se disa nga shoqëritë UK e kanë të nevojshme rritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve, lidhur me menaxhimin më të mirë të sistemeve të furnizimit për reduktimin e UPA si dhe mbi njohjen në tërësi të rrugëve për reduktimin e tyre. Rrjetet shpërndarëse në sektor kërkojnë që të jenë të seksionuara me zona të mbyllura të matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike të tyre që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve dhe përcaktojnë masat për zvogëlimin e tyre.

Sfidë e sektorit për përmirësimin e treguesit Uji Pa të Ardhura mbetet ulja e humbjeve administrative dhe fizike të cilat ndikojnë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, si dhe rritjen e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë (objektivi i furnizimit me ujë 24/7) si dhe në mbrojtjen e burimeve ujore nga mbi konsumi.

Përmirësimi i situatës teknike të sistemeve të vjetruara të furnizimit, saktësimi i të dhënave mujore dhe vjetore, zbulimi dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, rritja e faturimit mbeten instrumentet kryesore në reduktimin e UPA për çdo shoqëri UK.

1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Treguesit financiarë të performancës si Mbulimi i Kostove O&M dhe Totale kanë një rëndësi themelore për qëndrueshmërinë financiare në sektor. Performanca në sektor, për vitin 2021, lidhur me këta tregues, ka qenë pothuajse në të njëjtat nivele me një përmirësim të lehtë me +0,16% për treguesin e Mbulimit të Kostove O&M krahasuar me vitin 2020, si dhe me një përkeqësim të lehtë me -1% të Mbulimit të Kostove Totale. Përkeqësimi i këtij të fundit është i pritshëm sepse rikuperimi i borxheve të prapambetura bëhet gjithnjë e më i vështirë për tu mbledhur për shkak të falimentimit të subjekteve debitorë dhe të familjeve me status të ndihmës ekonomike. Kostot e Operim & Mirëmbajtjes kanë një rritje me rreth 118 milion, që vjen kryesisht nga rritja e kostove të punës dhe të energjisë elektrike, ndërsa Kostot Totale kanë një rritje me 256 milion lekë, që vjen nga rritja e kostove të amortizimit, për shkak të shtimit të aktiveve të shoqërive si rezultat i përfundimit të investimeve të bëra me qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerje për zonat urbane.

Të ardhurat e aktivitetit dhe të tjera janë rritur me 137 milion lekë, e cila ka ndikuar në ruajtjen e niveleve të treguesve të mbulimit të kostove.

Tabela 2 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2020 dhe 2021 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela 2. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2020 e 2021 (në 000 lekë)

Nr.	Kostot e Shërbimit UK	Viti 2020 në 000 lekë	Viti 2021			Diferenca 2021-2020 në 000 lekë	Rritja/Rënia 2021/2020 në %
			në 000 lekë	Ndaj Kostove O&M (%)	Ndaj Kostove Totale (%)		
1	Kosto e punës	4,300,480	4,521,714	47%	33%	221,234	5%
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,592,311	2,799,804	29%	21%	207,494	8%
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	499,668	439,757	5%	3%	(59,911)	-12%
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	1,001,599	685,350	7%	5%	(316,248)	-32%
5	Kosto e materialeve kimikate	233,679	265,968	3%	2%	32,289	14%
6	Kosto të tjera	914,753	947,889	10%	7%	33,136	4%
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,542,489	9,660,482	100%	71%	117,994	1%
7	Kostot e Amortizimit	2,595,284	3,021,227		22%	425,943	16%
8	Kosto financiare, taksa tatime	1,011,344	841,664		6%	(169,680)	-17%
	Kostot Kapitale	3,606,628	3,862,892		29%	256,263	7%
	Kostot Totale	13,149,117	13,523,374		100%	374,257	3%

Ritmi i rritjes së Kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes ka rënë në 1% krahasuar me vitin 2020 që ka qenë 5%, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 11%.

Konstatohet se, për vitin 2021, Kostot e O&M të sektorit UK janë rritur me vlerën 117,994 milion lekë, të cilat ndikohen kryesisht nga rritja e pothuajse të gjitha kostove operative të UK Durrës, të cilat në total rriten me rreth 200.4 milion lekë që vijnë kryesisht nga futja në punë e sistemit të dytë të furnizimit me ujë nga Fushë Miloti me një prurje prej 637 litra/sek. Më pas renditet UK Kamëz me 69.3 milion lekë dhe UK Vlorë me 63.2 milion lekë.

Krahasuar me një vit më parë, megjithëse kostot operative në sektor rriten, për 27 shoqëri UK këto kosto reduktohen, ku ndikimin kryesor e reflekton UK Tiranë, e cila redukton kostot operative me 240 milion lekë.

Të gjithë zërat që përbëjnë totalin e kostove operative të sektorit janë në rritje me përjashtim të Kostos së Riparim Mirëmbajtjes, e cila ka rënie me -12% dhe Kostos së Shërbimeve të Kontraktuara, e cila ka rënie me -32%.

Rritje të konsiderueshme ka shënuar zëri “Kosto e Punës” me +221,2 milion lekë, “Kosto e energjisë së konsumuar” me +207.5 milion lekë, “Kosto e materialeve kimikate” +32.3 milion lekë.

Me rritje paraqitet edhe zëri “Kosto të Tjera” (+33.1 milion lekë) në të cilin shoqëritë përfshijnë kostot të cilat nuk janë të pasqyruar në zërat e tjerë të cituar më lart, si kostot për pagesat rregullatore dhe detyrime të prapambetura ndaj ERRU, SHUKALB-it, Këshillave të Administrimit, tarifatat ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, kostot për nxjerrjet jashtë përdorimit, vendimet gjyqësore etj.

Në detaje analiza për secilin zë të kostos të paraqitur në Tabelën 2 jepet si më poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2021 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 8,616 punonjësish (punonjësit e vet dhe nënkontraktorët) nga 8,425 punonjës që janë raportuar në vitin 2020, pra ka rritur stafin me 191 punonjës.

Rritja e numrit të punonjësve vjen për shkak të specifikave të operimit dhe ofrimit të shërbimit, zgjerimit të zonave të shërbimit, zbatimit të projekteve të ndryshme UK apo edhe për shkak të garantimit të sigurisë së veprave me personel roje.

Shoqëritë që kanë rritur ndjeshëm numrin e punonjësve janë UK Tiranë me 69 punonjës, për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, UK Elbasan me 93 punonjës nga të cilët 50 punonjës kryesisht në pozicionin Task Forcë dhe Juristë dhe 43 punonjës të nënkontraktuar për shërbimin e rojeve si dhe UK Kamëz me 51 punonjës për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit edhe me 5,000 abonentë të rinj. Nga ana tjetër janë shumë shoqëri që kanë reduktuar stafin operues, ndër to veçohen UK Fier dhe UK Vlorë, të cilët kanë rishikuar strukturën e punonjësve dhe kanë reduktuar përkatësisht me 73 punonjës dhe me 34 punonjës.

Rritja e kostove të punës me rreth 221.2 milion lekë ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të stafit por edhe ndryshimeve ligjore të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi nga 26,000 lekë në 30,000 lekë.

Për secilën shoqëri ERRU kërkon të analizohen hollësisht numri i punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune, megjithatë sektori vazhdon të jetë i mbingarkuar me staf të pajustifikuar. ERRU analizon në mënyrë të detajuar organigramën e stafit veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor.

Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafet menaxhuese të shoqërive UK pasi kostot e punës përbejnë peshën më të madhe në totalin e kostove operacionale në sektor, e cila këtë vit zë 47%. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë elektrike zënë rreth 29% në totalin e kostove të O&M. Pesha që zë kosto e energjisë elektrike e Grupit të I-rë është rreth 80% e totalit të kostos së energjisë elektrike të sektorit, ku kosto e UK Durrës jep dhe ndikimin kryesor zë rreth 38% të kostove të energjisë elektrike të këtij grupi dhe rreth 31% të kostove të energjisë elektrike të sektorit.

Konsumi i energjisë elektrike për të gjitha shërbimet është rritur me 12.2 milion KW krahasuar me vitin 2021, kështu që edhe kostot e energjisë elektrike janë rritur me 8%. Gjithashtu ndikim ka dhënë kriza e energjisë elektrike e reflektuar në 4 muajt e fundit të vitit 2021, sipas të cilës UK-të që furnizohen me energji 35KV faturohen nga OSHEE me tarifa të liberalizuara të tregut, ku ndikimin më të madh e jep UK Durrës, ku përveç faturimit të liberalizuar për sistemin 35KV influencon dhe sistemi i ri i furnizimit me ujë nga Fushë Miloti i futur në punë në vitin 2021.

Kostot e energjisë për vitin 2021 për shoqëritë raportohen rreth 207.5 milion lekë më të larta se viti 2020. Ndikimin kryesor në rritjen e kostove të energjisë e ka dhënë UK Durrës i cili ka rritur kostot e energjisë me 191 milion lekë për arsyet e përmendura me sipër. Gjithashtu rritje të kostove të energjisë elektrike kanë pasur edhe UK Fier (30 milion lekë) dhe UK Sarandë (19.4 milion lekë). Konstatohet se vëllimi i ujit të prodhuar me ngritje mekanike në sektor është rritur me 1.5 milion m³.

Duke qenë se 80% e shoqërive UK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara, detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së akumulohen çdo vit duke shtuar llogaritë e pagueshme edhe pse qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë shoqëritë UK.

Pritet që çmimi për njësi i energjisë elektrike të ketë rritje dhe faturimet mund të bëhen me tarifa të liberalizuara sipas tregut kështu që edhe kostot e energjisë elektrike do të mbeten problematike sa kohë që shoqëritë nuk kanë kapacitete financiare për t'i mbuluar të gjitha kostot operative prandaj përballimi i kësaj situate nga shoqëritë UK duhet të trajtohet për zgjidhje përfundimtare nga qeveria qendrore.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2021 krahasuar me ato të vitit 2020 kanë rënë me 12% ose 60 milion lekë.

Reduktimi i kostove për këtë shërbim ka qenë i dukshëm sidomos për grupin e parë, të cilët përbejnë 80% të këtyre kostove dhe ndikimin kryesor e ka dhënë ulja e kostove të riparimeve për UK Tiranë me 44.9 milion lekë, UK Elbasan 27.6 milion lekë dhe UK Durrës 16.6 milion lekë. Reduktimi i këtyre kostove vjen si rezultat i investimeve të bëra në rrjetin e ujësjellësit.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara Kosto e shërbimeve të nënkontraktuara në vitin 2021 për sektorin UK është reduktuar me 316.2 milion lekë krahasuar me 2020. UK Tirane zë 58% në totali e këtyre kostove për sektorin, prandaj përgjysmimi i kostove për shërbimet e nënkontraktuara me 300 milion lekë nga UK Tiranë ka patur ndikimin kryesor në uljen e këtyre kostove në sektor.

Në këto kosto përfshihen shpenzime të tjera për shërbimet e kontraktuara që kryhen nga të tretët, por kostot për shërbimin e rojeve nga nënkontraktorët zënë pjesën më të madhe të tyre. Shoqëritë janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për sigurinë e komponentëve të furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, puse etj., të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë së shëndetit të popullsisë, kështu shërbimi i rojeve përveçse me punonjësit e vet kryhet me nënkontraktorë gjithmonë e më shumë.

Shoqëritë duhet të investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera të cilat sjellin reduktimin e këtyre kostove.

Kosto të Tjera. Kostot e tjera janë rritur me rreth 33.1 milion lekë krahasuar me kostot e vitit 2020. Rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2020 ka shënuar UK Kamëz (45 milion lekë), UK Durrës (23 milion lekë), UK Fier (17 milion lekë) etj.

Në këto kosto shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifat ndaj Agjencisë së Baseneve për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, shpenzime për penalitete dhe gjoba, shpenzime për konsulencë si dhe të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetik të kostove.

Kostot Kapitale. Kostot Kapitale përfshijnë kostot e Amortizimit dhe të Kredive. Referuar Tabelës 2 vërehet se këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 29% të totalit të kostove të sektorit. Kostot e amortizimit për vitin 2021 rezultojnë 425.9 milion lekë më të larta se viti 2021, e cila kryesisht ka ardhur nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet e bilanceve të shoqërive UK, ku ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e kostove të amortizimit për UK Kamëz me 288 milion lekë për shkak se në vitin 2021 është bërë raportimi edhe i aseteve të ndërmarrjes ekzistuese.

Kostot financiare, ku përfshihen kostot e interesave, kostot e taksave dhe tatimeve, provizione dhe zëri kosto financiare janë reduktuar me 169.6 milion lekë ku kryesisht ka ndikuar ulja e kostove për provizione me 116 milion lekë dhe ulja e kostove të interesave dhe principalit me 58 milion lekë. Kostot për interesa për vitin 2021 janë 299 milion lekë, por disa shoqëri nuk kanë mundësi financiare për të përballuar këto kosto.

Kostot Totale të aktivitetit të shoqërisë përbëhen nga Kostot O&M dhe Kostot Kapitale. Theksohet se sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale. Aktualisht janë 2 shoqëri, UK Tiranë, UK Kolonjë, që arrijnë që t'i mbulojnë pjesërisht.

Me të ardhurat e gjeneruara mbulohen vetëm 74% të shpenzimeve totale megjithatë ritmi i rritjes së kostove totale nga 4% në 3% tregon për qëndrueshmëri të nivelit të kostove për vitin 2021. Megjithatë për shkak të krizës energjetike, pritet që të ketë rritje të kostove të energjisë elektrike të cilat do të reflektojnë ndikimin e tyre në përkeqësimin e situatës financiare, e cila do të ulë treguesit financiarë të performancës si Mbulimi i Kostove OM dhe Totale. Për shkak të pamundësisë së likuiditetit për të shlyer kostot operative, kjo rritje mund duhet të reflektohet dhe në kërkesat e shoqërive për nivel të ri tarifor.

1.1.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit financiar më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK). NAP në përlllogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera gjatë gjithë vitit nga shoqëria, d.m.th. edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK përjashton këto të fundit, d.m.th. llogarit vetëm arkëtimet e kryera lidhur me të ardhurat e faturuara brenda vitit ushtrimor.

Aneks 2, tabela 35, jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2021 dhe krahasuar ato me vitin 2020. Norma e Arkëtimit Korrente për sektorin UK për vitin 2021 raportohet në nivelin 77.6 %, pra me një rritje të lehtë prej 1% krahasuar me vitin 2020. Ky tregues mund të mos jetë real pasi shumë shoqëri në kontabilizimin e arkëtimit korent përjashtojnë arkëtimet e vonuara në kohë, por që kryhen brenda vitit dhe i raportojnë si arkëtim i debive. NAP është më reale pasi e amortizon "gabimin" që konstatohet në NAK.

Shumica e shoqërive UK të sektorit për vitin 2021 kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2020. Shoqëritë UK që performojnë me normë të lartë arkëtimi korrent janë shoqëritë e bashkive Poliçan, Kamëz, Vorë, Gramsh, Lezhë, Maliq, Pogradec, Tiranë, Mat, Konispol, Mirditë, Himarë, Lushnjë, Mallakastër, Malësi e Madhe dhe Berat-Kuçovë.

Disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korrente të ulët janë UK Kukës, UK Librazhd, UK Roskovec, UK Tepelenë, UK Finiq, UK Memaliaj, UK Has.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2020 raportohet 92.3% nga 89.8% që ka qenë në vitin 2020. Gjatë vitit 2020 shoqëritë kanë arkëtuar rreth 1.4 miliard lekë debi të prapambetura, pra rreth 196 milion lekë më shumë se viti paraardhës. Shoqëritë janë munduar ta përmirësojnë këtë tregues me marrëveshjet midis shoqërisë dhe konsumatorit, sipas së cilës arkëtohen edhe debitë e vjetra krahas faturave korrente.

Përmirësimi i këtij treguesi lidhet me monitorimin e rregullt të arkëtimeve të klientëve moslejimin e krijimit të borxhit të keq, marrjen e masave për klientët që nuk paguajnë si edhe me shtimin e qendrave dhe mënyrave të pagesës së faturës.

1.1.4 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është një tregues i cili ka një përmirësim konstant çdo vit dhe për vitin 2021 është 80.7%, me një përmirësim (+1.1%), por konsiderohet ende larg objektivit të përcaktuar nga ERRU. Pas riorganizimit të shoqërive me ndarjen e re administrative, ky tregues ka patur luhatjet e veta në varësi të organizimit të shoqërive, pasi shumica e konsumatorëve të zonave rurale nuk kanë instaluar matësa individual.

Shoqëritë UK për vitin 2021 kanë raportuar instalimin e 25,986 matësve të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 743,709 lidhje nga 921,158 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë. Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 6,970 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësve, në kategorinë klientë jo familjarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM nr.96, datë 21.2.2007.

Në sektor ka disa shoqëri me nivel shumë të mirë të këtij treguesi mbi 85% si ato të bashkive Korçë, Durrës, Lushnje, Sarandë, Tiranë, Divjakë, Librazhd, Peqin, Rogozhinë, Pustec, Këlcyrë etj., por ka dhe shoqëri që e kanë këtë tregues nën nivelin 40%, si ato Libohovë, Dropull, Bulqizë, Kurbin, Skrapar dhe Patos.

Shoqëritë UK duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, në mënyrë që konsumatorët të paguajnë volumin real të ujit të konsumuar, por edhe për faktin se faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale e cila jep më pas impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore.

1.1.5 Efienca e Stafit

Efienca e Stafit është një tregues shumë i rëndësishëm pasi lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë peshën kryesore ndaj totalit të kostove. Për vitin 2021 për arsye krahasimi me vitin paraardhës ky tregues është paraqitur me dy të dhëna sipas tabelës së mësipërme. Konkretisht efienca e stafit për vitin 2021 është 5.37 punonjës për 1000 lidhje UK kundrejt 5.32 që ishte në vitin 2020. Në vlerësimin e këtij treguesi në këtë rast janë përfshirë stafet sipas organigramës së shoqërive, si dhe personeli roje i nënkontraktuar me subjekte private. Treguesi i efiençës së stafit pa përfshirë personelin roje të nënkontraktorëve është në nivelin e 4.9 punonjës për 1000 lidhje UK. Për të patur referencë të njëjtë krahasimi, kjo mënyrë llogaritje do të ndiqet nga ERRU në vitet në vijim pasi paraqet situatën reale të stafit i cili operon në shoqëri sipas organigramës e cila është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi. Ky tregues luhetet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Përkeqësimi i lehtë i efiençës së stafit për vitin 2021, vjen si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve me 191 punonjës kundrejt rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 19,016 lidhje dhe të lidhjeve me kanalizime me rreth 2,089 lidhje. Kjo nuk ka influencuar në përmirësimin e efiençës së stafit për shkak se numri i punonjësve është rritur më shumë krahasuar me numrin e nevojshëm të lidhjeve.

Vlen të theksohet se në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Efiçencës së Stafit. Faktor tjetër që influencon negativisht në këtë tregues janë punësimet e pajustificuara, gjë që kërkon një vëmendje të veçantë të analizës së stafit për vlerësimin real të këtij treguesi bazuar në organigramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj. Veçanërisht, kjo analizë bëhet e thelluar kur shoqëria aplikon pranë ERRU për nivel të ri tarifor.

1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Për sa i përket cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, përmes vazhdimësisë së shërbimit, performanca e sektorit ka qenë jo e mirë. Shumica dërrmuese e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë. Mesatarja e orëve të furnizimit për sektorin është rritur me 1.6 orë në ditë, krahasuar me vitin paraardhës duke arritur nivelin 15.4 orë/ditë, përsëri qëndron në një nivel më të ulët se sa objektivi prej 18 orë/ditë që ka vendosur ERRU.

Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit. Gjatë vitit 2021, ka vazhduar procesi i kryerjes dhe i përfundimit të investimeve kapitale të nisura nga Qeveria Qendrore, nëpërmjet AKUM-it, e cila ka në objektivin e saj që deri në fund të vitit 2023 nga 66 qendra urbane në vend, 58 prej tyre, do të kenë furnizim me ujë pa ndërprerje. Referuar të dhënave të AKUM-it, me anë të investimeve të kryera gjatë vitit 2021 u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 5 qendra urbane, përkatësisht Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj duke e çuar kështu në 27 numrin total të zonave me regjim 24/7 deri në fund të vitit 2021. Investimet në vazhdim pritet të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve që lidhen me këtë indikator. Ndërkohë, kohëzgjatja e furnizimit me ujë për zonën rurale përgjithësisht është më e ulët krahasuar me zonën urbane, kjo për arsye se investimet kapitale kanë qenë të drejtuara kryesisht në zonat urbane.

Megjithatë disa shoqëri paraqiten me nivel të papranueshëm të këtij treguesi dhe ofrojnë deri në 6 orë/ditë ujë, të tilla janë UK Dropull, UK Roskovec dhe UK Kurbin.

Shoqëritë UK gjatë raportimeve japin të dhëna për zonën urbane dhe zonat rurale që kanë furnizim me ujë 24 orë/ditë, por nuk bëjnë një llogaritje të orëve mesatare të furnizimit me ujë për të gjithë zonën e shërbimit të tyre në mënyrë analitike sipas zonave të ndara të shpërndarjes (DMA), por vetëm duke u nisur nga koha e shkarkimit të depove që furnizon rrjetin shpërndarës, e cila nuk është metoda e duhur për matjen dhe vlerësimin e tij.

Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit që lidhet dhe me rrezikun e cënimit të shëndetit të popullatës, prandaj shoqëritë UK duhet të kenë në fokus kryesor përmirësimin e këtij indikator.

1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN

Treguesit “Mbulimi me FU” dhe “Mbulimi me KUN” për vitin 2021 janë pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2021 me një rritje prej 0.7% për shërbimit FU dhe një rritje prej 0.5% për shërbimin KUN.

Shërbimi i furnizimit me Ujë ofrohet për 76.7% të popullsisë në juridiksion. Ky tregues ka një rritje të lehtë sepse popullsia në zonën e juridiksionit është shtuar me rreth 25 393 mijë banorë, ndërkohë që ajo e mbuluar me shërbimin e furnizimit me ujë raportohet të jetë shtuar me rreth 51 134 mijë banorë.

Shërbimi me kanalizime i ujërave të ndotura ofrohet për 33 505 banorë me tepër se në vitin 2020. Problemi kryesor vazhdon të mbetet Zona Rurale, në të cilën përgjithësisht nuk ka rrjet kanalizimesh dhe shkarkimet e ujërave të ndotura realizohen individualisht me gropa septike, por që lënë mjaft për të dëshiruar në drejtim të respektimit të standardeve teknike të zbatimit të tyre.

1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Rezultatet financiare për të gjitha shoqëritë UK janë me humbje përveç UK Tiranë dhe UK Kolonjë të cilat mbulojnë totalisht kostot operative dhe pjesërisht ato kapitale, ku përfshihen edhe ato për investime, me të ardhurat nga aktiviteti dhe të tjera.

Për vitin 2021 nga 58 shoqëri UK, 12 prej tyre, gjenerojnë të ardhurat e nevojshme për të shlyer vetëm kostot operative, ndërsa të gjitha shoqëritë të tjera u mbetet një pjesë e kostove operative për t'u financuar nga jashtë apo subvencionuar, në mënyrë që të mos ngarkohen llogaritë e pagueshme çdo vit. Gjatë vitit 2021 qeveria qendrore nëpërmjet AKUM ka shpërndarë 380 milion lekë subvencione, të cilat krahasuar me një vit më parë janë përgjysmuar për shkak se kanë qenë të dedikuara vetëm për kostot e energjisë elektrike.

Për vitin 2021 janë realizuar 9 987 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 137 milion lekë.

Në Aneks 3, tabela 36, paraqet nevojat reale për subvencione të shoqërive UK për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra për vitin 2021. Në këtë tabelë të ardhurat nga aktiviteti krahasohen me Kostot e O&M dhe Kostot Totale, gjithashtu paraqitet dhe rezultati financiar vjetor i shoqërive UK me humbje ose fitim.

Tabela 3 jep në mënyrë të përmbledhur të ardhurat për sektorin nga aktiviteti i shoqërive UK dhe nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it.

Tabela 3. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2020-2021 nga Aktiviteti dhe Subvencionet

Nr.	Emërtimi	Viti 2020 (në 000 lekë)	Viti 2021 (në 000 lekë)	Diferenca (në 000 lekë)
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,850,414	9,987,507	+137,093
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	720,000	380,000	-340,000
3	TOTALI	10,570,414	10,367,507	-202,907

Duke patur parasysh ndarjen e shoqërive në grupe, tabela 4 jep të dhënat mbi të Ardhurat e Sektorit për Vitet 2020-2021 të ndara sipas Grupeve të Shoqërive UK.

Tabela 4. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2019-2020 sipas Grupeve të Shoqërive UK

Nr.	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2021
		Grupi i I-rë (në 000 lekë)		Grupi i II-të (në 000 lekë)		Grupi i III-të (në 000 lekë)	
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	8,412,695	8,508,528	1,332,503	1,338,414	105,215	140,565
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	179,752	215,408	473,003	154,554	67,245	10,038
3	TOTALI	8,592,446	8,723,936	1,805,506	1,492,968	172,460	150,603
	Diferenca pa Subvencionet	+95,833		+5,911		+35,000	

Nga tabela e mësipërme vërehet se në shoqëritë e **Grupit të I-rë** të ardhurat janë rritur me 95.8 milion lekë. Shoqëri që kanë rritje të të ardhurave në Grupin e parë janë UK Fier (+84.4 milion lekë), kryesisht për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve, UK Sarandë (+53.8 milion lekë), për shkak të rritjes së nivelit të faturimit dhe unifikimit të nivelit tarifor për të dy zonat Ksamil dhe Sarandë dhe UK Lushnje (+40.1 milion lekë), për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve dhe nivelit të faturimit. Të tjera janë UK Vlorë (+39.6 milion lekë), UK Kamëz (+ 27.3 milion lekë), UK Berat-Kuçova (+19.5 milion lekë), UK Lezhë (+19.1 milion lekë), UK Elbasan (+11.9 milion lekë), UK Pogradec (11.8 milion lekë), UK Korçë (11.7 milion lekë) dhe UK Shkodër (3.1 milion lekë).]

Të gjitha shoqëritë e tjera të Grupit të I-rë kanë rënie të të ardhurave duke filluar nga UK Durrës (-191.4 milion lekë), që raportohet për shkak të një gabimi në raportimin e vitit 2020, (verifikuar nga monitorimi në terren gjatë vitit 2021), në të cilin të ardhurat nga shërbimet KUN dhe ITUN janë dubluar. Shoqëri të tjera që kanë rënie të ardhurash krahasuar me një vit më parë janë UK Tiranë me (-15.7 milion lekë) dhe UK Kavajë me (-9.8 milion lekë).

Në **Grupin e II-të** konstatohet rritje e të ardhurave për vitin 2021 në shumën 5.9 milion lekë edhe pse UK Tepelenë ka kaluar në grupin e tretë të shoqërive për shkak të ndarjes me UK Memaliaj. Rritjen më të madhe e kanë shënuar UK Peqin, UK Mallakastër, UK Gjirokastrë. Me rënie të të ardhurave në këtë grup janë shoqëritë, UK Mirditë (-15 milion lekë), UK Kukës (-14 milion lekë), UK Poliçan (-7.8 milion lekë).

Grupi i III-të i cili zë peshën minimale prej 1% në totalin e të ardhurave, rezultojnë me rritje të të ardhurave me rreth 35 milion lekë. Ndikimin më të madh në rritjen e të ardhurave e ka dhënë përfshirja në grupin e tretë të dy shoqërive UK Tepelenë dhe UK Memaliaj që më parë kanë qenë në grupin e dytë.

Për vitin 2021 janë 12 shoqëri që i mbulojnë mbi 100% Kostot O&M nga 58 shoqëri në total. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes ka rënie për shoqëritë e Grupit të I-rë nga 114% në 113%, ndërsa ka rritje të lehtë për shoqëritë e Grupit të II-të nga 68% në 69%, dhe Grupit të III-të nga 54% në 67%.

Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ka ardhur për arsye se vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 është rritur me 4.3 milion m³ ujë si rezultat i rritjes me 19 mijë lidhje të reja të furnizimit me ujë dhe rritjes së orëve të furnizimit me ujë. Ndërsa vëllimi i faturuar KUN është rritur me 6.4 milion m³ si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve KUN.

Sektori me të ardhurat e gjeneruara arrin të mbulojë krejtësisht kostot e O&M deri nivelin 103%, që krijon përshtypje artificiale “optimiste” për sektorin, por në fakt 48 nga 58 shoqëritë nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M. Ndërkohë ka shoqëri UK brenda grupeve që nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmat e kostove operative dhe nuk kanë kapacitet financiar për të vazhduar aktivitetin nëse nuk subvencionohen nga qeveria qendrore nuk arrijnë të mbulojnë as pagat e punonjësve.

Gjatë vitit 2021 shpërndarja e subvencioneve ka patur qëllim vetëm mbulimin e kostove të energjisë elektrike, dhe nga tabela 36 Aneksi 3 vërehet se nuk ka shpërndarje mbi nevojat për subvencione.

Pavarësisht destinacionit, përveç shoqërive që kanë marrë subvencione, nevoja për subvencione, për mbulimin e kostove operative të aktivitetit për vitin 2021, kanë patur edhe shoqëri që gjatë vitit 2021 nuk kanë marrë subvencione nga qeveria qendrore, si ato të bashkive Fier, Kamëz, Devoll, Kukës, Mat, Himarë, Gramsh, Bulqizë, Dropull, Roskovec, Tepelenë, Finiq, Klos, Pukë, Libohovë dhe Fushë Arrëz.

Kanë përfituar 60% të totalit të subvencioneve, përkatësisht shoqëritë UK Durrës 98.2 milion lekë, UK Vlorë 52.5 milion lekë, UK Patos 32.7 milion dhe UK Elbasan 30.3 milion lekë.

Nevoja për subvencione për Sektorin në mënyrë që të mbulohen diferencat e kostove të O&M me të ardhurat është llogaritur në vlerën prej 1,632 milion lekë (rreth 13.5 milion euro), ndërsa fondi i akorduar shoqërive si subvencion është rreth 380 milion lekë (3.2 milion euro), i cili mbulon vetëm 23% të nevojave për subvencione. Megjithatë duke marrë në konsideratë destinacionin, krahasuar me një vit më parë fondet e alokuara me destinacion energjinë elektrike janë 230 milion lekë më të larta.

Në Aneksin 3, tabela 36, jep një pasqyrë të detajuar të nevojës për subvencione për vitin 2021, si dhe alokimin (shpërndarjen) e realizuar praktikisht gjatë vitit për çdo shoqëri UK.

1.2.2 Investimet Kapitale në Sektorin UK

Investimet nga Buxheti i Shtetit dhe Donatorët

Investimet në sektorin UK mbeten akoma nën nivelin e duhur për të arritur objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, si dhe në përmbushje të kërkesave të Direktivës Evropiane për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura.

Referuar Master Planit Kombëtar të projektuar deri në vitin 2040 rezulton se investimet fizike në sektorin UK të jenë rreth vlerës së 5 miliard Euro. Për përmbushjen e këtyre kërkesave kërkohen rreth 200 milion Euro/vit duke patur parasysh projektimin e tyre në 25 vite.

Mënyra e synuar e financimit të nevojave fizike të sektorit përcaktohet në draft Strategjinë e Financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve nëpërmjet sistemit të 3T-ve, përkatësisht nga Taksat (buxheti i shtetit), Transferta (financimi i donatorëve), si dhe nga Tarifat (faturat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët).

Investimet nga buxheti i shtetit për vitin 2021 nëpërmjet AKUM-it kanë qenë të orientuara për përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë për qendrat urbane, si projekte të reja dhe ato në vazhdim nga viti i kaluar. Kjo në vijim të objektivit afat shkurtër që ka ndërmarrë qeveria qendrore ku përmes investimeve nga AKUM synohet të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë pa ndërprerje për 58 qendra urbane, nga 66 të tilla deri në vitin 2023.

Investimet fizike nga buxheti i shtetit në sektorin e ujësjellës kanalizimeve për vitin 2021 kanë pësuar një rënie në krahasim me vitet e mëparshme. Referuar të dhënave të AKUM-it gjatë vitit 2021 në total janë disbursuar në vlerën 946 milion lekë (rreth 7,8 milion euro). Me anë të tyre u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 5 qendra urbane, përkatësisht, *Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj* duke e çuar kështu në 27 numrin total të zonave me regjim 24/7 deri në fund të vitit 2021. Shih Aneks 6, tabelën 39.

Ndërkohë në sektor është investuar edhe nga donatorët e huaj, kryesisht nga BE dhe KfW. Këto investime në total kanë rezultuar në vlerën e 2.6 miliard lekë ose rreth 21 milion euro. Siç shihet këto vlera rezultojnë më të mëdha se ato të investuara nga buxheti i shtetit, por krahasuar me vitet e mëparshme këto investime kanë qenë në vlerë më të ulët. Investimet fizike nga donatorët kanë konsistuar kryesisht në financimin e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III, IV dhe V (rreth 90% e totalit) që përmbledh 8 qytete të Shqipërisë, përkatësisht, Shkodër, Lezhë, Kamëz, Elbasan, Berat, Kuçovë, Vlorë dhe Fier. Ndërkohë që pjesa tjetër e financimit është investuar në projekte të tjera në një shkallë më të vogël, si për rehabilitimin e rrjetit hidrik të Tiranës etj.

Rënia e investimeve në sektor për vitin 2021 lidhet edhe me qasjen e re të qeverisë qendrore në kuadër të vazhdimësisë së reformës së ujit, ku po synohet agregimi i shoqërive UK në 15 të tilla. Kjo sigurisht që do të kërkojë një rivlerësim të nevojave për investime në sektor duke i përshtatur ato me nevojat që do të kenë shoqëritë e reja të riorganizuara.

Në tabelën 5 të mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmbledhur investimet e planifikuara për tu financuar nga AKUM dhe burimet e huaja për periudhën 2020-2023 si dhe vlera e financuar prej tyre për vitin 2021.

Tabela 5. Investimet e planifikuara në sektorin UK financuar nga AKUM dhe nga burime të huaja për periudhën 2020-2023.

Përshkrimi	Vlera Totale e Investimit 2020-2023 (Lekë)	Vlera e Financuar për Vitin 2021 (Lekë)
Investime nga AKUM	18,531,262,514	946,000,000
Investime të Huaja	1,744,917,279	2,600,000,000
TVSH	4,055,235,959	709,200,000
TOTALI	24,331,415,752 (eq. 196 milion euro)	4,255,200,000 (eq. 35 milion euro)

Burimi: AKUM

Si rezultat i investimeve të fokusuara kryesisht në drejtim të përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë siç u theksua më sipër, investimet në drejtim të kanalizimeve mbeten akoma një sfidë për tu arritur në të ardhmen pasi mbulimi i sektorit me kanalizime në rang kombëtar për vitin 2021 mbetet akoma shumë i ulët në masën e 52%.

Akoma financimi aktual në sektor nuk i përgjigjet nevojave reale në përbushje të tre Direktivave Evropiane për Ujin e Pijshëm dhe Ujërat e Ndotura*, ku vendi ynë synon të hapë së shpejti negociatat për aderimin në Komunitetin Evropian.

* Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian (Direktiva e Politikave të Ujit).
Direktiva 98/83/EC (Direktiva e Ujit të Pijshëm);
Direktiva 91/271/EEC (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura)

1.3 Reforma në Sektor

Në tre dekadat e fundit është evident fakti i performancës së dobët financiare të sektorit të ujësjellës kanalizimeve, si edhe i cilësisë së shërbimeve që shoqëritë UK ofrojnë për konsumatorët. Duke patur parasysh problematikat që paraqet sektori, qeveria qendrore ka planifikuar zbatimin e një reforme thelbësore në sektor me qasje kryesore agregimin e sektorit të fragmentarizuar në një numër të kufizuar shoqëri UK.

Gjatë vitit 2021 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të qeverisë qendrore ka zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi me anë të një sërë takimesh me përfaqësues të pushteteve vendore dhe të shoqërive UK mbi nevojën e një reforme rrënjësore në sektor me anë të agregimit të shoqërive UK ekzistuese me një numër mjaft të reduktuar të tyre, si një instrument për përmirësimin e gjendjes financiare të sektorit, si dhe të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Detaje të mëtejshme, si dhe hapat ligjorë e organizativë të realizimit të reformës pritet të konkretizohen gjatë vitit 2022 me anë të një vendimi të veçantë të Këshillit të Ministrave dhe nën-akte të tjera ligjore.

ERRU angazhohet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshme që kërkohen nga ky institucion në mbështetje të reformës në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritshme prej saj me synimin që të kemi një sektor financiarisht të qëndrueshëm dhe që ofron shërbime me një cilësi të lartë ndaj konsumatorëve dhe me tarifa të përballueshme prej tyre.

1.4 Metodologjia e re e Vendosjes së Tarifave, Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Raporti i performancës së shoqërive UK dhe të sektorit për vitin 2021 tashmë për të tretin vit radhazi është hartuar duke u bazuar në të dhënat që shoqëritë UK kanë raportuar pranë sektorit të monitorimit të ERRU në vijim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 31, datë 28.06.2019 mbi “Platformën e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime”.

Në fund të vitit 2021 ERRU aprovoi metodologjinë e re të vendosjes së tarifave për shërbimet e UK. Metodologjia e re i përgjigjet më mirë kërkesave aktuale dhe të perspektivës së sektorit, dhe ka përmirësime në drejtim të procesit të analizës, të nxitjes për hartimin e planit të menaxhimit të aseteve, rishikimin e normave të amortizimit dhe TKP, vendosjen e kriterëve për saktësinë e të dhënave, të periudhës rregullore, rikonceptim dhe detajim i zbatimit të kriterit të përballueshmërisë dhe të aplikimit të tarifave me blloqe për ruajtjen e burimeve natyrore të ujit.

Rendësi e veçantë i është kushtuar saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave, si kusht i domosdoshëm për një analizë objektive të performancës së sektorit dhe të vendosjes së objektivave në të ardhmen. Në metodologjinë e re të tarifave ka një kapitull të veçantë “Sistemet e Informacionit” ku paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat specifike për mbajtjen e informacionit të krijuar nga shoqëria kur aplikojnë për tarifa të reja. Për verifikimin dhe saktësinë e të dhënave me të cilat është hartuar edhe raporti i performancës 2021, ERRU, ka realizuar takime të drejtpërdrejta në terren me 30 shoqëri UK me probleme të saktësisë së të dhënave. Këto takime kanë shërbyer gjithashtu për trajnimin e stafeve në plotësimin e saktë dhe korrekt të formularit të data bazës.

Siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme nevoja e ERRU për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave për monitorimin e shoqërive dhe hartimin e Raporteve Vjetore të Performancës së shoqërive UK lindi si një nevojë për të mënjanuar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë

e të dhënave të marra nga Drejtoria e Monitorimit dhe Benchmarkut pranë AKUM si dhe për të minimizuar problemin kronik të vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që jo rrallë ka influencuar në konkluzionet për përmirësimin e performancës së sektorit.

Në këtë kontekst ERRU vazhdimisht është treguar proaktive në drejtim të forcimit të rolit të tij monitorues duke intensifikuar kërkesën e llogarisë ndaj shoqërive UK. Konkretisht për verifikimin dhe saktësinë e të dhënave me të cilat është hartuar edhe raporti i performancës 2021, ERRU, ka realizuar takime të drejtpërdrejta në terren me 30 nga 58 shoqëri UK që paraqesin probleme në drejtim të raportimit korrekt të dhënave pranë ERRU-së. Duhet patur parasysh se të dhënat e shoqërive dorëzohen deri në fund të muajit prill pas mbylljes së bilanceve financiare në fund të mars 2022. ERRU respekton rigorozisht afatin e publikimit të raportit deri në fund të Qershorit 2022 në mënyrë që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2021.

Qëllimi i këtyre takimeve përpos nevojës për verifikimin dhe saktësinë e të dhënave të raportuara lidhej edhe me nevojën për trajnimin e stafëve në plotësimin e saktë dhe korrekt të formularit të data bazës si rezultat i ndryshimit të shpeshtë të tyre. Ndryshimet e stafëve përgjegjëse për plotësimin dhe raportimin e të dhënave është edhe një ndër faktorët kryesorë ndikues në pasaktësinë e informacionit të dhënë.

Për sa më sipër ERRU në çdo takim u rekomandon drejtuesve të shoqërive nevojën për caktimin e një personi përgjegjës për raportimin e të dhënave tekniko ekonomike pranë ERRU dhe çdo institucioni tjetër të interesuar në mënyrë që të dhënat e raportuara prej tyre të jenë të njëjta për secilën palë duke pasqyruar kështu situatën reale të shoqërisë.

Siç u theksua më lart, edhe pse ERRU ka bërë përpjekje maksimale në drejtim të asistencës së dhënë ndaj shoqërive UK si në takime të drejtpërdrejta me drejtuesit dhe personat kyç të shoqërisë ashtu edhe në komunikimet e shpeshta telefonike dhe elektronike me to, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara mbetet akoma një sfidë për tu arritur nga sektori UK.

Konstatohen pasaktësi jo të vogla në drejtim të të dhënave tekniko-ekonomike veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së të cilët hartohen me vlerësime dhe jo me instrumenta matëse. Kjo kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Si rezultat Uji Pa të Ardhura si treguesi kryesor i performancës së sektorit, mund të rezultojë me shkallë relativisht jo të vogël pasaktësie.

Një tjetër element janë edhe raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arketimeve të detyrimeve korrente dhe atyre të prapambetura mbi bazën e të cilave llogaritet treguesi Norma e Arkëtimit.

Nisur nga faktorët e mësipërm, ERRU, e ka në fokus përmirësimin e besueshmërisë së bazës së të dhënave të cilën e ka përfshirë në një kapitull të veçantë edhe në metodologjinë re të tarifave “Sistemet e Informacionit” ku paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat specifike për mbajtjen e informacionit të krijuar nga shoqëria kur aplikojnë për tarifa të reja.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime

2.1 Ndarja sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjiellës kanalizime është i bazuar në 9 tregues kryesorë të performancës (Norma e Arkëtimit Korrente dhe Norma Totale përmbledhen në një tregues) të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, në përzgjedhjen e TKP përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimitet më të rëndësishme të performancës së operatorëve që tregojnë dhe nivelin e cilësisë së ofruar të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Në këtë raport do të analizohen treguesit e performancës për 57 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor pasi është shtuar shoqëria UK Memaliaj e cila më parë ka qenë pjesë e shoqërisë UK Tepelenë dhe nuk disponon të dhëna të plota për vitin kalendarik 2021. Duke qenë se shoqëria UK Memaliaj ka raportuar të dhënat për herë të parë në vitin 2021, kjo shoqëri për arsye krahasimore nuk do të merret në analizën e grupeve, por të dhënat e saj për çdo tregues performancë do të jenë pjesë e tabelave të ecursisë së shoqërive sipas grupeve në mënyrë që të krahasohen me vitin pasardhës 2022.

Shoqëritë UK raportojnë të dhënat për zonën e shërbimit sipas reformës në përputhje me ndarjet administrative të bashkive (1 bashki = 1 shoqëri UK) edhe pse deri në fund të vitit 2021 janë akoma 16 shoqëri të pa licencuara nga ERRU në përputhje me reformën.

Metodologjia e përdorur në këtë raport performancë mbetet e njëjtë, si për ndarjen në grupe të shoqërive, ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre. Tabela 6 jep tre grupimet e shoqërive UK sipas madhësisë (numrit të lidhjeve).

Gjithsesi në Aneks 11 në tabelën 44, jepen të detajuara të gjithë Treguesit Kryesorë të Performancës për secilën shoqëri UK më vete sipas grupimeve.

Tabela 6. Grupimet e Shoqërive Sipas Numrit të Lidhjeve

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	14	14
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	33	33
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjiellës kanalizime	11	10

Burimi i Informacionit ERRU

Për vitin 2021 ka një ndryshim në grupet e renditjes së shoqërive krahasuar me vitin paraardhës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive. Konkretisht në grupin e tretë janë shtuar dy shoqëri përkatësisht UK Tepelenë dhe UK Memaliaj për shkak të ndarje së këtyre dy shoqërive nga njëra tjetra e cila ka sjellë edhe ndryshim në uljen e numrit të lidhjeve për UK Tepelenë, pasi më parë ka qenë pjesë e grupit të dytë. Në detaje numri i lidhjeve për çdo shoqëri në secilin grup jepet në Tabelën 7.

Tabela 7. Numri i lidhjeve për çdo Shoqëri sipas Grupimeve

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjetellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjetellës)
Grupi 1			Grupi 2 (vazhdimi)		
UK	Tiranë	259,338	UK	Rrogozhinë	5,572
UK	Durrës	91,608	UK	Bulqizë	5,378
UK	Vlorë	58,682	UK	Përmet	4,788
UK	Elbasan	40,063	UK	Dropull	4,652
UK	Fier	38,592	UK	Vore	4,514
UK	Shkodër	32,066	UK	Ersekë	4,241
UK	Korçë	29,718	UK	Selenicë	4,198
UK	Berat -Kuçovë	29,358	UK	Ura Vajgurore	4,194
UK	Kavajë	25,741	UK	Skrapar	3,975
UK	Kamëz	25,215	UK	Vau Dejës	3,813
UK	Lushnje	23,239	UK	Peqin	3,710
UK	Sarandë	20,379	UK	Tropoje	3,646
UK	Pogradec	18,717	UK	Delvinë	3,240
UK	Lezhë	18,415	UK	Roskovec	3,233
			UK	Mirditë	3,182
Grupi 2			UK	Poliçan	3,004
UK	Maliq	10,284	Grupi 3		
UK	Gjirokastër	10,249	UK	Tepelenë	2,896
UK	Devoll	9,182	UK	Finiq	2,738
UK	Dibër	8,964	UK	Konispol	2,382
UK	Cërrik	7,650	U	Klos	1,969
UK	Belsh	7,292	UK	Pukë	1,846
UK	Kurbin	7,105	UK	Këlcyrë	1,762
UK	Kukës	7,045	U	Has	1,615
UK	Librazhd	6,950	UK	Libohovë	1,522
UK	Divjake	6,643	UK	Fushë Arrëz	750
UK	Mat	6,639	UK	Pustec	748
UK	Himarë	6,429	UK	Memaliaj	2,033
UK	Krujë	6,059			
UK	Mallakastër	5,837			
UK	Patos	5,812			
UK	Malësi e Madhe	5,763			
UK	Gramsh	5,714			

Burimi i Informacionit ERRU

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme.

Në tabelën nr. 8 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.




Figura 1. Grafik i Analizës së TKP-ve

Tabela 8 Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji Pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

¹ Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Sasia e ujit që humbet nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve konsiderohet “Ujë Pa të Ardhura”. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues, shpërndarës etj.).

Gjatë shfrytëzimit të sistemeve të furnizimit me ujë, humbjet e ujit janë një nga pengesat kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërive UK. Përmirësimi i Treguesit UPA nëpërmjet performancës në rritje dhe uljes së kostove operative është rrugëzgjidhja për të patur përmirësim të dukshëm të tij.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2020, rritja e variablit “faturimi total” me (+4,323 milion m³) solli përmirësim të lehtë të treguesit UPA në nivelin (- 0.6%).

Në treguesin “Ujë Pa të Ardhura” 64.8% ndonëse me tendencë përmirësimi, ndikim negativ kanë dhënë edhe faktorët “lidhje të paligjshme”, “faturimi aforfe”, “sistemet e vjetra” që ende vazhdojnë t’ju bashkëngjiten shoqërive UK si dhe lëvizja e kufizuar si pasojë e Pandemisë botërore e cila izoloi jo vetëm banorët vendas, por dhe ata të huaj.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për Grupin e I-rë, viti 2021

Gjatë vitit 2021, me nivel të treguesit UPA nën 30% dhe performancën më të mirë në grup raporton shoqëria UK Korçë (29.50%). Brenda nivelit 30-50% të treguesit performuan shoqëritë Lezhë (37.50%), Pogradec (38.70%) dhe Sarandë (42.30%) ndërsa 10 shoqëri UK ende performojnë dobët me nivelin e UPA nga 50-80%.

Ndonëse numri i shoqërive që performojnë dobët është i madh, 12 shoqëri UK raportojnë përmirësim të treguesit, si të tilla dallohen shoqëritë UK Sarandë me 6.16%, UK Berat-Kuçovë 5.96%, UK Tiranë 3.14%, UK Vlorë 2.85%, UK Lushnje 2.55%, UK Korçë 1.31% etj.

Nga 14 shoqëri në grup, përkeqësim të treguesit raportuan shoqëritë UK Kamëz me 7.02% dhe UK Kavajë me 2.29%.

Ecurinë më të mirë në këtë grup për vitin 2021 e kanë patur UK Sarandë që e ka reduktuar UPA me 6.16%, UK Berat-Kuçovë me 5.96% dhe UK Tiranë me 3.14%.

Tabela 9. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Sarandë	UK	48.46	42.30	-6.16
2	Berat - Kuçovë	UK	71.06	65.10	-5.96
3	Tiranë	UK	61.84	58.70	-3.14
4	Vlorë	UK	79.05	76.20	-2.85
5	Lushnje	UK	73.75	71.20	-2.55
6	Korçë	UK	30.81	29.50	-1.31
7	Pogradec	UK	39.81	38.70	-1.11
8	Shkodër	UK	69.83	69.20	-0.63
9	Fier	UK	75.91	75.30	-0.61
10	Lezhë	UK	38.03	37.50	-0.53
11	Durrës	UK	79.53	79.20	-0.33
12	Elbasan	UK	74.29	74.20	-0.09
13	Kavajë	UK	62.41	64.70	2.29
14	Kamëz	UK	63.78	70.80	7.02

Grupi 2 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për Grupin e II-të, viti 2021

Në shoqëritë e Grupit të II-të, mos mbajtja nën monitorim gjatë gjithë vitit i sistemeve të furnizimit me ujë, niveli i ulët i matjes për variablat “ujë i prodhuar” dhe “ujë i faturuar” janë faktorët kryesorë të luhatjeve të treguesit UPA edhe gjatë këtij viti ushtrimor. Ky fenomen ka shoqëruar shoqëritë UK Patos, Kukës, Skrapar, Divjakë etj.

Siç paraqitet dhe në tabelat e grafikët përkatës, kanë performuar nën kufirin e performancës së mirë shoqëritë Kolonjë (26.60%) dhe Dropull (27.7%). UK Dropull raporton përmirësim të treguesit në nivelin (-21.07%) si rezultat i investimit të ri të bërë në sistemin e furnizimit me ujë.

Nga 33 shoqëri të grupit të dytë, 13 prej tyre raportuan nivel të UPA nga 30-50% ndërsa 18 shoqëri UK performuan me nivel të UPA mbi 50%.

Me nivelin më të lartë të Ujit Pa të Ardhura u paraqiten UK Selenicë (84.01%), UK Patos(73.3%), UK Cërrik (70.4%), UK Vorë (70.0%), UK Himarë(68.7%) etj.

Për ecurinë më të mirë dhe të besueshme gjatë këtij viti paraqiten UK Dropull, UK Gjirokastrë, UK Librazhd etj. Disa shoqëri ndonëse raportuan nivele të përmirësuar për treguesin UPA, të dhënat e raportuara

janë të pabesueshme si rezultat i raportimeve jo korrekte në vite. Këto të fundit do të monitorohen dhe asistohen në mënyrë të veçantë nga ERRU në të ardhmen.

Më poshtë në tabelën 10, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për dy vitet e fundit për Grupin e II-të

Tabela 10. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Dropull	UK	48.77	27.70	-21.07
2	Gjirokastër	UK	47.90	40.60	-7.30
3	Librazhd	UK	53.18	46.80	-6.38
4	Himarë	UK	74.44	68.70	-5.74
5	Kurbin	UK	54.14	49.10	-5.04
6	Mat	UK	45.88	42.10	-3.78
7	Ura Vajgurore	UK	58.47	54.90	-3.57
8	Malësi e Madhe	UK	54.31	51.20	-3.11
9	Përmet	UK	37.72	35.20	-2.52
10	Krujë	U	69.69	67.50	-2.19
11	Dibër	UK	57.79	56.10	-1.69
12	Mallakastër	UK	59.08	58.80	-0.28
13	Gramsh	UK	38.60	38.40	-0.20
14	Rrogozhinë	UK	62.22	62.10	-0.12
15	Poliçan	U	46.09	46.10	0.01
16	Roskovec	UK	64.30	65.10	0.80
17	Selenicë	UK	82.91	84.10	1.19
18	Cërrik	U	68.61	70.40	1.79
19	Kolonjë	UK	24.39	26.60	2.21
20	Vau i Dejës	UK	58.38	61.00	2.62
21	Maliq	UK	37.56	40.30	2.74
22	Bulqizë	U	43.46	46.30	2.84
23	Delvinë	UK	43.19	46.30	3.11
24	Peqin	UK	63.16	66.60	3.44
25	Vorë	UK	66.15	70.00	3.85
26	Devoll	UK	26.86	31.70	4.84
27	Mirditë	UK	47.71	55.80	8.09
28	Skrapar	UK	51.91	60.20	8.29
29	Belsh	UK	23.07	33.00	9.93
30	Tropojë	UK	28.88	47.20	18.32
31	Kukës	UK	34.55	54.50	19.95
32	Patos	UK	51.67	73.30	21.63
33	Divjakë	UK	42.61	65.70	23.09

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2021

Në Grupin e III-të të shoqërive, performojnë nën kufirin 30% të treguesit UPA shoqëritë UK Klos (26.60%) dhe UK Konispol (26.70%). Me nivel të UPA nga 30-50% raportuan shoqëritë Tepelenë (35.7%) dhe Pustec (42.1%) ndërsa mbi nivelin 50% të Benchmarkut performuan 6 nga 10 shoqëri të grupit.

Si pasojë e investimeve në rrjete, kanë raportuar përmirësim të Treguesit UPA shoqëritë UK Konispol (-9.72%) dhe UK Pustec (-16.6%).

Nga krahasimi i të dhënave për tre vitet e fundit, shoqëritë Fushë Arrëz dhe Finiq rezultojnë me tregues të përmirësuar në nivele të konsiderueshme të cilat edhe mund të mos jenë të besueshme nisur nga luhatjet në raportime gjatë viteve si rezultat i gabimeve në matje dhe vlerësime për variablat ujë i prodhuar dhe ujë i faturuar.

Grupi 3 - Uji Pa të Ardhura (%)




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të, viti 2021

Tabela 11. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Pustec	UK	58.76	42.10	-16.66
2	Konispol	UK	36.42	26.70	-9.72
3	Has	UK	58.86	54.40	-4.46
4	Pukë	UK	78.48	74.20	-4.28
5	Finiq	UK	77.45	76.10	-1.35
6	Libohovë	UK	71.98	71.80	-0.18
7	Këlcyrë	UK	76.78	77.40	0.62
8	Tepelenë	UK	34.31	35.70	1.39
9	Fushë Arrëz	UK	51.87	53.50	1.63
10	Klos	U	19.66	26.60	6.94
11	Memaliaj	UK	-	27.36	-

- Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2021 është 64.8%. Performuan nën kufirin 30% të performancës së mirë 5 shoqëri UK, 18 prej tyre performuan brenda kufirit 30-50% dhe 35 të tjera performuan mbi kufirin 50% të Benchmarking.
- Analiza e kryer në rang sektori për vitin 2021 tregoi tendencë përmirësimi të lehtë për treguesin UPA. Krahasuar me të dhënat e vitit 2020, rritja e variablit “faturimi total” me (+4,323 milion m3) solli përmirësim të lehtë të treguesit UPA në nivelin (-0.6%).
- Për këtë vit, në treguesin “Ujë Pa të Ardhura” ndonëse me tendencë përmirësimi, ndikim negativ kanë dhënë edhe faktorët “lidhje të paligjshme”, “faturimi aforfe”, “sistemet e vjetra” sidomos në hapësirën rurale që janë në zonën e shërbimit të shoqërive UK, si dhe nga kufizimi i lëvizjes si pasojë e Pandemisë COVID 19.
- Niveli i lartë i UPA, që ndikon direkt në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, mbetet shqetësimi kryesor për sektorin. Rregullatori vazhdimisht këmbëngul në “Hartimin e planeve të biznesit” dhe përfshirjen në to të planeve të veprimit për të reduktuar humbjet komerciale (dukshme) dhe ato teknike (reale).
- Gjithashtu ERRU, sugjeron shoqëritë UK për rritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve dhe emërimeve të duhura veçanërisht për stafin teknik në drejtim të menaxhimit të humbjeve dhe UPA.
- Shoqëritë duhet të përmirësojnë situatën teknike të sistemeve të vjetruara të furnizimit me anë të planit të menaxhimit të aseteve të cilat duhet ti hartojnë sa më shpejt të jetë e mundur.
- Shoqëritë duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë zbulimit dhe eliminimit të lidhjeve të paligjshme, futjes në sistem të klientëve të rinj që do të sjellë dhe rritje të faturimit, si dhe të saktësojnë të dhënat vjetore për të patur situatë reale mbi UPA.
- Instalimi i ujëmatësve në të gjitha pikat kyçe të prodhimit dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur të dhëna të sakta mbi volumet e prodhuara dhe të faturuara, për ruajtjen e burimeve ujore dhe shfrytëzimin e tyre në përputhje me kërkesën standarde për ujë, dhe për të hartuar një “Bilanc Uji” me të dhëna të sakta prej të cilit do të ndërmerren dhe hapat për reduktimin e UPA në sistemet e furnizimit.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është një nga treguesit financiar të performancës, i cili paraqet raportin me të cilin të ardhurat e realizuara nga aktiviteti mbulojnë kostot operative që nevojiten për funksionimin e aktivitetit (pa kostot kapitale).

Për vitin 2021, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 103,39 % nga 103.23 % që ishte në vitin paraardhës duke shënuar përmirësim të lehtë me 0.17%.

Niveli mbi 100% i këtij tregues të performancës për sektorin tregon në dukje se në total me të ardhurat e faturuara arrijnë të mbulojnë kostot operative në sektor. Në fakt akoma 46 shoqëri nga totali prej 58 nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M me të ardhurat, të cilat vazhdojnë të subvencionohen plotësisht ose pjesërisht nga qeveria qendrore me anë të AKUM-it. Ndikimin kryesor të këtij rezultati “paradoks” e jep Grupi i I-rë i shoqërive UK, ku bëjnë pjesë shoqëritë e mëdha, për të cilin treguesi mbulimi i kostove O&M është 113%. Në kuadër të reformës krijimi i shoqërive rajonale duke bashkuar shoqëritë në vështirësi financiare me shoqëritë në gjendje të qëndrueshme financiare, pritet që të ndikojë pozitivisht duke zvogëluar/eliminuar subvencionet nga qeveria qendrore e shoqërive UK për shlyerjen e kostove operative

të vitit ushtrimor dhe duke u përqendruar në investime të cilat duhet të sjellin optimizimin e kostove, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve.

ERRU konstaton se, për vitin 2021, në sektor janë 12 shoqëri që kanë këtë tregues mbi 100%, nga 10 që rezultojnë në vitin 2020. Shoqëritë UK që janë shtuar duke kaluar nivelin e mbulimit 100% janë UK Saranda (nga 93.86% në 110.47%), UK Malësi e Madhe (nga 88.71% në 108.58%), UK Dibër (nga 92.03% në 105.64%) dhe UK Gjirokastrë (nga 94.02% në 104.53%).

Shoqëritë UK që kanë pësuar rënie të këtij treguesi nën 100% janë UK Devoll (nga 103.95% në 92.22%) dhe Kukës (nga 133.43 në 78.78%).

Më poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grup të shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, në Grupin e I-rë, bëjnë pjesë 14 shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave kanë disa vite që mbulojnë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes mbi 100 %. Realizimi i këtij treguesi për shoqëritë e Grupit të I-rë për vitin 2021 jepet në grafikun e Figurës 5.

Grupi 1 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 5. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë, viti 2021

Siç shihet nga grafiku, 6 nga 14 shoqëritë e këtij grupi e kanë kaluar nivelin e objektivit të synuar për performancë të mirë ($\geq 100\%$) të vendosur nga ERRU, përkatësisht: UK Korçë, UK Lezhë, UK Pogradec, UK Tiranë, UK Berat-Kuçovë dhe UK Sarandë. Krahësuar me vitin 2020, numri i shoqërive që mbulojnë mbi 100% Kostot O&M është shtuar pasi më parë ishin 5 shoqëri UK që mbulonin Kostot O&M.

Shoqëritë UK që kalojnë nivelin 100% të objektivit të këtij treguesi, e kanë përmirësuar performancën e tyre lidhur me këtë tregues krahasuar me vitin 2020 me përjashtim të UK Korçë, e cila e ka përqesuar këtë tregues me 41.25%, si rezultat i rritjes me 27.9 % të pothuajse të gjithë zërave të kostove operative (+ 45.5 milion lekë) ndërkohë që të ardhurat janë rritur vetëm me 3.35%. Pra rritja e nivelit të kostove është më e lartë se sa rritja e të ardhurave.

Në zonën e performancës së dobët për këtë vit janë pesë shoqëri të këtij grupi dhe konkretisht UK Kavajë (55.19%), UK Vlorë (70.53%), UK Durrës (74.45%), UK Kamëz (75.65%) dhe UK Shkodër (79.72%). Këto shoqëri kanë rënie të nivelit të këtij treguesi, përveç UK Kavajë, e cila krahasuar me vitin paraardhës është përmirësuar me 13.93%, por gjithsesi mbetet në nivelin e performancës më të dobët të Grupit të I-rë.

Në zonën e performancës së pranueshme (80%-100%) janë tre shoqëri, UK Lushnje, UK Fier, UK Elbasan, ku vërehet se shoqëritë Lushnje & Fier kanë pësuar një rritje të nivelit të treguesit mbulimi i kostove O&M duke kaluar nga niveli i performancës së dobët në atë të pranueshme.

Mbulimi i kostove të O&M për vitin 2021 ka një përqesim të lehtë, i cili është 113.21% nga 113.71% që ishte në vitin 2020. Kjo situatë për Grupin e I-rë ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kostove operative me +117 milion lekë dhe rritjes së të ardhurave nga aktiviteti me rreth +95 milion lekë, pra rritja e kostove ka qenë më e lartë se sa rritja e të ardhurave.

Tabela 12 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për dy vitet e fundit.

Tabela 12. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Berat - Kuçovë	UK	111.88	147.95	36.07
2	Sarandë	UK	93.86	110.47	16.61
3	Tiranë	UK	150.17	164.16	13.99
4	Kavajë	UK	41.26	55.19	13.93
5	Lushnje	UK	74.62	88.52	13.90
6	Lezhë	UK	131.68	144.83	13.15
7	Fier	UK	78.42	89.77	11.35
8	Elbasan	UK	87.85	90.80	2.95
9	Pogradec	UK	108.95	111.83	2.88
10	Vlorë	UK	73.14	70.53	-2.61
11	Shkodër	UK	84.11	79.72	-4.39
12	Kamëz	UK	85.11	75.65	-9.46
13	Durrës	UK	99.46	74.45	-25.01
14	Korçë	UK	214.89	173.64	-41.25

Në këtë grup, gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020 kanë pasur përmirësim 9 shoqëri. UK Berat-Kuçovë është përmirësuar me 36.07%, për shkak të reduktimit të kostove me 18.2% dhe ka rritur të ardhurat me 8%, UK Sarandë është përmirësuar me 16.61%, UK Tiranë me 13.99%, UK Kavajë me 13.93%, UK Lushnje me 13.9 %, UK Lezhë 13.15%, UK Fier me 11.35%, UK Elbasan me 2.95% dhe UK Pogradec me 2.88% për shkak se niveli i rritjes së të ardhurave është më i madh se niveli i rritjes së kostove.

Pesë shoqëritë e tjera të këtij grupi kanë shënuar rënie, ku me rënien më të lartë kryeson UK Korçë (-41.25%), për shkak të rritjes së kostove operative me 27.9%, pasuar nga UK Durrës (-25.01%), për shkak

të uljes së të ardhurave nga faturimi me 14.13%, UK Kamëz (-9.46%) për shkak të uljes së të ardhurave. Të tjera shoqëri janë me rënie me të lehtë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Referuar klasifikimit mbi numrin e lidhjeve, në Grupin e II-të të shoqërive bëjnë pjesë 33 shoqëri nga 34 që ishin në vitin 2020. Vërehet se në Grupin e II-të shoqërive është larguar UK Tepelenë, e cila pas ndarjes me UK Memaliaj bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve, ka kaluar në Grupin e III-të. Evidentohen **gjashtë shoqëri** me performancë të mirë, që mbulojnë Kostot O&M me mbi 100%, nga pesë shoqëri që ishin në vitin paraardhës. Sipas grafikut në vijim, shoqëria me performancën më të mirë është UK Kolonjë në nivelin 168.71%, e ndjekur nga UK Librazhd, UK Tropojë, UK Dibër, UK Malësi e Madhe dhe UK Gjirokastrë.

Nga analiza e mbulimit të kostos O&M vërehet se UK Devoll dhe UK Kukës vitin e kaluar kanë mbuluar kostot mbi 100%, por për vitin 2021 kanë përkeqësuar të nivelin të performancës, veçanërisht UK Kukës e cila ka kaluar në performancë të dobët, nën 80%, me diferencë (-34.65).




Figura 6. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e II-të, viti 2021

Në zonën e performancës së dobët, pra me mbulim të kostove O&M nën 80% renditen 20 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët mbetet UK Patos me 29.52% të mbulimit të kostove O&M. Kjo shoqëri për shkak të performancës së dobët financiare aplikon nivelin e ri tarifar të miratuar nga ERRU në vitin 2021, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.03.2021, sipas të cilit të ardhurat parashikoheshin të mbulonin 54% të kostove operative. Shoqëria UK Patos nuk ka realizuar as nivelin e të ardhurave të llogaritura me tarifat e reja (i ka realizuar vetëm 65%) dhe as kostot e parashikuara (20% më të larta se parashikimi) dhe

nuk i ka realizuar objektivat e vendosura nga ERRU në vendimin nr. 53 datë 04.02.2021 për miratimin e tarifave.

Sipas grafikut nr. 6, në nivele shumë të ulëta mbulimi të kostove O&M janë dhe UK Kurbin, UK Vau i Dejës, UK Ura Vajguore, UK Divjakë që si shkak kryesor kanë nivelin e ulët të tarifave dhe që kanë një kohë relativisht të gjatë që nuk kanë aplikuar pranë ERRU-së për tarifa të reja.

Në zonën e performancës së pranueshme, me mbulim të kostove O&M me 80%-100% janë renditur 7 shoqëri, ku krahasuar me vitin 2020 UK Mat ka përmirësimin më të madh të nivelit të këtij treguesi me 19.89% e ndjekur nga UK Delvinë me 7.08%, UK Përmet me 3.33%. Krahasuar me nivelin e performancës në vitin 2020, UK Devoll ka rënë nga zona e performancës së mirë ($\geq 100\%$) në zonën e performancës së pranueshme me 92.22%, ndërsa tre shoqëritë e tjera të këtij grupi që janë UK Himarë, UK Gramsh dhe UK Vorë, kanë rënie të lehtë të këtij treguesi.

Tabela 13. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Kolonjë	UK	140.49	168.71	28.22
2	Selenicë	UK	46.99	69.08	22.09
3	Mat	UK	70.44	90.33	19.89
4	Malësi e Madhe	UK	88.71	108.58	19.87
5	Dropull	UK	49.65	68.22	18.57
6	Diber	UK	92.03	105.64	13.61
7	Peqin	UK	50.53	61.33	10.80
8	Gjirokastrë	UK	94.02	104.53	10.51
9	Skrapar	UK	45.26	55.76	10.50
10	Rrogozhinë	UK	53.87	62.42	8.55
11	Krujë	UK	67.54	76.05	8.51
12	Tropojë	UK	107.54	115.07	7.53
13	Delvinë	UK	76.05	83.13	7.08
14	Patos	UK	22.88	29.52	6.64
15	Librazhd	UK	111.04	116.48	5.44
16	Ura Vajguore	UK	43.69	47.64	3.95
17	Përmet	U	86.31	89.64	3.33
18	Divjakë	UK	46.89	49.48	2.59
19	Mallakastër	UK	56.25	56.69	0.44
20	Himarë	UK	90.82	89.89	-0.93
21	Maliq	UK	69.38	67.59	-1.79
22	Gramsh	U	91.59	89.02	-2.57
23	Vorë	UK	89.31	85.51	-3.80
24	Kurbin	UK	39.75	35.35	-4.40
25	Belsh	UK	68.84	62.31	-6.53
26	Cërrik	UK	66.79	60.17	-6.62
27	Devoll	UK	103.95	92.22	-11.73
28	Poliçan	UK	69.57	55.26	-14.31
29	Roskovec	UK	98.85	78.12	-20.73
30	Vau i Dejës	UK	65.42	37.69	-27.73
31	Bulqizë	UK	95.38	65.38	-30.00
32	Mirditë	UK	90.06	56.64	-33.42
33	Kukës	UK	113.43	78.78	-34.65

Nga 33 shoqëri që bëjnë pjesë në Grupin e II-të, raportohen 19 shoqëri që e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të Kostove të O&M në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Kolonjë e cila për vitin 2021 raporton rreth 6 milion lekë të ardhura më shumë se viti 2020, duke arritur nivelin e mbulimit të kostove O&M në 168.71% për vitin 2021, nga 140.49% që ishte në vitin 2020. Përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar dhe shoqëritë UK Selenicë, UK Mat, UK Dropull dhe UK Malësi e Madhe.

Ndërkohë, shoqëria UK Kukës ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove O&M në Grupin e II-të me 34.65%, duke e kaluar shoqërinë nga zona e performancës së mirë në zonën e performancës së pranueshme. Kjo situatë për shoqërinë për vitin 2021 ka ardhur si pasojë e rënies së të ardhurave me -21.4% dhe rritjes së kostove me 13.2%. Rënie të konsiderueshme të këtij treguesi (dy-shifrore) kanë shënuar dhe shoqëritë UK Mirditë, UK Bulqizë, UK Vau i Dejës dhe UK Roskovec.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Sipas klasifikimit, në bazë të numrit të lidhjeve, në Grupin e III-të bëjnë pjesë 11 shoqëri, nga të cilat vetëm UK Finiq dhe UK Pukë është në zonën e performancës së pranueshme dhe shoqëritë e tjera përfshihen në shoqëritë me performancë të dobët. Këto janë shoqëritë më të vogla të sektorit, me numër lidhjesh për shërbimin e furnizimit me ujë deri në 3,000 lidhje. Edhe pse këto shoqëri kryesisht nuk arrijnë të mbulojnë kostot e punës, që konsiderohen si kosto prioritare, influenza negative e tyre në sektor është minimale. Kjo vjen si pasojë e numrit të vogël të klientëve, pra të peshës së vogël që kanë në sektor këto shoqëri.

Grupi 3 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 7. Mbulimi i Kostove O&M Grupi III-të, Viti 2021

Grupi i III-të numëron në total rreth 15 mijë lidhje dhe kostot O&M të këtij grupi llogariten në rreth 2% të kostove O&M të sektorit, pra mund të thuhet që performanca e këtyre shoqërive nuk ka ndikim në sektor.

Shoqëria me performancën më të dobët për këtë grup është UK Pustec që mbulon vetëm 34.91% të Kostove të O&M, e cila është dhe shoqëria që ka rënien më të madhe të mbulimit të kostove O&M me 16.49%. Për këtë vit në këtë grup janë shtuar dy shoqëri UK Tepelenë dhe UK Memaliaj, të cilat kanë sjellë edhe rritjen e totalit të të ardhurave për këtë grupim me 4.4 milion lekë.

Tabela 14. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Tepelenë	UK	44.75	73.93	29.18
2	Finiq	UK	76.10	95.27	19.17
3	Këlcyrë	UK	32.10	47.56	15.46
4	Klos	U	65.89	76.72	10.83
5	Pukë	UK	84.90	91.54	6.64
6	Konispol	UK	65.48	71.04	5.56
7	Libohovë	UK	53.53	55.44	1.91
8	Pustec	UK	33.81	34.91	1.10
9	Has	UK	48.86	47.71	-1.15
10	Fushë Arrëz	UK	70.51	63.96	-6.55
11	Memaliaj	UK	-	71.59	-

Për shoqëritë e Grupit të III-të, për pjesën më të madhe të shoqërive, treguesi i mbulimit të Kostove O&M në vitin 2021 ka pasur tendencë përmirësimi krahasuar me vitin 2020, si rrjedhojë e përpjekjeve të shtuara nga këto shoqëri për këtë tregues, por jo në nivelin e kërkuar të një situate të shëndoshë financiare. Shkak kryesor i nivelit të ulët të këtij treguesi është edhe sepse këto shoqëri nuk kanë aktivitet të rregulluar nga ERRU për shkak edhe se një pjesë e tyre nuk kanë tarifa të miratuara dhe të kontrolluara nga ERRU.

Pritet që në kuadër të reformës për agregimin e sektorit ky grup shoqërish UK të shkrihet dhe secila të përfshihet në shoqëritë UK rajonale të propozuara.

- Nga analiza e treguesit “Mbulimi i Kostove O&M” për të tre grupet e shoqërive (të klasifikuara sipas kriterit të numrit të lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë) rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2021 është 103.4%, duke shënuar rritje me 0.17% krahasuar me vitin 2020. Ky përmirësim i lehtë apo mos ndryshim i nivelit të këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes në përqindje të të ardhurave dhe kostove O&M pothuajse në të njëjtat nivele, të ardhurat rriten me 1.39% dhe kostot me 1.24%.
- “Mbulimi i Kostove O&M” për sektorin në nivelin 103,4% nuk duhet konsideruar që sektori është i shëndetshëm financiarisht sepse vetëm 12 shoqëri nga totali prej 58 arrijnë të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M. Nga ana tjetër, 12 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 36 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 8 shoqëri të cilat mbulojnë më pak se 50% të kostove O&M. Këto shoqëri kryesisht i përkasin Grupit të II-të dhe të III-të, me përjashtim të UK Kavajë që bën pjesë në Grupin e I-rë. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot e O&M.
- Për vitin 2021 në sektor rezultojnë 21 shoqëri me tendencën negative të këtij treguesi që përbën rreth 36% të shoqërive në sektor dhe 37 shoqëri me tendencë pozitive që përbën rreth 64% të shoqërive në sektor, kjo është arsyeja që niveli i mbulimit të kostos OM për sektorin është me rritje të lehtë në krahasim me vitin paraardhës.
- Mbulimi i Kostove O&M është elementi bazë në propozimet e shoqërive për tarifa të reja duke argumentuar në mënyrë të detajuar kostot, si edhe ti raportojnë shpenzimet sipas qendrave të kostos për të orientuar tarifat tek kostot e secilit shërbim më vete. Detajimi i kostove shërben edhe si një element bazë për transparencën ndaj konsumatorëve.
- Nevoja për subvencione pritet të reduktohet me rajonalizimin e shoqërive UK, pasi shoqëritë në vështirësi financiare do të bashkohen duke ndikuar pozitivisht në treguesit financiarë të performancës në të ardhmen.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Treguesi financiar i performancës Mbulimi i Kostove Totale për vitin 2021 për të gjithë sektorin UK raportohet në nivelin 73.85% nga 74.91% që ishte në vitin 2020.

Nga 58 shoqëri UK janë vetëm dy shoqëri që përballojnë kostot totale të operimit me të ardhurat nga aktiviteti, përkatësisht UK Tiranë në nivelin 121.45% dhe UK Kolonjë në nivelin 102.57%, prandaj për këtë tregues analiza nuk është kryer sipas grupeve të shoqërive, por për sektorin në tërësi.

Në nivelin e performancës (50%-80% e mbulimit të kostos totale) raportohen 28 shoqëri, ndërsa në nivelin e performancës së mirë (mbi 80% e mbulimit të kostos totale) raportohen vetëm 10 shoqëri, dy prej të cilave e kanë nivelin e mbulimit mbi 100%.

Pjesa tjetër e shoqërive (20 shoqëri) bëjnë pjesë në brezin e performancës së dobët, me mbulimin e kostove totale deri në 50%, ku ka shoqëri me nivele minimale të mbulimit të kostove si: UK Vau Dejës (24.44%), UK Patos (27.44%), UK Këlcyrë (27.79%), UK Kurbin (30.10%), UK Pustec (30.96%), UK Kamëz (31.55%) dhe UK Kavajë (32.5%). Disa nga këto shoqëri por edhe të tjera me të ardhurat e tyre nuk mund të mbulojnë as kostot e punës prandaj të gjitha janë subjekt i subvencioneve të qeverisë qendrore.

Janë 24 shoqëri që kanë pasur tendencë pozitive (mbi 5% rritje) në drejtim të mbulimit të kostove totale me të ardhurat nga aktiviteti krahasuar me vitin 2020 që ishin 18 shoqëri. Kjo tendencë varion nga 5.8% UK Korçe, në 20.01% UK Selenicë. Numri i shoqërive nga (-4.92%) deri në 4.51% raportohen 18 shoqëri. Tendencë negative konstatohet në 24 shoqëri nga të cilat janë 14 shoqëri që raportojnë rënie të konsiderueshme të nivelit të këtij treguesi nga (-6.34%) në (-35%).

Kostot totale në sektor për vitin 2021 janë rritur me 374,2 milion lekë ose 3% krahasuar me vitin 2020. Në këtë rritje rreth 86%, ose 322.9 milion lekë i takon shoqërive të Grupit të I-rë. Ndërsa, të ardhurat e sektorit kanë shënuar një rritje me rreth 1.39% ose në vlerë 137 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës ku peshën kryesore të kësaj rritje e kanë shoqëritë e grupit të parë me rreth 70%.

Treguesi Mbulimi i Kostove Totale është në nivele të qëndrueshme krahasuar me një vit më parë por ka një rënie të lehtë (-1.06%) për shkak se rritja e kostove totale (3%) ka qenë më e lartë se rritja e të ardhurave nga aktiviteti (1.39%).

Gjithsesi në lidhje me treguesin e mbulimit të kostove totale kërkohet një analizë me e detajuar për çdo shoqëri dhe për secilin zë për të gjykuar për performancën e këtij treguesi. Ndonjë shoqëri si UK Lezha në dukje ka tregues të ulët të mbulimit të kostove totale (59,03%), por në fakt kjo shoqëri ka patur mjaft investime nga donatorët e huaj vitet e fundit, që megjithëse ajo i shlyen rregullisht principalin dhe interesat e kredive, këtë përqindje e ul në mënyrë drastike vlera mjaft e lartë e amortizimit që imponojnë investimet e reja. Konkretisht për këtë shoqëri ndërsa kostot e O&M janë rreth 146 milion lekë/vit, ato totale janë në vlerën rreth 360 milion lekë/vit, pra janë rreth 250% më të larta, të cilat vijnë si rezultat i kostove mjaft të larta të amortizimit, prej rreth 205 milion lekë/vit.

Tabela 15. Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Selenicë	UK	46.81	66.82	20.01
2	Delvinë	UK	48.95	68.88	19.93
3	Mat	UK	61.51	79.66	18.15
4	Sarandë	UK	56.50	74.01	17.51
5	Berat - Kuçovë	UK	79.07	95.42	16.35
6	Dibër	UK	83.36	99.52	16.16
7	Tepelenë	UK	33.83	47.96	14.13
8	Këlcyrë	UK	30.38	43.80	13.42
9	Finiq	UK	67.46	80.37	12.91
10	Tiranë	UK	109.10	121.45	12.35
11	Lushnje	UK	53.11	64.42	11.31
12	Rrogozhinë	UK	47.48	58.72	11.24
13	Peqin	UK	45.79	56.84	11.05
14	Pukë	UK	57.16	66.03	8.87
15	Malësi e Madhe	UK	73.07	81.67	8.60
16	Gjirokastrë	UK	75.38	83.89	8.51
17	Krujë	UK	60.31	68.79	8.48
18	Klos	UK	56.92	65.34	8.42
19	Lezhë	UK	51.14	59.03	7.89
20	Fier	UK	66.49	74.04	7.55
21	Dropull	UK	35.64	43.13	7.49
22	Skrapar	UK	41.15	48.57	7.42
23	Pogradec	UK	47.23	53.51	6.28
24	Patos	UK	21.32	27.44	6.12
25	Korçë	U	78.11	83.91	5.80
26	Librazhd	UK	94.42	98.93	4.51
27	Vlorë	UK	48.09	51.49	3.40
28	Përmet	UK	68.43	71.12	2.69
29	Pustec	UK	28.93	30.96	2.03
30	Mirditë	UK	53.44	55.42	1.98
31	Kavajë	UK	30.56	32.50	1.94
32	Elbasan	UK	66.97	67.65	0.68
33	Libohovë	U	50.43	51.07	0.64
34	Ura Vajgurore	UK	36.52	37.16	0.64
35	Fushë Arrëz	UK	35.56	36.04	0.48
36	Mallakastër	UK	46.09	46.28	0.19
37	Konispol	UK	32.88	32.99	0.11
38	Maliq	UK	62.94	61.75	-1.19
39	Divjakë	UK	44.98	43.31	-1.67
40	Himarë	UK	74.56	71.88	-2.68
41	Shkodër	UK	48.58	45.22	-3.36
42	Vorë	UK	88.93	84.57	-4.36
43	Gramsh	U	76.48	71.56	-4.92
44	Roskovec	UK	48.25	41.91	-6.34
45	Kurbin	UK	36.58	30.10	-6.48
46	Belsh	UK	65.12	58.01	-7.11
47	Has	UK	37.59	28.87	-8.72
48	Devoll	UK	95.69	85.84	-9.85
49	Poliçan	UK	64.08	53.76	-10.32
50	Vau i Dejës	UK	37.75	24.44	-13.31
51	Cërrik	UK	66.35	52.26	-14.09
52	Bulqizë	UK	81.70	61.93	-19.77
53	Durrës	UK	88.12	63.21	-24.91
54	Kamëz	UK	58.09	31.55	-26.54
55	Kukës	UK	77.58	50.10	-27.48
56	Tropojë	UK	80.15	49.75	-30.40
57	Kolonje	UK	137.57	102.57	-35.00
58	Memaliaj	UK		41.88	Shoqëri e re

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj dhe varet kryesisht nga faktorë manaxherial.

Në analizën e shoqërive sipas grupeve llogariten treguesi Norma e Arkëtimit Korrente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin 2021, si dhe treguesi Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku përfshihen dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.

Për vitin 2021 NAK rezulton 77.6% kundrejt 76.6% që ishte në vitin 2020, me një rritje prej 1%. Kjo tregon se niveli i normës së arkëtimit është pothuajse i njëjtë dhe i qëndrueshëm duke marrë në konsideratë edhe rritjen e çmimeve në përgjithësi sidomos në fundin e vitit 2021, e cila duhet të kishte ndikuar negativisht në pagesat e faturave nga klientët për shërbimet UK.

Shoqëritë, krahas arkëtimit të faturave korrente, bëjnë përpjekje edhe për vjeljen e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma, si lidhja e akt- marrëveshjeve shoqëri - klient për pagimin e tyre me këste.

Në mbyllje të vitit 2021 rezulton se nga debitë e prapambetura, janë arkëtuar rreth 1.4 miliard lekë. Në analizën e Grupeve, fokusi është NAK pasi efienca në mbledhjen e të ardhurave korrente është elementi kryesor i qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, por që gjithashtu rrit mundësinë e shlyerjes së debive të vjetra.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Grupi 1 - Norma e Arkëtimit Korrente (%)




Figura 8. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e I-rë, Viti 2021

Për vitin 2021, në Grupin e I-rë bëjnë pjesë 14 shoqëri, nga të cilat raportohen 6 shoqëri me performancë të mirë, pra me një normë arkëtimi korrente mbi 82%, që janë: UK Kamëz (98.4%), UK Lezhë (91.7%), UK Pogradec (90.6%), UK Berat-Kuçovë (84.7%), UK Tiranë (84.5%) dhe UK Lushnje (84.1%).

Në këtë grup, në brezin e performancës së dobët, me normë arkëtimi korrente nën 60% nuk ka asnjë shoqëri. Krahësuar me vitin 2020, ku dy shoqëritë UK Lushnje (54.84%) dhe UK Durrës (59.28%) të cilat kanë qenë në brezin e performancës së dobët kanë shënuar rritje, UK Lushnje (84.1%) dhe UK Durrës (76.4%).

Pjesa tjetër e shoqërive (8 shoqëri) bëjnë pjesë në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korrente 60%-82%.

Tabela 16. Ecuria e Normës së Arkëtimt Korrente për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Lushnje	UK	54.84	84.10	29.26
2	Durrës	UK	59.28	76.40	17.12
3	Kamëz	UK	93.29	98.40	5.11
4	Tiranë	UK	81.06	84.5	3.44
5	Pogradec	UK	87.98	90.60	2.62
6	Lezhë	UK	89.52	91.70	2.18
7	Elbasan	UK	66.26	68.30	2.04
8	Fier	UK	75.43	77.10	1.67
9	Korçë	UK	80.41	81.00	0.59
10	Kavajë	UK	74.70	74.90	0.20
11	Shkodër	UK	67.87	68.00	0.13
12	Sarandë	UK	72.29	68.60	-3.69
13	Berat - Kuçovë	UK	88.60	84.70	-3.90
14	Vlorë	UK	95.95	63.10	-32.85

Nga 14 shoqëri të analizuara, 10 prej tyre kanë shënuar përmirësim të treguesit NAK krahasuar me vitin 2020. Për vitin 2021 progresin më të madh e ka shënuar UK Lushnje me (+29.26%), UK Durrës me (+17.12%) UK Kamëz me (+5.11%) si dhe UK Tiranë (+3.44). Ndërsa, një pjesë e vogël e shoqërive që bëjnë pjesë në këtë grup (3 shoqëri) kanë shënuar përkeqësim të këtij treguesi, ku bie në sy UK Vlorë (-32.85%), por kjo rënie vjen si rezultat i raportimit të gabuar në vitin paraardhës.

Grupi 2 - Norma e Arkëtimit Korrente (%)




Figura 9. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e II-të, Viti 2021

Në Grupin e II-të, ku bëjnë pjesë 33 shoqëri, 9 prej tyre bëjnë pjesë në brezin e performancës së mirë, me një normë arkëtimi korrente mbi 82%, ku kryeson UK Poliçan me (98.4%), UK Vorë me (94.5%), U Gramsh me (93%), UK Maliq me (91.7%), UK Mat me (88.8%), duke vijuar me 4 shoqëri të tjera siç tregohet dhe në grafikun e mësipërm. Vihet re shoqëria UK Malësi e Madhe e cila në vitin 2020 ka qenë në krye të listës për grupin e parë me 95.56%, këtë vit është me rënie në 82.9%, kjo për shkak se të ardhurat e arkëtuara korrente kanë rënë me 2%.

Në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korrente 60%-82%, bëjnë pjesë 21 shoqëri, duke filluar nga U Bulqizë me 81.6% e duke vijuar deri tek U Selenicë me 60.9%. Nga këto shoqëri konstatohet se 15 prej tyre kanë pësuar rënie të këtij treguesi krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu, vihet re se pesë nga këto shoqëri kanë kaluar nga zona e performancës së mirë në vitin 2020, në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2021. Vlen të theksohet se shoqëria UK Librazhd për 2021 ka kaluar nga performancë e mirë në performancë të dobët me një rënie (-28.63%) që tregon se shoqëria nuk ka marrë masa për të mbledhur të ardhurat e faturuara. Në zonën e performancës së dobët, me normë arkëtimi korrente nën 60% përfshihen 3 shoqëri, përkatësisht **UK Librazhd, UK Roskovec dhe UK Kukës**. Tabela 17 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela 17. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Mirditë	UK	52.63	85.40	32.77
2	Dibër	UK	49.13	65.90	16.77
3	Kukës	UK	34.69	50.50	15.81
4	Mallakastër	UK	67.75	83.20	15.45
5	Maliq	UK	84.03	91.70	7.67
6	Poliçan	UK	90.92	98.40	7.48
7	Krujë	UK	60.00	66.30	6.30
8	Kolonje	UK	70.82	75.60	4.78
9	Tropojë	UK	61.12	65.40	4.28
10	Himarë	UK	79.94	84.20	4.26
11	Mat	UK	84.84	88.80	3.96
12	Roskovec	UK	52.74	56.60	3.86
13	Bulqizë	UK	77.77	81.60	3.83
14	Vorë	UK	90.82	94.50	3.68
15	Skrapar	UK	79.46	80.70	1.24
16	Selenicë	UK	60.00	60.90	0.90
17	Belsh	UK	73.42	72.20	-1.22
18	Gramsh	U	94.85	93.00	-1.85
19	Gjirokastrë	UK	73.29	71.00	-2.29
20	Divjakë	UK	69.98	66.00	-3.98
21	Kurbin	UK	72.41	67.30	-5.11
22	Devoll	UK	73.91	67.60	-6.31
23	Rrogozhinë	UK	77.84	71.00	-6.84
24	Përmet	U	69.06	61.80	-7.26
25	Vau i Dejës	UK	70.23	62.80	-7.43
26	Ura Vajgurore	UK	79.75	71.50	-8.25
27	Patos	UK	88.65	79.30	-9.35
28	Peqin	UK	84.11	72.30	-11.81
29	Malësi e Madhe	UK	96.56	82.90	-13.66
30	Cërrik	UK	82.06	65.30	-16.76
31	Delvinë	UK	91.74	73.70	-18.04
32	Dropull	UK	90.68	70.70	-19.98
33	Librazhd	UK	88.13	59.50	-28.63

Referuar tabelës së mësipërme, 16 shoqëri e kanë përmirësuar treguesin e NAK krahasuar me vitin e mëparshëm, kundrejt 17 shoqërive të cilat kanë shënuar përkeqësim. Ecurinë më të mirë e kanë UK Mirditë me (+32.77%), UK Dibër me (+16.77%), UK Kukës me (+15.81%), UK Mallakastër me (+15.45%) duke vijuar me pjesën tjetër të shoqërive deri tek U Selenicë e cila ka përmirësimin më të vogël (+0.9%). Ndërsa nga 17 shoqëri të cilat kanë rezultuar me përkeqësim të situatës për NAK, raportohen të jenë **UK Librazhd me (-28.63%), UK Dropull me (-19.98%), UK Delvinë me(-18.04), UK Cërrik me (-16.76%)** duke vijuar deri tek shoqëria UK Belsh me (-1.22%).




Figura 10. Norma e Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të, Viti 2021

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 11 shoqëri, nga të cilat vetëm UK Konispol dhe UK Pukë janë në nivelin e performancës së mirë (mbi 82% të nivelit të arkëtimit), respektivisht me 88.2% dhe 81.6%.

Në brezin e performancës së dobët (nën 60%) përfshihen katër shoqëri, përkatësisht UK Tepelenë (56.0%), UK Has (54.9%), dhe UK Finiq (49.7%).

Tabela 18 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela 18. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korrente për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Fushë Arrëz	UK	67.15	77.60	10.45
2	Këlcyrë	U	63.05	65.00	1.95
3	Klos	UK	60.67	62.20	1.53
4	Has	U	53.52	54.90	1.38
5	Finiq	UK	48.78	49.70	0.92
6	Pukë	UK	85.38	81.60	-3.78
7	Libohovë	U	66.10	61.60	-4.50
8	Pustec	UK	70.17	62.30	-7.87
9	Konispol	UK	98.52	88.20	-10.32
10	Tepelenë	UK	85.08	56.00	-29.08
11	Memaliaj	UK		51.69	

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, në Grupin e III-të 5 shoqëri kanë përmirësuar treguesin NAK, ku UK Fushë Arrëz ka rritjen më të madhe me (+10.45%). Gjashtë shoqëritë e tjera kanë pësuar rënie të këtij

treguesi, ku UK Tepelenë me (-29.08%) ka rënien më të madhe brenda këtij grupi, duke e kaluar shoqërinë në zonën e performancës së dobët për vitin 2021.

Përfundime

- Shoqëritë kanë raportuar për vitin 2021 të dhëna të ndara për secilin tregues. Gjithsesi edhe për këtë vit ekziston një marzhë gabimi në lidhje me treguesin NAK pasi ka disa shoqëri që ende konsiderojnë dhe i raportojnë debitë e krijuara gjatë vitit si shlyerje të debive të prapambetura, por që në fakt ato likuidohen nga klientët brenda vitit.
- Referuar sektori në tërësi, nga 58 shoqëri që kanë raportuar të dhëna për Normën e Arkëtimit Korrente, 16 shoqëri rezultojnë në brezin e performancës së mirë (mbi 82%), 35 shoqëri në brezin e pranueshëm (60%-82%) dhe 7 shoqëri në nivelin e performancës së dobët (nën 60%).
- Për vitin 2021, vërehet se 31 shoqëri kanë shënuar përmirësim të këtij treguesi, nga 25 që ishin në vitin 2020, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive (27 shoqëri) kanë pësuar regres gjatë vitit 2021.
- Për një pjesë të shoqërive të cilat konsiderohen shoqëri të reja ose shoqëritë që janë ende në proces riorganizimi nevojitet një saktësim i mëtejshëm i situatës dhe tendencës së ecurisë për këto tregues, vlerësimi i të cilave do të kryhet rast pas rasti.

2.3.5 Niveli i Matjes

Niveli i matjes shpreh raportin e lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Ky tregues ka patur tendencë pozitive vit pas viti dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën e 80.7%. Shoqëritë UK për vitin 2021 kanë raportuar instalimin e 25,986 matëseve të rinj, por përsëri nuk e kanë arritur nivelin e performancës së mirë 85% të vendosur nga ERRU për sektorin. Edhe për vitin 2021 vetëm shoqëria UK Devoll e paraqet këtë tregues në nivelin e 100%.

Megjithëse ka një përmirësim të treguesit, akoma disa shoqëri kanë shumë punë për të bërë sidomos shoqëritë që janë nën 50% të nivelit të matjes.

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre, prandaj pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive dhe një element që lehtëson problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve të mbikonsumit të tij.

Grupi 1 - Niveli i Matjes (%)




Figura 11 . Niveli i Matjes Grupi I-rë, Viti 2021

Referuar grafikut të mësipërm vërehet se në Grupin e I-rë, shoqëritë paraqesin trend pozitiv në përmirësim të këtij treguesi, prej të cilave 7 shoqëri UK e kanë nivelin matjes mbi 85%, UK Korçë 99.1%, UK Durrës 95.9%, UK Lushnje 95.7%, UK Sarandë 95%, UK Tiranë 89%, UK Lezhë 86% dhe UK Pogradec 85.7%. Vërehet se për 6 prej këtyre shoqërive ka patur trend pozitiv rritës të këtij treguesi krahasuar me vitin 2020.

Pjesa tjetër e shoqërive janë nën kufirin e 85%, por për 5 prej tyre vërehet një përmirësim, UK Berat Kuçova nga 74.93% në 78.20%, UK Elbasan 74.08% në 75.6%, UK Fier nga 66.63% në 72.10%, UK Shkodër nga 69.53% në 71.1% dhe UK Vlora nga 60.24% në 65.50%. Me rënie paraqiten shoqëritë UK Pogradec nga 89.01% në 83.70% për shkak të aktivizimit të kontratave joaktive në aktive, por të pa pajisura me matësja uji dhe UK Kamëz nga 85.14% në 77% për arsye të rritjes së numrit të lidhjeve pa matës pasi kanë zgjeruar zonën e shërbimit me rreth 6 mijë abonentë në zonën e Babrrusë.

Në tabelën 19 të mëposhtme jepet ecuria për treguesin e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit

Tabela 19. Ecuria e Nivelit të Matjes Grupi I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Fier	UK	66.63	72.10	5.47
2	Vlorë	UK	60.24	65.50	5.26
3	Berat - Kuçovë	UK	74.93	78.20	3.27
4	Shkodër	UK	69.53	71.10	1.57
5	Elbasan	UK	74.08	75.60	1.52
6	Durrës	UK	95.03	95.90	0.87
7	Tiranë	UK	88.84	89.50	0.66
8	Lushnje	UK	95.35	95.70	0.35
9	Sarandë	UK	94.75	95.00	0.25
10	Korçë	UK	99.00	99.10	0.10
11	Lezhë	UK	85.91	86.00	0.09
12	Kavajë	UK	41.19	40.90	-0.29
13	Pogradec	UK	89.01	85.70	-3.31
14	Kamëz	UK	85.14	77.00	-8.14

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2021




Figura 12. Niveli i Matjes Grupi II-të, viti 2021

Gjatë vitit 2021, në Grupin e II-të janë 33 shoqëri nga 34 që ishin për vitin 2020 kjo nga kalimi i pragut të lidhjeve, nga ndarja e dy shoqërive UK Tepelenë me UK Memaliaj të cilat si rezultat janë bërë pjesë e Grupit të III-të.

Mbi kufirin e performancës së mirë (mbi 85%) performojnë 13 shoqëri UK duke filluar me UK Devoll në nivelin 100 % deri tek UK Gramsh 88.9%, të cilat kryesisht vijojnë të kenë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2020.

Nën nivelin e 85% deri në 50% të treguesit të nivelit të matjes janë 12 shoqëri, duke filluar me UK Vau Dejës 83.6% deri tek UK Dibër 58.8% ndërkohë që 3 prej këtyre shoqërive UK Krujë, UK Mat dhe UK Dibër kanë përkeqësim të këtij treguesi të ndikuar kryesisht nga temperaturat ekstreme gjatë dimrit të cilat kanë ndikuar në dëmtimin matësve.

Në shoqëritë me performancë të dobët përkeqësim të këtij treguesi ka patur UK Skrapar edhe kjo si rezultat i temperaturave ekstreme gjatë dimrit të cilat kanë ndikuar në dëmtimin e matësve.

Përmirësim të ndjeshëm të treguesit paraqesin 5 shoqëri UK Selenicë (+14.77%) sepse janë bërë investime me pajisjen e abonentëve aforfe me matësa uji në fshatin Kote, Armen dhe Selenicë qytet. UK Delvinë (+12.99%), UK Vau i Dejës (+7.72 %), U Gramsh (+6.09%), UK Malësi e Madhe (+5.37%) dhe UK Vorë (+4.61%).

Ecuria e treguesit të nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet më poshtë në tabelën 20.

Tabela 20. Ecuria e Nivelit të Matjes, Grupi II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Selenicë	UK	8.53	23.30	14.77
2	Delvinë	UK	58.71	71.70	12.99
3	Vau i Dejës	UK	75.88	83.60	7.72
4	Gramsh	U	82.81	88.90	6.09
5	Malësi e Madhe	UK	70.43	75.80	5.37
6	Vorë	UK	78.29	82.90	4.61
7	Mallakastër	UK	60.35	63.20	2.85
8	Bulqizë	UK	22.88	25.30	2.42
9	Divjakë	UK	96.52	98.90	2.38
10	Roskovec	UK	94.51	96.80	2.29
11	Ura Vajgurore	UK	94.36	96.60	2.24
12	Gjirokastër	UK	59.68	61.30	1.62
13	Mirditë	UK	68.53	70.10	1.57
14	Përmet	U	92.01	93.00	0.99
15	Peqin	UK	97.44	98.20	0.76
16	Kukës	UK	37.02	37.40	0.38
17	Himarë	UK	92.48	92.80	0.32
18	Cërrik	UK	82.34	82.60	0.26
19	Librazhd	UK	98.90	99.10	0.20
20	Belsh	UK	91.52	91.70	0.18
21	Rrogozhinë	UK	94.53	94.70	0.17
22	Patos	UK	33.14	33.20	0.06
23	Dropull	UK	18.66	18.70	0.04
24	Kolonjë	UK	40.46	40.50	0.04
25	Devoll	UK	100.00	100.00	0.00
26	Poliçan	UK	65.52	65.50	-0.02
27	Tropojë	UK	89.36	89.10	-0.26
28	Maliq	UK	89.60	89.20	-0.40
29	Dibër	UK	59.66	58.80	-0.86
30	Kurbin	UK	22.20	21.10	-1.10
31	Mat	UK	72.76	70.20	-2.56
32	Krujë	UK	79.43	76.00	-3.43
33	Skrapar	UK	38.10	33.20	-4.90

Grupi 3 - Niveli i Matjes (%)




Figura 13. Niveli i Matjes Grupi III-të, Viti 2021

Në Grupin e III-të ku bëjnë pjesë 11 shoqëri, janë 3 shoqëri në nivelin mbi 85% të këtij treguesi përkatësisht UK Pustec, UK Konispol dhe UK Këlcyrë të cilat kanë patur tendencë përmirësimi edhe gjatë vitit 2021.

Tendencë përmirësimi të treguesit nga të dhënat e raportuara shfaqin 5 shoqëri UK Pukë (+23.39%) për arsye të vendosjes së 462 matësve uji, U Klos (+18.32%) për arsye të vendosjes së 396 matësve UK Finiq me (+2.59%), UK Këlcyre (+2.3%) dhe UK Fushë Arrës me (+1.60%).

Edhe këtë vit në nivelin më të ulët të treguesit niveli i matjes performon shoqëria UK Libohovë, e cila pothuajse i ka të pamatur të gjithë kategoritë e konsumatorëve dhe nuk bën asnjë përpjekje për përmirësimin e këtij treguesi duke qëndruar në nivelin e matjes nën 2%.

Ecuria e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 21.

Tabela 21. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Pukë	UK	59.31	82.70	23.39
2	Klos	U	27.28	45.60	18.32
3	Finiq	UK	57.21	59.80	2.59
4	Këlcyrë	UK	93.00	95.30	2.30
5	Fushë Arrëz	UK	45.60	47.20	1.60
6	Konispol	UK	98.23	99.00	0.77
7	Has	UK	71.84	72.40	0.56
8	Pustec	UK	99.59	99.60	0.01
9	Libohovë	UK	1.84	1.80	-0.04
10	Tepelenë	UK	68.94	67.60	-1.34
11	Memaliaj	UK		74.13	0.00

- Matja e konsumit të ujit paraqet domosdoshmëri për mirëmanaxhimin e aktivitetit të shoqërisë. Vlerat sa më të larta të treguesit të nivelit të matjes çojnë në uljen e niveli të shpërdorimit të ujit, rrjedhimisht duke ulur kërkesën për ujë rrit orët e furnizimit me ujë, pra përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.
- Niveli i matjes për vitin 2021 në rang sektori është 80.7 %, krahasuar me vitin 2020 ky tregues është përmirësuar me 0.7%. Edhe pse ky tregues ka trend në përmirësim kërkohet që shoqëritë UK ti kushtojnë më shumë vëmendje vendosjes së matësve në përmbushje të arritjes së objektivit prej 85% të performancës së mirë të vendosur nga ERRU.
- Gjatë vitit 2021 në sektor janë instaluar 25,986 matës të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës në rang sektori ka shkuar 743,709 lidhje nga 921,158 lidhje UK që janë në total në të gjithë shoqëritë.
- Në sektor janë 10 shoqëri UK të cilat e kanë nën 50% treguesin e nivelit të matjes. Për këto shoqëri kërkohet një angazhim serioz në përmirësimin e këtij treguesi për të bërë të mundur eliminimin e praktikës aforfe, si dhe pajisja 100% me matës të konsumatorëve privat.
- Për vitin 2021 janë 23 shoqëri UK që operojnë për këtë tregues mbi nivelin e performancës së mirë 85%. Nga këto shoqëri 7 janë në grupin e parë, 13 në grupin e dytë dhe 3 shoqëri në grupin e tretë.
- Në sektorin UK, për të dytin vit radhazi, vetëm shoqëria UK Devoll ka nivelin e matjes 100%.
- Pjesa e konsumatorëve që faturohen aforfe me 150 litra/ditë, banor, nuk është korrekte pasi shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të supozuar, por pjesa tjetër abuzojnë pasi kanë shtëpi private apo janë në zona rurale ku konsumi për shkak të përdorimit të ujit për ujtime është realisht më i madh së faturimi. Nga ana financiare shoqëritë përfitojnë në mënyrë jo korrekte duke faturua volum më të madh sesa konsumojnë realisht konsumatorët.
- Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbi konsumit në sisteme.

2.3.6 Efienca e Stafit

Treguesi i efiençës së stafit praqet raportin e numrit të punonjësve të shoqërisë mbi totalin e numrit të lidhjeve të ujësjellës kanalizimeve të ujërave të ndotura që administron shoqëria.

Treguesi i Efiençës së Stafit siç u trajtua edhe më sipër tek gjendja e sektorit, për arsye krahasimore me vitin paraardhës, edhe për këtë vit do të analizohet duke përfshirë numrin e stafit sipas organigramës së shoqërisë dhe numrin e nënkontraktorëve që janë kryesisht personeli roje.

Ecuria e efiençës së stafit, në të ardhmen do të trajtohet pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar e cila do të merret si bazë krahasimi për vitin e ardhshëm 2022 ku dhe do të realizohet analiza e këtij treguesi duke marrë në konsideratë vetëm stafin organik të shoqërisë sipas organigramës. Kjo i vë të gjitha shoqëritë UK në të njëjtën bazë krahasimi për performancën e këtij treguesi.

Duke qenë se kostoja e personelit zë një përqindje të madhe 47% të kostove O&M treguesi i efiençës së stafit është tregues mjaft i rëndësishëm në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, si edhe me potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiençës në punë.

Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin e punës që presupozohet të kryejnë. Fatkeqësisht sektori paraqitet akoma i mbingarkuar me

staf të pajustificuar që në mjaft raste janë të punësuar pa arsimin dhe kualifikimet përkatëse dhe bazuar në kritere partiake. Kjo pjesë e stafit përveç se është jo efikase, dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit si shembull negativ i performancës në punë.

Për vitin 2021 sektori e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 8,616 punonjësish (punonjësit e vet dhe nënkontraktorët) nga 8,425 punonjës që janë raportuar në vitin 2020, pra ka rritur stafin me 191 punonjës, ndërkohë që rritja e numrit të lidhjeve të ujit është rritur me 19,016 lidhje dhe ai i kanalizimeve me 2,089 lidhje duke mos dhënë kështu impakt pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi i cili për vitin 2021 është 5.37 punonjës për 1000 lidhje nga 5.32 që ishte në vitin 2020.

Rritja e numrit të punonjësve justifikohet nga shoqëritë për shkaqe të specifike të operimit dhe ofrimit të shërbimit, zgjerimit të zonave të shërbimit, zbatimit të projekteve të ndryshme UK apo për të garantuar sigurinë e veprave me personel roje.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Për Grupin e I-rë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët. Figura 14 jep grafiksht Eficientën e Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive UK

Grupi 1 - Eficienta e Stafit (staf / 1000 lidhje UK)




Figura 14. Eficienta e Stafit për Grupin e I-rë, Viti 2021

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëritë UK Korçë me 2.37 punonjës për 1000 lidhje, UK Kamëz me 3.86 punonjës për 1000 lidhje dhe UK Tiranë me 3.87 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 10 shoqëri nga UK Lezhë me 4.25 punonjës për 1000 lidhje deri tek UK Elbasan me 5.89 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së dobët për të dytin vit radhazi është shoqëria UK Kavajë me 7.29 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 22 paraqet ecurinë e treguesit të Efijencës së Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 22. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (staf/1000 lidhje)	2021 (staf/1000 lidhje)	Ndryshimi 2021-2020 (staf/1000 lidhje)	2021* (staf/1000 lidhje)
1	Fier	UK	6.19	5.01	-1.18	4.63
2	Vlorë	UK	4.90	4.44	-0.46	3.42
3	Lushnje	UK	5.61	5.35	-0.26	5.35
4	Kavajë	UK	7.29	7.11	-0.18	7.11
5	Sarandë	UK	4.97	4.87	-0.10	4.87
6	Korçë	UK	2.47	2.37	-0.10	2.37
7	Pogradec	UK	5.89	5.79	-0.10	5.6
8	Lezhë	UK	4.29	4.25	-0.04	4.25
9	Berat - Kuçovë	UK	4.85	4.89	0.04	4.89
10	Durrës	UK	5.16	5.31	0.15	5.31
11	Tiranë	UK	3.70	3.87	0.17	2.68
12	Shkodër	UK	5.46	5.85	0.39	5.29
13	Kamëz	UK	3.33	3.86	0.53	3.86
14	Elbasan	UK	4.63	5.89	1.26	5.3

* Treguesi i Efijencës së Stafit për vitin 2021 pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar

Për Grupin e I-rë të shoqërive ecurinë më të mirë e ka patur UK Fier me (-1.18) punonjës për 1000 lidhje duke vijuar më tej me 7 shoqëri të tjera të cilat kanë patur tendencë pozitive minimale dhe konkretisht UK Vlorë (-0.46), UK Lushnje (-0.26), UK Kavajë (-0.18), UK Sarandë, UK Korçë dhe UK Pogradec me (-0.10) si dhe UK Lezhë (-0.04) punonjës për 1000 lidhje.

Ecurinë më të madhe negative e ka patur UK Elbasan (+1.26) punonjës për 1000 lidhje si rezultat i shtimit të stafit organik me 51 punonjës gjatë vitit 2021, kryesisht punonjës së task forcës dhe në sektorin juridik. Pjesa tjetër e shoqërive të grupit të I-rë, kanë tendencë negative përgjithësisht të vogël duke filluar nga UK Berat Kuçovë (+0.04) deri tek UK Kamëz (+0.53) punonjës për 1000 lidhje.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Për Grupin e II-të, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 15 jep grafikisht Efiçencën e Stafit për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 15. Efiçenca e Stafit për Grupin e II-të, viti 2021

Në këtë grup në nivelin e performancës së mirë për të dytin vit radhazi bëjnë pjesë 4 shoqëri si UK Kolonjë, UK Librazhd, UK Dibër dhe UK Maliq të cilat me përjashtim të UK Librazhd e kanë përmirësuar më tej këtë tregues përkatësisht me (-1.22), (-1.2) dhe (-0.04) punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 20 shoqëri duke filluar nga UK Cërrik deri tek UK Vau Dejës që variojnë brenda kufirit prej 6.45 deri 9.63 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e performancës së dobët me mbi 10 punonjës për 1000 lidhje renditen 9 shoqëri, duke filluar me UK Patoš 17.7 punonjës për 1000 lidhje e cila ka dhe efiçencën më të dobët në këtë grup, UK Peqin me tregues 16.47, UK Mallakastër me 15.94, UK Vorë me 12.37, UK Malësi e Madhe me 12.14, e deri tek UK Tropojë me 10.02 punonjës për 1000 lidhje UK.

Nisur nga tabela 23 e mëposhtme ecurinë më të mirë në nivelin e nën 1 punonjës që është përcaktimi që ERRU konsideron pozitiv e ka patur UK Peqin (-6.33), UK Selenicë (-1.93) dhe UK Skrapar (-1.2) punonjës për 1000 lidhje. Gjithashtu në këtë grup janë edhe 15 shoqëri me ecuri pozitive me lehtë duke filluar me UK Malësi e Madhe (-0.84) deri tek UK Krujë (-0.03) punonjës për 1000 lidhje.

Tendencë të lartë negative të këtij treguesi kanë pasur 3 shoqëri si UK Devoll me (+1.25) e cila është edhe shoqëria me tendencën më të lartë negative në Grupin e II-të pasuar nga UK Mat me (+0.94) dhe UK Kukës me (+0.81) punonjës për 1000 lidhje.

Për UK Devoll përkeqësimi ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve me (+12) punonjës dhe rritjes së numrit të lidhjeve me ujë vetëm me (+94) lidhje për vitin 2021.

Tabela 23 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e II-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 23. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (staf/1000 lidhje)	2021 (staf/1000 lidhje)	Ndryshimi 2021-2020 (staf/1000 lidhje)	2021* (staf/1000 lidhje)
1	Peqin	UK	22.80	16.47	-6.33	16.47
2	Selenicë	U	11.55	9.62	-1.93	9.62
3	Skrapar	UK	9.16	7.96	-1.20	7.96
4	Malësi e Madhe	UK	12.98	12.14	-0.84	12.14
5	Kolonjë	UK	4.31	3.79	-0.52	3.79
6	Divjakë	UK	11.55	11.13	-0.42	11.13
7	Roskovec	UK	9.29	8.95	-0.34	8.95
8	Vau i Dejës	UK	9.94	9.63	-0.31	9.63
9	Kurbin	UK	9.17	8.89	-0.28	8.89
10	Bulqizë	U	10.28	10.03	-0.25	7.85
11	Maliq	UK	5.64	5.43	-0.21	5.43
12	Përmet	U	7.36	7.21	-0.15	7.21
13	Gramsh	U	8.87	8.75	-0.12	8.75
14	Belsh	UK	9.74	9.63	-0.11	9.63
15	Himarë	UK	6.75	6.65	-0.10	6.65
16	Tropojë	UK	10.11	10.02	-0.09	10.02
17	Gjirokastër	UK	9.44	9.39	-0.05	8.58
18	Krujë	UK	6.88	6.85	-0.03	5.71
19	Dropull	UK	7.02	7.02	0.00	7.02
20	Poliçan	UK	8.10	8.10	0.00	8.1
21	Delvinë	UK	7.32	7.34	0.02	7.34
22	Ura Vajgurore	UK	9.50	9.59	0.09	9.59
23	Mirditë	UK	11.11	11.31	0.20	11.31
24	Cërrik	UK	6.14	6.45	0.31	6.45
25	Rrogozhinë	UK	7.54	7.86	0.32	7.86
26	Librazhd	UK	4.98	5.30	0.32	5.3
27	Mallakastër	UK	15.61	15.94	0.33	15.94
28	Dibër	UK	6.00	6.34	0.34	5.34
29	Vorë	UK	12.02	12.37	0.35	12.37
30	Patos	UK	17.12	17.70	0.58	17.7
31	Kukës	UK	6.63	7.44	0.81	7.44
32	Mat	UK	6.36	7.30	0.94	6.46
33	Devoll	UK	5.28	6.53	1.25	6.53

* Treguesi i Efijencës së Stafit për vitin 2021 pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2021

Për Grupin e III-të niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Në këtë grup për vitin 2021 siç është theksuar më lart janë shtuar dy shoqëri UK Tepelenë e cila më parë ka qenë pjesë e grupit të dytë dhe UK Memaliaj e cila raporton për herë të parë pas ndarjes me UK Tepelenë. Për efekt analize UK Memaliaj është pasqyruar vetëm tek tabela e ecurisë së grupit dhe do jetë objekt analize në vitin e ardhshëm 2022.

Figura 16 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 16. Eficienca e Stafit për Grupin e III-të, Viti 2021

Në Grupin e III-të performuesi më i mirë vijon të jetë UK Fushë - Arrëz 8.61 punonjës për 1000 lidhje i cili ndiqet më tej nga UK Pukë me 8.78 dhe UK Tepelenë 9.88 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme për këtë grup janë 5 shoqëri si UK Finiq 10.23, UK Konispol 10.5, UK Libohovë 12.48, UK Pustec 12.62 dhe UK Klos 13.7 punonjës për 1000 lidhje duke kaluar kështu në brezin e performancës së pranueshme nga ai i dobët që ishte në vitin 2020.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 2 shoqëri, UK Këlcyrë 19.3 dhe UK Has me 20.43 punonjës për 1000 lidhje e cila vijon të renditet e fundit në Grupin e III-të.

Tabela 24 paraqet ecurinë e treguesit të Eficiencës së Stafit për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 24. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (staf/1000 lidhje)	2021 (staf/1000 lidhje)	Diferenca 2021-2020 (staf/1000 lidhje)	2021* (staf/1000 lidhje)
1	Klos	U	15.76	13.71	-2.05	13.71
2	Finiq	UK	11.29	10.23	-1.06	10.23
3	Pukë	UK	9.59	8.78	-0.81	8.78
4	Këlcyrë	UK	20.08	19.30	-0.78	19.3
5	Konispol	UK	10.81	10.50	-0.31	10.5
6	Pustec	UK	12.79	12.62	-0.17	12.62
7	Fushë Arrëz	UK	8.76	8.61	-0.15	8.61
8	Has	UK	20.25	20.43	0.18	20.43
9	Libohovë	UK	11.17	12.48	1.31	12.48
10	Tepelenë	UK	8.46	9.88	1.42	9.88
11	Memaliaj	UK		7.43	0	7.43

* Treguesi i Efijencës së Stafit për vitin 2021 pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar

Ndryshim pozitiv të ndjeshëm mbi 1 punonjës për 1000 lidhje kanë pasur shoqëritë UK Klos (-2.05), UK Finiq (-1.06), por përsëri mbasin në brezin e performancës së pranueshme me 13.71 dhe 10.23 punonjës për 1000 lidhje. Gjithashtu tendencë pozitive kanë pasur edhe shoqëritë UK Pukë (-0.81) deri tek UK Fushë Arrëz me (-0.15) punonjës për 1000 lidhje UK.

Tendencën negative më të madhe e ka UK Tepelenë me (+1.42) punonjës për 1000 lidhje, si rezultat i largimit të numrit të lidhjeve UK me 3327 lidhje pas ndarjes me UK Memaliaj dhe UK Libohovë me (+1.31) punonjës për 1000 lidhje pasi ka shtuar stafin me 2 punonjës ndërkohë që numri i lidhjeve ka mbetur i njëjtë me vitin paraardhës.

Gjithsesi vlerësimi i performancës për të tre grupet e këtij treguesi duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishme të veçantë. Kjo influencë është më e dukshme në shoqëritë e vogla që i përkasin Grupit të III-të.

Përfundime

- Në mbyllje të vitit 2021, treguesi staf për 1000 lidhje ka pësuar përkeqësim të lehtë me vitin paraardhës.
- Rritja e numrit të punonjësve me 191 punonjës në rang sektori e ka zvogëluar efektin pozitiv të rritjes së lidhjeve UK të cilat janë rritur me rreth 19,016 lidhje uji dhe 2,089 lidhje KUN.
- Rritja e numrit të punonjësve justifikohet në pjesën më të madhe të tyre nga zhvillimet në sektor, riorganizimi i shoqërive dhe zgjerimi i zonës së shërbimit.
- Rritja e numrit të punonjësve ka ndikuar edhe në rritjen e kostove të punës të cilat zënë dhe peshën kryesore në totalin e kostove O&M. Nevoja për përmirësimin e këtij treguesi ka rëndësi të veçantë pasi lidhet me objektivin strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare ku përmirësimi i efijencës së stafit është një nga elementet thelbësor për përmirësimin e efijencës financiare të shoqërisë.
- Nxitja, motivimi dhe trajnimi i stafeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale do të ndikonte në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.
- Mbetet problem mbingarkimi artificialisht me staf (roje), për të cilin duhet të rishikohet kuadri ligjor përkatës për garantimin e veprave të sigurisë së veçantë, si depo, stacione pompimi, puse me zgjidhje alternative teknike të kombinuara me logjistikë survejimi dhe sinjalizimi.

- ERRU do ti kushtojë një vëmendje të veçantë shqyrtimit të organigramës së stafit të shoqërive UK kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja duke u treguar agresive në vendosjen e objektivit për secilën shoqëri në mënyrë që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.

Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së shërbimit të një shoqërie është mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët. Si një nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, qëndron në vendet e para të listës së prioriteteve, pasi përmirësimi i saj redukton kërkesën për të mbivlerësuar nga shpërdorimet dhe lidhjet e paligjshme, për rrjedhojë dhe eliminon nevojën për shtim artificial të burimeve të tjera. Veçanërisht atje ku furnizimi është shumë më pak nga objektivi i përgjithshëm i shërbimit prej 24 orësh, çdo zgjatje e orarit të shërbimit do të vihet re dhe mirëpritet nga konsumatorët, mesatarja aktuale e sektorit është 15.4 orë/ditë dhe ka pësuar rritje me 1.6 orë në ditë nga viti paraardhës.

Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete. Referuar të dhënave nga AKUM, aktualisht shoqëritë UK vetëm në 27 qendra urbane ofrojnë ujë 24/7 orë, Korçë, Lezhë, Librazhd, Devoll, Përmet, Gramsh, Poliçan, Bulqizë, Fushë Arrëz, Rrëshen, Pustec etj. Kuptohet referuar të gjithë zonës së shërbimit, ku përfshihet edhe zona rurale, koha e furnizimit me ujë është nën 24 orë/ditë, siç jepet në tabelat përkatëse për secilin grup shoqëri.

Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë/ditë ende është larg për tu arritur nga shumë shoqëri, siç do vërehet në analizën e shoqërive sipas grupeve.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2021




Figura 17. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e I-rë, Viti 2021

Në Grupin e I-rë të shoqërive, bëjnë pjesë 14 shoqëri UK, për vitin 2021 vetëm pesë shoqëri arrijnë të furnizojnë konsumatorët me mbi 18 orë/ditë që është dhe kufiri i performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Gjatë vitit 2021, përmirësim të këtij treguesi raportojnë shoqëritë UK Lushnje (+5 orë/ditë), UK Durrës (+4.1 orë/ditë), UK Lezhë (+3 orë/ditë), UK Tiranë (+1.56 orë/ditë), UK Elbasan (+1.1 orë/ditë), UK Berat Kuçovë (+1 orë/ditë), UK Vlorë (+1 orë/ditë), ndërsa shoqëritë e tjera nuk kanë patur ndryshime të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë krahasuar me vitin 2020, përveç UK Shkodër (-0.5 orë/ditë).

Shoqëritë UK Korçë, UK Lezhë janë për këtë vit të vetmet shoqëri në këtë grup që arrijnë të furnizojnë me ujë 24 orë/ditë, duke u ndjekur nga UK Fier (22 orë/ditë), UK Shkodër (21.2 orë/ditë), UK Pogradec (20.4 orë/ditë).

Shoqëria me performancë më të dobët për këtë grup dhe shumë larg realizimit të treguesit ose përafrimit të vlerave të grupit vazhdon të jetë UK Kamëz me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 4 orë/ditë e cila nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta përmirësuar këtë tregues.

Ecuria e këtij treguesi për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit paraqitet në tabelën 25, ku vlen të përmendet se shoqëritë me ecuri më të mirë krahasuar me vitin 2020, janë UK Lushnje (+ 5) orë/ditë, UK Durrës (+4.1) orë/ditë, UK Lezhë (+3) orë/ditë dhe UK Tiranë (+1.56) orë/ditë që kanë përmirësuar orët e furnizimit me ujë, ndërsa shoqëria me ecurinë më të keqe për vitin 2021 është UK Shkodër (-0.5) orë/ditë.

Të gjitha shoqëritë e Grupit të I-rë duhet të kenë në fokus kryesor përmirësimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë sepse si shoqëri të mëdha ato mbulojnë me shërbim pjesën më të madhe të popullsisë në vend.

Tabela 25. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (orë/ditë)	2021 (orë/ditë)	Ndryshimi 2021-2020 (orë/ditë)
1	Lushnje	UK	5.00	10.00	5.00
2	Durrës	UK	9.00	13.10	4.10
3	Lezhë	UK	21.00	24.00	3.00
4	Tiranë	UK	15.44	17.00	1.56
5	Elbasan	UK	12.50	13.60	1.10
6	Berat - Kuçovë	UK	14.00	15.00	1.00
7	Vlorë	UK	13.00	14.00	1.00
8	Korçë	UK	24.00	24.00	0.00
9	Fier	UK	22.00	22.00	0.00
10	Pogradec	UK	20.40	20.40	0.00
11	Kavajë	UK	10.00	10.00	0.00
12	Sarandë	UK	10.00	10.00	0.00
13	Kamëz	UK	4.00	4.00	0.00
14	Shkodër	UK	21.70	21.20	-0.50

Grupi 2 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 18. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e II-të, Viti 2021

Në Grupin e II-të përbërë prej 33 shoqëri, 11 prej tyre arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë 6 (gjashtë) shoqëri UK Devoll, UK Gramsh, UK Librazhd, UK Poliçan, UK Bulqizë dhe UK Përmet, ndërsa për 5 (pesë) shoqëri UK Rrogozhinë, UK Selenicë, UK Dropull, UK Roskovec, UK Kurbin niveli i këtij treguesi është nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë).

Edhe për këtë vit UK Roskovec (5 orë/ditë) dhe UK Kurbin (4 orë në ditë), janë performuesit më të dobët në grup.

Gjatë vitit 2021, përmirësim të orëve të furnizimit me ujë kanë patur shoqëritë UK Malësi e Madhe (+7.9) orë/ditë kjo ka ardhur nga ulja e popullsisë në zonën e shërbimit pasi u bënë rakordimet me popullsinë e gjendjes civile, UK Divjakë (+5.6) orë/ditë, UK Bulqizë (+4,5) orë/ditë, UK Dibër (+3) orë/ditë si dhe UK Kukës, UK Ura Vajguore, UK Vau i Dejës, UK Skrapar me nga (+2) orë/ditë.

Ky tregues ka pësuar përkeqësim të ndjeshëm për shoqërinë UK Belsh (-9.5 orë/ditë), kjo sipas shoqërisë ka ardhur se kishin përdorur një logjikë të gabuar në vlerësimin e këtij treguesi për vitin 2020 dhe këtë vit kanë bërë korrigjimet përkatëse, duke e kaluar këtë shoqëri nga një shoqëri me performancë të mirë me 18 orë në ditë furnizim me ujë, në kufirin e performancës së dobët me 8,5 orë në ditë. E njëjta situatë përkeqësimi dhe për UK Delvinë (-3) orë/ditë, ku shprehet se kanë bërë një vlerësim të gabuar të këtij treguesi në vitin 2020.

Ecuria e shoqërive në Grupin e II-të për dy vitet e fundit pasqyrohet në tabelën 26.

Tabela 26. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (orë/ditë)	2021 (orë/ditë)	Ndryshimi 2021-2020 (orë/ditë)
1	Malësi e Madhe	UK	11.10	19.00	7.90
2	Divjakë	UK	6.00	11.60	5.60
3	Bulqizë	UK	19.50	24.00	4.50
4	Dibër	UK	8.00	11.00	3.00
5	Kukës	UK	8.40	10.50	2.10
6	Ura Vajgurore	UK	10.00	12.00	2.00
7	Delvinë	UK	6.00	8.00	2.00
8	Skrapar	UK	12.00	14.00	2.00
9	Vau i Dejës	UK	9.00	10.00	1.00
10	Roskovec	UK	4.45	5.00	0.55
11	Devoll	U	24.00	24.00	0.00
12	Gramsh	UK	24.00	24.00	0.00
13	Librazhd	UK	24.00	24.00	0.00
14	Polican	UK	24.00	24.00	0.00
15	Cërrik	U	22.00	22.00	0.00
16	Kolonje	UK	21.00	21.00	0.00
17	Peqin	UK	20.00	20.00	0.00
18	Himarë	UK	16.00	16.00	0.00
19	Mirditë	UK	15.00	15.00	0.00
20	Gjirokastrë	UK	13.00	13.00	0.00
21	Mallakastër	UK	11.00	11.00	0.00
22	Krujë	UK	8.00	8.00	0.00
23	Vorë	U	8.00	8.00	0.00
24	Selenicë	UK	7.00	7.00	0.00
25	Kurbin	UK	4.00	4.00	0.00
26	Mat	UK	18.00	18.00	0.00
27	Përmet	UK	24.00	24.00	0.00
28	Patos	UK	12.00	11.50	-0.50
29	Rrogozhinë	UK	9.00	7.50	-1.50
30	Maliq	UK	19.00	17.10	-1.90
31	Tropojë	UK	21.00	19.00	-2.00
32	Dropull	UK	10.00	6.50	-3.50
33	Belsh	UK	18.00	8.50	-9.50

Grupi 3 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 19. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të, Viti 2021

Në Grupin e III-të të përbërë nga 11 shoqëri, 7 prej tyre arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë shoqëritë UK Fushë Arrëz dhe UK Pustec. Përmirësim të ndjeshëm të orëve të furnizimit me ujë për vitin 2021 e ka patur UK Pustec me 15.4 orë/ditë dhe UK Libohovë me 9 orë/ditë për shkak të investimeve që janë kryer duke i renditur, për vitin 2021, këto shoqëri tek shoqëritë me performancë të mirë.

Për vitin 2021, në këtë grup janë shtuar 2 shoqëri UK Tepelenë dhe UK Memaliaj. Sqarojmë se UK Tepelenë ka kaluar në grupin e III për shkak të uljes së numrit të lidhjeve pas largimit të aksionarit Bashkia Memaliaj. Kjo e fundit ka krijuar shoqërinë e re të licencuar UK Memaliaj, e cila ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 17.5 orë duke u renditur tek shoqëritë me performancë të mirë.

Rënie më të madhe të këtij treguesi ka patur UK Tepelenë (-4) orë/ditë, kjo ka ardhur për shkak të ndarjes nga kjo shoqëri të aksionarit Bashkia Memaliaj, UK Këlcyrë me (-2) orë/ditë ku sipas shoqërisë ka ardhur nga një raportim jo i saktë në vitin 2020, e ndjekur më pas nga UK Pukë (-1) orë/ditë dhe UK Konispol (-1) orë/ditë, por përsëri mbeten të renditura tek shoqëritë me performancë të mirë.

Për këtë vit, ky grup ka një performancë të mirë, vetëm UK Has vazhdon të ketë për të tretin vit radhazi furnizimin me ujë 8 orë/ditë.

Në tabelën 27 është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për Grupin e III-të të shoqërive për tre vitet e fundit.

Tabela 27. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (orë/ditë)	2021 (orë/ditë)	Ndryshimi 2021-2020 (orë/ditë)
1	Pustec	UK	10.00	24.00	14.00
2	Libohovë	UK	13.00	22.00	9.00
3	Klos	U	9.00	10.00	1.00
4	Fushë Arrëz	UK	24.00	24.00	0.00
5	Finiq	UK	21.40	21.40	0.00
6	Has	UK	8.00	8.00	0.00
7	Pukë	UK	24.00	23.00	-1.00
8	Konispol	UK	21.00	20.00	-1.00
9	Këlcyrë	UK	24.00	22.00	-2.00
10	Tepelenë	UK	24.00	20.00	-4.00
11	Memaliaj	UK		17.50	

Përfundime

- Konsumatorët Shqiptarë për vitin 2021 janë furnizuar mesatarisht me 15.4 orë ujë në ditë. Krahasuar me vitin paraardhës treguesi është rritur me 1.6 orë në ditë, por pavarësisht se duket larg realizimit të objektivit të performancës së mirë përcaktuar nga ERRU 18 orë/ditë, me reformën e re në sektorin e furnizimit me ujë dhe investimet nga qeveria qendrore për qendrat urbane pritet që gjendja të përmirësohet dukshëm në të ardhmen e afërt.
- Eksperienca e shoqërive me performancë të mirë në të tre grupet tregon se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por edhe nga mirë menaxhimi i sistemeve nga shpërdorimet dhe lidhjet e paligjshme.
- Shoqëritë duhet të marrin me seriozitet raportimin në ERRU të të dhënave që lidhen me operimin teknik, që akoma është larg nivelit të dëshiruar lidhur me saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Shoqërive do t'iu kërkohen objektiva të forta në momentin e licencimit dhe të aplikimit për ndryshim të tarifave dhe të marrin hapat e nevojshëm për të arritur përmirësime të dukshme duke analizuar dhe dhënë rëndësi të veçantë treguesit të Uji Pa të Ardhura që lidhet ngushtësisht me vazhdimësinë e furnizimit me ujë të konsumatorëve.

2.3.8 Mbulimi me Kanalizime

Treguesi i Mbulimit me Kanalizime është raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK. Shoqëritë të cilat ofrojnë këtë shërbim, arrijnë të mbulojnë në nivel kombëtar mesatarisht 52% të popullsisë nga 51.5% e raportuar në vitin 2020, me një rritje pothuajse të papërfillshme prej 0.5 % për të dytin vit radhazi.

Në sektor, jo të gjitha shoqëritë i ofrojnë të dy shërbimet atë të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, ky i fundit në të shumtën e rasteve kryhet nga ndërmarrjet brenda bashkive, pasi akoma pushteti vendor nuk e ka përfunduar kalimin e këtij shërbimi, në zbatim të VKM 63, tek shoqëritë përkatëse.

Për të patur një shërbim të KUN më cilësorë, nevojitet që të ketë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. Për vitin 2021, nga 11 (njëmbëdhjetë) impiantet ekzistuese, mbulimi me ITUN është raportuar 12.17 % me një rritje prej 1.64% nga viti 2020. Për momentin vetëm 5 (pesë) shoqëri kanë në funksionim

impiant trajtimi të ujërave të ndotura, përkatësisht UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Shkodër të cilat janë të licencuara nga ERRU për të ofruar këto shërbime.

Meqenëse ITUN konsiderohen si shumë të rëndësishme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit, domosdoshmëria për ndërtim të impianteve të reja dhe vënia në punë me kapacitet të plotë e impianteve të ndërtuara do të rrisë ndjeshëm cilësinë e këtij shërbimi.

Analiza e mëposhtme merret vetëm me grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2021




Figura 20. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e I-rë, Viti 2021

Në Grupin e I-rë të shoqërive, mbi kufirin 75% të performancës së mirë, performojnë vetëm 3 shoqëri po të njëjtat që ishin në vitin 2020, si UK Tiranë me 90.7% UK Kamëz me 82.6% dhe UK Sarandë me 79.6%, të cilat duke i krahasuar me vitin paraardhës kanë pësuar një rritje të lehtë të këtij treguesi UK Tiranë (+0.6%) dhe UK Sarandë (+0.36), ndërsa rënie të nivelit të këtij treguesi ka pësuar UK Kamëz, me 17.4%, pasi u konstatua që shoqëria bënte raportim të gabuar, por përsëri mbetet në shoqëritë me performancë të mirë me 82.6%.

Për vitin 2021, në nivelin e performancës 50% deri në 75% të këtij treguesi, performojnë 8 shoqëri UK Kavajë (73.4%), UK Korçë (65.3%), UK Vlorë (63.9%), UK Lezhë (61.6%), UK Durrës (57.5%), UK Elbasan (57%), UK Berat-Kuçovë (54.8%), UK Pogradec (50.3%), ndërsa në nivelin e performancës së dobët 50%, performojnë 3 (tre) shoqëri përkatësisht UK Shkodër (44.6%), UK Fier (41.7%) dhe UK Lushnje (37.5%).

Rritje të dukshme të këtij treguesi ka raportuar UK Kavajë (+11.75%), duke çuar mbulimin me kanalizime të kësaj shoqëri në 73.4 %, kjo rritje ka ardhur për shkak të marrjes së zonës së shërbimit Synej në të cilën kryhet sistemi i kanalizimeve, e ndjekur më pas nga UK Fier (+3.36%), UK Vlorë (+2.1%) dhe UK Lezhë (+1.3%).

Trajtimi i ujërave të ndotura në këtë grup bëhet nga shoqëritë e licencuara UK Durrës, UK Pogradec, UK Korçë, UK Lezhë dhe UK Shkodër.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 28.

Tabela 28 .Ecuria e mbulimit me kanalizime për Grupin I-të 2021

Aktiviteti	Operatori	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
UK	Kavajë	61.65	73.40	11.75
UK	Fier	38.34	41.70	3.36
UK	Vlorë	61.80	63.90	2.10
UK	Lezhë	60.26	61.60	1.34
UK	Durrës	56.64	57.50	0.86
UK	Berat - Kuçovë	54.13	54.80	0.67
UK	Shkodër	43.98	44.60	0.62
UK	Tiranë	90.10	90.70	0.60
UK	Sarandë	79.24	79.60	0.36
UK	Korçë	65.25	65.30	0.05
UK	Pogradec	50.64	50.30	-0.34
UK	Lushnje	38.18	37.50	-0.68
UK	Elbasan	58.46	57.00	-1.46
UK	Kamëz	100.00	82.60	-17.40

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2021

Grupi 2 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 21. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e II-të, Viti 2021

Në Grupin e II-të, për këtë tregues, kanë raportuar 29 shoqëri pasi 4 shoqëri nuk e kryejnë këtë shërbim UK Dropull, UK Devoll, UK Divjakë dhe U Gramsh. Për këtë vit, kanë raportuar për herë të parë për

mbulimin me kanalizime UK Selenicë (31.3%), UK Peqin (4.2%) dhe UK Bulqizë (1.5%), këto 2 të fundit në vlera të papërfillshme, por nuk janë analizuar pasi nuk kanë bazë krahasimi.

Në këtë grup, për vitin 2021 shoqëritë nuk kanë pasur përmirësim të këtij treguesi dhe pothuajse të gjitha shoqëritë e këtij grupi janë nën nivelin e performancës së dobët prej 50%, shoqëritë të cilat kanë përmirësim të këtij treguesi janë UK Maliq (+4.3 %), duke çuar mbulimin me kanalizime në 28.3 %, UK Vorë (+3.16%), UK Roskovec (+2.68%), UK Cërrik (+1.97%), UK Ura Vajgurore (+1.92%), por përsëri kanë një nivel shumë të ulët të këtij shërbimi dhe vazhdojnë të jenë shoqëri me performancë të dobët.

Për të dytin vit radhazi, UK Kolonjë (81.6 %) është e vetmja shoqëri që performon mbi kufirin 75% të performancës së mirë.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 29.

Tabela 29. Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin II-të 2021

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Maliq	UK	24.00	28.30	4.30
2	Peqin	UK	-	4.20	4.20
3	Vorë	UK	47.74	50.90	3.16
4	Roskovec	UK	29.02	31.70	2.68
5	Cërrik	UK	27.13	29.10	1.97
6	Ura Vajgurore	UK	12.68	14.60	1.92
7	Bulqizë	UK	0.00	1.50	1.50
8	Mat	UK	45.93	46.70	0.77
9	Përmet	U	68.00	68.60	0.60
10	Mallakastër	UK	21.41	21.90	0.49
11	Gjirokastër	UK	40.25	40.50	0.25
12	Librazhd	UK	21.00	21.10	0.10
13	Himarë	UK	18.23	18.30	0.07
14	Patos	UK	51.65	51.70	0.05
15	Kolonjë	UK	81.58	81.60	0.02
16	Devoll	UK	0.00	0.00	0.00
17	Divjakë	UK	0.00	0.00	0.00
18	Gramsh	U	0.00	0.00	0.00
19	Skrapar	UK	46.11	46.10	-0.01
20	Delvinë	UK	38.12	38.10	-0.02
21	Rrogozhinë	UK	7.82	7.80	-0.02
22	Kurbin	UK	37.02	37.00	-0.02
23	Poliçan	UK	67.82	67.80	-0.02
24	Vau i Dejës	UK	6.24	6.20	-0.04
25	Dibër	UK	17.44	17.40	-0.04
26	Krujë	UK	25.74	25.70	-0.04
27	Kukës	UK	39.95	39.90	-0.05
28	Malësi e Madhe	UK	1.94	1.80	-0.14
29	Mirditë	UK	40.00	39.80	-0.20
30	Dropull	UK	0.67	0.00	-0.67
31	Belsh	UK	17.04	14.50	-2.54
32	Tropojë	UK	28.56	24.70	-3.86
33	Selenicë	UK	-	31.30	-

Grupi 3 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 22 . Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2021

Grupi i III-të vazhdon të jetë grupi me performancën më të dobët për treguesin e mbulimit me kanalizime kjo dhe si rezultat i mungesës së investimeve në zonën rurale e cila zë një përqindje të lartë të hapësirës në zonën e tyre të shërbimit. Nga 11 shoqëri të këtij grupi, vetëm 5 shoqëri kanë raportuar të dhëna dhe do të analizohen për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura.

Në këtë grup raporton për herë të parë UK Memaliaj (31.95%), shoqëri e re e krijuar nga Bashkia Memaliaj pas shkëputjes së aksioneve nga UK Tepelenë.

Për vitin 2021, asnjë shoqëri e këtij grupi nuk arrin as nivelin e performancës së dobët 50%, të 5 (pesë) shoqëritë performojnë nën kufirin e kësaj performace UK Tepelenë (48.5%), UK Fushë - Arrëz me (34.5%), UK Memaliaj (31.95%), UK Pukë me (25.6%), UK Pustec me (24.3%).

Përmirësim të këtij treguesi ka pësuar vetëm UK Tepelenë (+9.2%), por përsëri mbetet nën nivelin e performancës së dobët me 48.5% mbulim me kanalizime.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 30.

Tabela 30. Ecuria e Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2021

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2020 (%)	2021 (%)	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Tepelenë	UK	39.30	48.50	9.20
2	Pukë	UK	25.28	25.60	0.32
3	Pustec	UK	24.13	24.30	0.17
4	Fushë Arrëz	UK	34.55	34.50	-0.05
5	Memaliaj	UK		31.95	31.95
6	Finiq	UK	0.00	0.00	0.00
7	Has	UK	0.00	0.00	0.00
8	Kelcyrë	UK	0.00	0.00	0.00
9	Klos	U	0.00	0.00	0.00
10	Konispol	UK	0.00	0.00	0.00
11	Libohovë	UK	0.00	0.00	0.00

- Treguesi i mbulimit me shërbimet e KUN është ndër treguesit që ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel për shumë vite radhazi, me rritje pothuajse të papërfillshme prej 0.5 %. Shihet se për vitin 2021 nga analiza për të tre grupet, vetëm 4 shoqëri arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 75 % të popullsisë në zonën e juridiksionit, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Sarandë dhe UK Kolonjë.
- Nga të tre grupet, 16 shoqëri performojnë ndërmjet kufirit të performancës 50% dhe 75%, ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojnë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion.
- UK Selenicë, UK Peqin, UK Bulqizë dhe UK Memaliaj kanë raportim për herë të parë për mbulimin me shërbimet e KUN për vitin 2021.
- Në rang vendi nga 52% mbulim me shërbim të kanalizimeve, shihet që 46% ju ofrohet shërbim zonave urbane dhe vetëm 6% është për zonat rurale. Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 7 shoqëri UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec, UK Shkodër (ITUN Velipojë + ITUN Shirokë), UK Sarandë, UK Vlorë (ITUN Vlorë + ITUN Orikum) dhe UK Lezhë, por nga këto shoqëri kanë arritur të pajisen me licence nga ERRU vetëm 5 shoqëri (UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec, UK Lezhë dhe UK Shkodër) pasi shoqëritë e tjera nuk kanë mundur të pajisen me lejen mjedisore, gjë që ka sjellë pengesë në marrjen e kategorisë D për këto shoqëri.
- Mbetet akoma problem respektimi i normave teknike për impiantet individuale të trajtimit të UN (gropat septike) për zonat rurale.
- Ndihet nevoja e rritjes së vëmendjes për investime në sektor, si në drejtim të zgjerimit të rrjeteve të mbledhjes dhe largimit të UN, edhe të ndërtimit të ITUN para se të derdhen në ambientin pritës.

Renditja e Shoqërive UK Sipas Performancës

Për të vlerësuar arritjet në performancën e shoqërive UK në sektor gjatë vitit 2021 u përzgjedhën katër Tregues Kryesorë të Performancës, të cilat lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive, si dhe të cilësisë së shërbimit që ato i ofrojnë konsumatorëve, respektivisht, Mbulimi i Kostove të O&M, Norma Korrente e Arkëtimit, Uji Pa të Ardhura dhe Vazhdimësia (Orët) e Furnizimit me Ujë. Bazuar në mesataren e renditjes të katër treguesve të mësipërm, në klasifikimin e përgjithshëm shoqëria me performancën më të mirë gjatë vitit 2021 u rendit Shoqëria UK Lezhë e ndjekur nga Shoqëritë UK Korçë dhe UK Gramsh ndërsa shoqëritë me performancë me të dobët në sektor u klasifikuan shoqëritë UK Selenicë, U Has, dhe UK Vau Dejës (shih Aneks 7, tabela 40).

Një klasifikim tjetër për performancën më të mirë u realizua edhe bazuar sipas ndarjes në tre grupe të shoqërive UK që i referohen numrit të lidhjeve që ato administrojnë, ku ndër shoqëritë e vogla (grupi i III-të) e para u klasifikua shoqëria UK Konispol (shih Aneks 8, tabela 41)

3 Konkluzione dhe Rekomandime

- Problemet e mungesave të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara pranë ERRU-së për mjaft shoqëri UK, kërkon rritjen e përgjegjshmërisë së stafëve drejtuese të shoqërive UK në respektim të procedurave për saktësinë e të dhënave të përcaktuara në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave të shërbimeve UK.
- Rritja e kostove të energjisë elektrike edhe për vitin 2021 me 8%, kërkon një vëmendje të shtuar nga shoqëritë UK, kryesisht atyre me skema të furnizimit me ujë me ngritje mekanike. Nevoja për marrjen e masave për menaxhimin e kostove të energjisë merr rëndësi të veçantë në kushtet e krizës globale të energjisë e cila pritët të shoqërohet me rritjen e çmimit të energjisë. Këto masa do të konsistojnë kryesisht në rritjen e efikasitetit të energjisë elektrike bazuar në raporte studimi me këtë subjekt.
- Veçanërisht shoqëritë problematike ndaj pagesës së faturës së energjisë elektrike, të merret në konsideratë firmosja e një kontrate performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos të UPA, Normës Korrente të Arkëtimit dhe Efikasitetit të Stafit.
- Duhet të aktivizohet dhe të nënshkruhen Kontratat e Performancës ndërmjet AKUM-it dhe Bashkive/Shoqërive UK në të cilat realizimi i objektivave të TKP duhet të shërbejë si element bazë për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.
- Duke patur parasysh rolin kyç të Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë në menaxhim për përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë, rekrutimi dhe ose vazhdimësia në detyrë e të cilëve duhet të bëhet bazuar në një kontratë performance të firmosur nga kryetari i Këshillit Administrativ të shoqërisë dhe Drejtorit Ekzekutiv me objektiva konkrete.
- Efikasiteti i stafit në nivelin 5.37 punonjës për 1000 lidhje UK, paraqitet në nivele të larta ku për vitin 2021 konstatohet rritje e kostove të punës me 5% dhe që zënë 33% në kostot operationale të shoqërisë. Shoqëritë UK duhet të marrin në konsideratë bazuar në një analizë të detajuar të organigramave dhe pozicioneve të punës për të justifikuar numrin e punonjësve në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të saj. ERRU në veçanti do ta trajtojë këtë problem kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja të shërbimeve.
- Në lidhje me problemin e garantimit të sigurisë së veprave të furnizimit me ujë si objekte të rëndësishme të veçantë duhet përshtatur legjislacioni në fuqi për të mundësuar alternativën e garantimit të sigurisë me mjete logjistike, si kamera të gërshetuara edhe me masa të tjera teknike, në mënyrë që të ulen kostot e pajustifikuara të stafit, apo të kontraktimit të palëve të treta për këto shërbime.
- Ujit Pa të Ardhura, 64.8% megjithëse ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2020, përsëri mbetet problem serioz për sektorin UK dhe me elementë të konsiderueshme të pasaktësisë së matjes së sasisë së ujit të prodhuar dhe më tej. Në kuadër të reformës së re të sektorit UK, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet instalimit të matësve të ujit në burim dhe tek konsumatorët privat dhe familjarë në mënyrë që të hartohen bilanci i ujit të saktë si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Planet e Biznesit 5-vjeçarë si dhe Planet e Menaxhimit të Aseteve si një domosdoshmëri për shoqëritë UK, duhet të jenë në fokus kryesorë të reformës në sektor për shoqëritë e agreguara.
- Në kuadër të reformës mbi agregimin e sektorit për përmirësimin e performancës së tij në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operationale dhe qëndrueshmërisë financiare, të vijohet sa më parë me konkretizimin e këtij procesi përsa i përket formës dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore për realizimin e saj.

4 Tema e Veçantë (Studim i ERRU-së tetor 2021, i përditësuar me të dhënat e OSHEE në mbyllje të vitit 2021)

Studimi, Problematika e Mbulimit të Kostove të Energjisë për Shoqëritë UK

I. Të Përgjithshme

Në sektorin UK aktualisht nga 58 shoqëri UK, 46 prej tyre nuk arrijnë të mbulojnë kostot operim dhe mirëmbajtje (O&M). Kostot e energjisë elektrike në sektorin e UK zënë rreth 29% të totalit të kostove O&M. Shoqëritë që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M e sigurojnë mbijetesën financiare me anë të subvencioneve nga qeveria qendrore, ose duke mos paguar faturën e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së. Kjo gjendje ka sjellë një borxh të akumuluar të sektorit ndaj OSHEE prej rreth 11.9 miliard lekë (rreth 100 milion euro), që së bashku me kamatëvonesat në vite arrin në rreth 21.9 miliard lekë (rreth 184 milion euro). (Shih Aneks 14, tabela 47)

Referuar kësaj gjendje, ERRU me mbështetjen e OSHEE ndërmori një studim që analizoi në detaje situatën, si dhe jep rekomandimet përkatëse për daljen e sektorit UK nga kjo gjendje. Studimi jep qasjen kryesore për vlerësimin e kësaj situate, si dhe disa rekomandime si bazë nisje për zgjidhjen e problemit.

Analiza është fokusuar kryesisht për 6 shoqëri UK, respektivisht, Durrës, Vlorë, Patos, Kavajë, Kurbin dhe Krujë, shuma e borxheve të të cilave përbën rreth 64% të borxhit total të sektorit UK ndaj OSHEE-së (Tabela nr. 31.). Kostot e energjisë për këto shoqëri variojnë nga 21% deri 62% të kostove O&M. Konkluzionet dhe rekomandimet nga analiza e këtyre 6 shoqërive kanë karakter përgjithësues pothuajse për të gjithë sektorin.

Tabela Nr.31 Kostot O&M dhe Debitë e Akumuluar nga Kostot e Energjisë për Sektorin UK (2021)

Nr.	Shoqëritë	Kosto O&M (000 lek)	Kosto e Energjisë (000 lek/vit)	Pesha e Energjisë në Kostot O&M (në %)	Debi të Akumuluar ndaj OSHEE Principali (në 000 lek)	Debi të Akumuluar ndaj OSHEE Kamatë-vonesa (në 000 lek)
1	UK Kavajë	180,685	112,607	62.30%	586,487	409,484
2	UK Durrës	1,562,900	876,285	56.10%	3,739,880	3,400,779
3	UK Kurbin	114,395	63,793	55.80%	461,976	380,256
4	UK Patos	181,666	91,598	50.40%	901,634	766,923
5	UK Vlorë	637,343	237,598	37.30%	1,285,977	1,066,146
6	UK Krujë	79,056	16,604	21%	518,210	454,697
		2,756,045	1,398,485		7,494,164	6,478,285
	Totali i borxhit ndaj OSHEE për 6 Shoqëritë UK (në 000 lek)				13,972,500 (64% ndaj totalit të 58 shoqërive UK)	
	Totali i borxhit ndaj OSHEE për 58 Shoqëritë UK (në 000 lek)				11,915,442	10,029,355
					21,944,797	
	Totali për 58 Shoqëritë (në euro)	80,504,000	23,300,000		99,300,000	83,500,000
					182,800,000	

II. Qasja e Studimit

Problematika e shlyerjes së pagesës së energjisë elektrike nga shoqëritë UK ndaj OSHEE është komplekse. Në mënyrë që të reduktohet debia e krijuar ndaj OSHEE dhe të krijohet aftësi pagueuse për faturën e energjisë në vijimësi, ky studim fokusohet në katër faktorët e mëposhtëm:

- I. Rritja e efijencës së energjisë elektrike dhe e Treguesve Kryesore të Performancës (TKP) për shoqëritë UK;
- II. Plan i ri tarifar i shoqërive UK për shërbimet që ofrojnë për konsumatorët;
- III. Subvencionimi pjesërisht/plotësisht nga buxheti i shtetit;
- IV. Ulja e tarifës së energjisë elektrike për shoqëritë UK.

Studimi analizon vetëm tre faktorët e parë sepse referuar gjendjes aktuale të krizës energjitike elementi i katërt nuk shihet si mundësi momentalisht për tu marrë në konsideratë.

III. Rritja e Efijencës së Energjisë Elektrike dhe Performancës së Shoqërisë UK

Rritja e efijencës së energjisë elektrike përgjithësisht është e lidhur me investimet fizike, kryesisht në stacionet e pompimit të sistemeve të UK dhe të impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), por edhe në rishikimin dhe përmirësimin e skemave hidraulike të këtyre sistemeve.

Çdo shoqëri UK duhet të disponojë një raport të efijencës së energjisë, në të cilin analizohet efikasiteti i përdorimit të energjisë elektrike, kryesisht në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm e të ujërave të ndotura, si dhe në ITUN. Referuar 6 shoqërive që merren në analizë në këtë studim, UK Kavajë, UK Krujë dhe UK Kurbin nuk disponojnë një raport të efijencës së energjisë, për rrjedhojë duhet ta kenë prioritet hartimin e tij.

Një nga treguesit kryesorë të performancës që lidhet me konsumin e energjisë elektrike është Uji Pa të Ardhura (UPA), i cili për 6 shoqëritë e konsideruara luhet nga 49% - 79%. Tabela nr. 32 jep vlerat e UPA dhe konsumin mesatar litra/ditë, person. Në të vërehet se shoqëritë Durrës, Vlorë dhe Fier përveçse kanë vlera mjaft të larta deri në 79% të UPA, kanë edhe një normë mjaft të lartë konsumi të energjisë elektrike. Kjo tregon se krahasuar me kërkesën reale për ujë, këto shoqëri pompojnë mbi-volum uji, pra edhe mbi konsum të energjisë elektrike. Këto shoqëri për uljen e konsumit të energjisë elektrike duhet të angazhohen seriozisht për uljen e UPA, pra të humbjeve teknike dhe administrative.

Tabela Nr. 32 UPA dhe Norma Mesatare e Ujit të Prodhuar, viti 2021

Shoqëria UK	Durrës	Vlorë	Patos	Krujë	Kavajë	Kurbin
Uji Pa të Ardhura (në %)	79	76	73	68	65	49
Prodhimi (litër/ditë/banor)	348	380	243	195	205	214

Në veçanti duhen marrë në konsideratë dhe analizuar gjithashtu edhe treguesit e tjerë të performancës, përkatësisht, Norma e Arkëtimit dhe Efijenca e Stafit.

IV. Plan i Ri Tarifor për Shërbimet UK

Mbulimi i kostove të O&M pjesërisht ose plotësisht mund të realizohet nga rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së tarifës për FU dhe KUN bazuar në kriteret e kostove të justifikuara, si dhe përballueshmërinë e faturës mujore për konsumatorët, pra që ajo nuk duhet të kalojë vlerën prej 5% të shpenzimeve mesatare mujore për familje.

Tabela nr. 33 paraqet në vlerë absolute (në lek/muaj) faturën mujore mesatare aktuale për konsumatorët familjarë (mesatarisht 4 persona/familje me një konsum mesatar 100 litra/ditë/banor) për shërbimet e UK që u ofrohen konsumatorëve. Në të jepet gjithashtu fatura mesatare e pritshme mujore, e cila do të mundësonte mbulimin 100% të kostove O&M të shoqërive (në lek/muaj), rritjen që do të pësonte kjo faturë, si dhe pragun maksimal të rritjes së faturës për të respektuar kriterin e përballueshmërisë.

Tabela Nr. 33 Fatura mesatare mujore aktuale, e pritshme dhe niveli i Përballueshmërisë

Shoqëritë UK	Patos	Kavajë	Krujë	Vlorë	Kurbin	Durrës
Fatura mesatare aktuale* (lek/muaj)	1,536	763	739	984	492	1,908
Fatura me mbulim 100% të kostove O&M (lek/muaj)	2,755	1,215	1,107	1,308	791	2,082
Rritja absolute e faturës (lek/muaj)	1,219	452	367	324	299	174
Rritja e faturës (në %)	79%	59%	50%	33%	61%	9%
Vlera Maksimale e Faturës si Kriter i Përballueshmërisë (lek/muaj)	3,981	3,445	3,821	3,505	3,799	3,821

*) për një familje me 4 persona, dhe me një konsum mesatar 100 litra/ditë/banor

Vihet re se shoqëria që rezulton me nevojën më të madhe për rritjen e nivelit të tarifës është UK Patos me 79%. Në fakt për rritjen e kërkuar të tarifës Kriteri i Përballueshmërisë respektohet, por në pjesën më të madhe të shoqërive të mësipërme kërkohet një rritje tarife shumë e lartë dhe e menjëhershme, që në përgjithësi mund të krijojë reagim negativ të fuqishëm nga konsumatorët për mospagimin e faturës së ujit. Kjo do të ishte veçanërisht e pritshme në shoqëritë, UK Patos, UK Kavajë, UK Krujë dhe UK Kurbin. Në fakt që një rritje tarifash për shërbimet FU dhe KUN të konsiderohet e arsyeshme dhe e pranueshme duhet të kryhet një analizë rast pas rasti për secilën shoqëri. Deficiti që do të krijohet nga një rritje graduale në kohë (jo e menjëhershme) në kushtet e pamundësisë së pagesës së plotë të faturës së energjisë elektrike ndaj OSHEE-së, do të duhet të kompensohet nga subvencionet që alokohen nga qeveria qendrore.

V. Subvencionimi nga Buxheti i Shtetit

Bazuar në nevojat e justifikuara të shoqërive për mbulimin 100% të kostove të O&M, për të bërë të mundur vijimin e aktivitetit, qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it subvencionon një pjesë të kostove direkte të O&M. Për vitin 2021, nevoja reale për subvencionim e sektorit ka qenë 1,6 miliard lekë (rreth 13.5 milion euro). Gjatë vitit 2021 kanë përfituar subvencione nga buxheti i shtetit 29 shoqëri UK në vlerën 380 milion lekë (rreth 3.2 milion euro), por mbetën pa mbuluar rreth (1.2) miliard lekë (10.3 milion euro) ose rreth 77% më pak se nevojat reale për subvencione. Subvencionimi nga qeveria qendrore duhet të kryhet i plotë në përputhje me nevojat e mbulimit të kostove O&M sepse mungesa përgjithësisht shkon në mospagimin e faturës së energjisë elektrike ndaj OSHEE.

Përfundime

- Përmirësimi i performancës financiare të shoqërive UK debitore ndaj OSHEE për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve ndaj kësaj të fundit, kërkon një analizë për çdo shoqëri rast pas rasti nga kombinimi i tre faktorëve të trajtuara më sipër.
- Rritja e efikasitetit të energjisë elektrike dhe të performancës në tërësi për shoqëritë UK duhet të realizohet me anë të një kontrate performance, bazuar në një analizë dhe vlerësim real të Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), si dhe të objektivave të tyre, me përfshirjen e AKUM-it dhe ERRU-së. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos UPA, Norma Korrente e Arkëtimit, dhe Eficienca e Stafit.
- Shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU-së me një Plan të ri tarifor, i cili në respektim të kritereve të ERRU-së për aprovimin e tarifave, të mund të mbulojnë deri 100% kostot e O&M, pra duke përfshirë edhe vlerën (koston) faturës së energjisë ndaj OSHEE-së.
- OSHEE duhet të ushtrojë presion nëpërmjet të gjitha instrumenteve ligjore kundrejt shoqërive UK debitore në mënyrë që ato të krijojnë likuiditetet e duhura dhe të shlyejnë detyrimet.
- Kontrata e performancës dhe niveli i ri tarifor duhet të shërbejnë si bazë për vlerësimin real të nevojave për subvencione për çdo shoqëri debitore ndaj OSHEE-së.
- Detyrimet që i përkasin kamatë-vonesave për faturat e papaguara të energjisë së shoqërive UK ndaj OSHEE-së propozohet që të mund të rishikohen dhe të likuidohen me marrëveshje të veçanta ndërmjet secilës shoqëri dhe OSHEE-së.
- Shoqëritë duhet të ndërgjegjësohen dhe të bëjnë çdo përpjekje e cila kontribuon në rritjen e efikasitetit të energjisë, dhe për rrjedhojë ul konsumin e energjisë dhe koston e saj, duke filluar me hartimin e planeve të efikasitetit të energjisë.

I. Rast Studimor - UK Durrës

UK Durrës është shoqëria e cila ka borxhin më të lartë të akumuluar ndaj OSHEE (7.1 miliard lekë), ku borxhi real i akumuluar është 3.7 miliard lekë dhe kamata përkatëse prej 3.4 miliard lekë. Në këtë shoqëri pesha që zë kostoja e energjisë elektrike në totalin e kostove O&M për vitin 2021 është rreth 56.1%.

Shoqëria krahas sistemit të furnizimit me ujë ekzistues ka futur në punë një sistem të ri Fushë Kuqe me një prurje shtesë prej rreth 637 litra/sek. Të gjitha sistemet përbërëse të saj të furnizimit me ujë, kanalizimit të ujërave të ndotura, dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura operojnë me ngritje mekanike, gjë që bën që kostoja e energjisë elektrike për këtë shoqëri të jetë më e larta në sektor.

Duke patur parasysh që në përgjithësi stacionet e pompimit në të gjithë zonën e shërbimit janë relativisht të reja dhe me rendimente të larta të pompave, duket si jo thelbësore ulja e konsumit të energjisë elektrike nga ky faktor nga rritja e rendimentit të pompave.

Treguesi “UPA” për vitin 2021 ishte 79.2%. Përmirësimi i këtij treguesi për UK Durrës duhet të jetë në fokusin kryesor të kësaj shoqërie, për të rritur të ardhurat financiare të shoqërisë nga lidhjet e paligjshme dhe abuzimet me faturimet, gjë e cila do të rriste aftësinë paguese të shoqërisë ndaj detyrimeve që ka kundrejt OSHEE-së. Nga ana tjetër, kjo do të influenconte në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, sepse ulja e UPA-s do të çonte në rritjen e orëve të furnizimit me ujë për konsumatorët.

Duke analizuar dhe kompleksitetin e sistemeve të furnizimeve me ujë në zonën e saj të shërbimit, krahas angazhimit për uljen e humbjeve administrative, ndihet akoma nevoja e investimeve për reduktimin e këtij treguesi në drejtim të humbjeve fizike kryesisht në rrjetet shpërndarëse të tyre.

Fatura mesatare aktuale për konsumatorët familjarë që shërbehen nga UK Durrës është 1,900 lekë/muaj. Në mënyrë që nëpërmjet të ardhurave të faturuara, kostot O&M të kësaj shoqërie të mbulohen 100%, nevojitet që niveli i faturës ndaj konsumatorëve të rritet përafërsisht 9%. Kjo rritje do të bënte që fatura mesatare mujore të rritej me rreth 174 lekë/muaj dhe fatura të arrinte në vlerën 2,080 lekë/muaj. Por referuar normës së arkëtimit (76.4%) që përcakton të ardhurat e arkëtuara për vitin 2021, për të mbuluar kostot e O&M tarifa do të duhej të rritej akoma më tepër, gjë që duket e papranueshme dhe jashtë kriterëve të ERRU-së për miratimin e një plani të ri tarifor. Kjo situatë sjell nevojën e vazhdimësisë për subvencionim nga buxheti i shtetit të shoqërisë UK Durrës.

Si konkluzion, për përmirësimin e gjendjes financiare të UK Durrës dhe për të mundur mbulimin e kostove direkte të O&M dhe më pas të kostove totale, për UK Durrës propozohet:

- Lidhja e një Kontrate Performance me objektiva bazuar në një analizë të thelluar të treguesve kryesorë të performancës (TKP) së shoqërisë dhe mundësisë së përmirësimit të tyre për çdo vit. Duke patur parasysh një normë prodhimi uji prej 348 litra/ditë/banor, duhet të analizohet treguesi i UPA prej 79.2% dhe i Normës Korrente të Arkëtimit të papranueshme prej 76.4%;
- Shoqëria UK Durrës operon me një tregues të efikasitetit të stafit prej 5,31. Është i nevojshëm përmirësimi i këtij treguesi për reduktimin e stafit të tepërt dhe uljen e kostove të O&M.
- Aplikimi pranë ERRU-së për një rritje të arsyeshme dhe të pranueshme të tarifave ekzistuese, bazuar në përditësimin e Planit të Biznesit 5-vjeçar aktual të shoqërisë, ku të përmbushet edhe kriteri i përballueshmërisë;
- Të vazhdojë subvencionimi nga buxheti i shtetit, për plotësimin pjesërisht të nevojave për mbulimin e kostove direkte të O&M bazuar në realizimin e treguesve të kontratës së performancës;
- Të lidhet një kontratë me OSHEE për likuidimin e debive të akumuluar, e shtrirë në kohë bazuar në terma të dakordësisë së dyanshme;
- Duke qenë se shoqëria UK Durrës ka ende pa shlyer investime të kryera në të kaluarën (interesa dhe principal), nevoja për të mbuluar kostot totale të aktivitetit në të ardhmen, duke përfshirë një faturë të lartë të kostove të energjisë elektrike (duke konsideruar edhe borxhet e akumuluar), rekomandohet krijimi i një mundësie që shoqëria UK Durrës të ketë burimin e saj të pavarur të energjisë elektrike për të plotësuar në mënyrë të plotë ose të pjesshme nevojat e saj për energji elektrike, me anë të burimeve alternative të rinovueshme. Kjo ide përforcohet më shumë nga kriza aktuale energjitike, nga e cila pritet një rritje e mëtejshme e çmimit të energjisë elektrike.

5 Aneke: Të dhënat Kryesore të Sektorit

Aneks 1, Tabela 34. Shoqëritë e Riorganizuara dhe të Licencuara sipas Reformës deri në Vitin 2021

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës					
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë	Sh.a UK Pukë	Sh.a UK Fier	Sh.a.UK Selenicë
2	Sh.a UK Vorë	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull	Sh.a UK Elbasan	Sh.a UK Bulqizë	Sh.a.UK Tiranë
3	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol			Sh.a.UK Memaliaj
4	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë			
5		Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë			
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë			
7		Sh.a UK Berat Kuçovë	Sh.a UK Kavajë			
8		Sh.a UK Devoll	Sh.a UK Sarandë			
9		Sh.a UK Maliq	Sh.a UK Ura Vajgurore			
10		Sh.a UK Patos				
11		Sh.a UK Skrapar				
12		Sh.a UK Vau Dejës				
13		Sh.a UK Tepelenë				
14		Sh.a UK Delvinë				
15		Sh.a UK Lezhë				
16		Sh.a UK Pogradec				
17		Sh.a UK Shkodër				
18		Sh.a UK Cërrik				
19		Sh.a UK Roskovec				
20		Sh.a UK Mat				
21		Sh.a UK Lushnje				
22		Sh.a UK Librazhd				
Nëntotali						
	4	22	9	2	2	3
42						

Burimi: ERRU

Aneksi 2, Tabela 35. Norma e Arkëtimit Korrente dhe e Përgjithshme, Vitet 2020-2021

Nr.	Aktiviteti	Shoqëritë	Norma e Arkëtimit Korrente		Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	
			Viti 2020	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2021
1	UK	Tiranë	81.06%	84.5%	85.16%	94.7%
2	UK	Durrës	59.28%	76.36%	73.35%	90.17%
3	UK	Vlorë	95.95%	63.12%	117.11%	84.60%
4	UK	Elbasan	66.26%	68.28%	92.72%	120.24%
